

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

TEVHID DHE TEVEKKUL

Imam Gazali

Ihja U lumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i originalit
KITABU'T-TEVHID VE'T-TEVEKKUL
Libri 35

Përgatiti dhe përktheu
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Shenaj Zeneli

Prishtinë, 2020

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Hamd i takon vetëm Allahut Teala, Atë e lavdërojmë dhe Atë e falënderojmë. Ai Allah, që drejton botën e fshehur (alem el-melekut) dhe botën e dukshme (alem el-mulk), është Një dhe i Vetmi në sundim. Ai e ngriti qiellin dhe e mban lartë pa direkë, e nga atje u jep riskun robëve të Tij. Duke i larguar zemrat dhe sytë e mendjemprehtëve nga ndërmjetësimet dhe shkaqet, i lidhi ato Vetes. I largoi nga mbështetja tjetrit dhe ata nuk adhurojnë askënd përveç Tij, sepse e dinë se Allahu është Një, se Atij i mbështetet secila krijesë, për secilën nevojë, se edhe ato krijesa janë të pafuqishme dhe të krijuara nga Ai, dhe se Allahu Teala të gjithë atyre ju ka garantuar riskun, duke thënë:

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin.” (11-Hud: 16)

E kur e kuptuan se Allahu Teala është garantues për riskun, duke iu mbështetur Atij, thanë:

“Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!” (3-Ali Imran: 173)

Salat dhe selam Muhammedit s.a.v.s., që e çrrënjosi besimin e kotë dhe udhëzoi në rrugë të drejtë, ehli-bejtit të tij edhe as'habëve të tij të ndershëm e të pastër.

E tash dije: *tevekkul*¹ është gradë e rëndësishme e fesë, e atyre që posedojnë *jekin* dhe gradë e lartë e *mukarrebunëve* (të afërt te Allahu). *Tevekkul* është i vështirë për t'u kuptuar aq sa është edhe i zorshëm për t'u vepruar. E vështirësia për të kuptuar *tevekkulin* është kjo: konsiderimi i sebepeve si kryesoret dhe mbështetja në to është shirk në tevhid. Largimi i plotë nga sebepet është pohim i mangësisë në ligjin e Allahut (*sunnetullah*), është shpifje e trillim mbi sheriatin, ndërsa mbështetja në sebepe pa vepruar është kundër mendjes së shëndoshë dhe është dalldisje në injorancë.

¹ Fjala *tevekkul*, në gjuhësi ka kuptimin t'ia dorëzosh një punë dikujt tjetër, të kalosh një punë në përgjegjësi të tjetrit, të porositësh dikë tjetër për një punë, puna të lihet në dorë të dikujt tjetër. Ndërsa, në terminologjinë Islame *tevekkul* ka kuptimin: pas marrjes së masave të sebepit (shkakut) - përfundimi t'i lihet Allahut; të jesh i kënaqur (razi) me atë që vjen prej Allahut; duke u angazhuar me shkaqet; pas mobilizimit të mundësive, merr masa dhe i bën detyrat që i takojnë, dhe pastaj përfundimin ia lë Allahut Teala. *Tevekkul* është një përfundim i natyrshëm i besimit që Allahu posedon cilësitë e diturisë, dëshirës, fuqisë dhe krijimit. Edhe besimi në kader dhe kaza përforcon *tevekkulin*. *Tevekkul* është kur njeriu plotësisht beson në premtimet e Allahut Teala. Në gjuhën shqipe, *tevekkul* është përkthyer si *mbështetje Allahut*.

Është shumë e vështirë të përcaktohet kuptimi i vërtetë i tevekkulit, e kjo të jetë përshtatshëm mësimeve për domosdoshmëritë e sheriatit, hadithit dhe tevhidit. Karshi kaq fshehtësive, perden mund ta ngritin vetëm dijetarët e vërtetë, ata të cilëve sytë u janë lyer me nurin e hakikatit dhe shohin qartë me syrin e zemrës.

Si hyrje në këtë libër do ta shpjegojmë vlerën e lartë të tevekkulit; në pjesën e parë do të flasim për tevhidin, e në pjesën e dytë për gjendjen e tevekkulit dhe zbatimin e tij.

VLERAT E LARTA (FAZILET) TË TEVEKKULIT

AJETET NË KËTË TEMË

“Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu!” 5-Maide: 23

“Vetëm Allahut le t'i mbështeten vazhdimisht ata që gjithnjë iu mbështetën.” 14-Ibrahim: 12

“Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton.”

65-Talak: 3

“Mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” 3-Ali Imran: 159

Sa gradë e lartë kur personi i mbështetet Allahut dhe Allahu Teala e do atë! Atij që i mjafton Allahu, atë që Allahu e do dhe e mbron, me siguri që ka arritur shpëtim dhe fitore të madhe. I dashuri nuk dënohet, nuk privohet nga *Rahmeti* dhe *Xhemali*:

“A nuk i mjafton Allahu robit të Vet?!”

39-Zumer: 36

Ai që kërkon tjetër pos Allahut, e ka braktisur *tavekkulin* dhe e ka përgënjeshtuar këtë ajet, ku përmes pyetjes tregohet hakikati.

Ndërsa Allahu Teala thotë:

“Vërtet ka kaluar një periudhë kohore, që njeriu nuk ekzistonte fare si një diçka i përmendur.”

76-Insan: 1

“Por ai që mbështetet tek Allahu, me të vërtetë, do ta gjejë Atë të Plotfuqishëm dhe të Urtë.” 8-Enfal: 49

Allahu është i Plotëfuqishmi, nuk e poshtëron atë që i kërkon ndihmë, nuk e dëmton atë që i mbështetet dhe strehohet te Ai. Është i Urti, dhe atij që i mbështetet përcaktimit të Tij, nuk i bën padrejtësi dhe do të jetë i kënaqur.

Allahu Teala thotë:

“S'ka dyshim se ata që po i adhuroni ju pos Allahut, janë të krijuar sikur ju.” (7-Araf: 194), dhe njofton se njerëzit adhurojnë ata që janë të krijuar, sikur edhe vet njerëzit, kur edhe ata janë nevojtarë, si gjithçka tjetër.

E Allahu Teala gjithashtu thotë:

“Në të vërtetë, ata që ju i adhuron në vend të Allahut, nuk kanë pushtet t’ju furnizojnë, andaj, vetëm tek Allahu kërkoni risk dhe adhuron e falënderoni vetëm Atë. Tek Ai do të ktheheni.” 29-Ankebut: 17,

si edhe:

“Por Allahut i takojnë thesaret e qiejve dhe të Tokës, ndonëse hipokritët nuk kuptojnë.”

63-Munafikun: 7,

dhe:

“Ai drejton çdo gjë. S’ka ndërmjetës tek Ai përveçse me lejen e Tij. Ky është Allahu, Rabbi juaj, andaj adhurojeni Atë! A nuk po mendoni?!”

10-Junus: 3

Çdo ajet në Kuran-i Kerim që përmend *tevhidin*, thërret në ndërprerje të interesimit për të tjerët dhe në mbështetje Allahut, i Cili Sundon.

HADITHET NË KËTË TEMË

Në një transmetim nga Ibn Mesud r.a., Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Të gjithë ummetet m’u treguan në Miraxh. E pashë ummetin tim, i kishin mbushur fushat dhe malet. Më pëlqeu kallaballëku dhe gjendja e tyre. M’u tha:

- A je i kënaqur?

- Po, jam i kënaqur; thashë unë, e atëherë m’u tha:

- Shtatëdhjetëmijë prej tyre do të hynë në xhenet pa llogari.

As’habët e pyetën: *“Kush janë ata, o i Dërguari i Allahut?”*, e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Janë ata që nuk janë damkosur, nuk janë ogurzi, nuk kërkojnë magji, nuk përdorin fjalë ndjellakeqe, por vetëm i mbështeten Allahut Teala.

Ukashe b. Mihsan el-Esed u ngrit në këmbë e tha:

- O i Dërguari i Allahut, lute Allahun të më bëj prej tyre; e Resulallahu s.a.v.s., u lut:

- O Allah, bëje Ukashen prej tyre.

Pastaj u ngrit një tjetër dhe tha:

- O i Dërguari i Allahut, edhe unë dua të jem prej tyre; e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- Ukashe ta kaloi.²

² Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Abbasi.

Resulallahu s.a.v.a., thotë:

“Po t’i mbështeteni plotësisht Allahut, Ai, siç i jep riskun shpendëve, edhe juve do t’ju jepte. Shpendët fluturojnë në mëngjes të uritur e kthehen në mbrëmje të ngopur”³, dhe thotë:

“Kush e kthen fytyrën nga çdo send dhe i mbështetet Allahut të Plotfuqishëm, Allahu Teala ia jep riskun nga një vend që ky nuk e shpreson. E kush i kthehet dynjasë, Allahu Teala atë ia lë dynjasë”⁴,

dhe:

“Kush dëshiron të jetë më i fuqishëm mes njerëzve, le të mbështetet te Allahu Teala, duke besuar.”⁵

Kur familja e tij ishte në varfëri, Resulallahu s.a.v.s., ju thoshte:

- ***Falni namaz!***, duke thënë krahas kësaj:

- ***Kështu më ka urdhëruar Rabbi im. Ai thotë: “Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë...”*** (20-Ta Ha: 132)⁶, dhe:

“Nuk mbështetet në Allahun ai që merret me magji (sihir) dhe me punë të këqija.”⁷

³ Tirmidhiu dhe Hakimi nga Omeri r.a..

⁴ Teberani, Ibn Ebu Dunia dhe Bejhaki nga Hasani.

⁵ Hakimi dhe Bejhaki nga Ibn Abbasi.

⁶ Taberani, në veprën *‘Evsat’*, nga Muhammed ibn Hamza.

Tregohet se Ibrahim i a.s., kur u hodh në zjarr, Xhibrili a.s., e pyeti:

- ***A të duhet ndihmë?***; e Ibrahim i a.s., tha:

- *Jo nga ti!*; duke u mbështetur në fjalët:

“Na mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!”

3-Ali Imran: 173,

në çka Allahu Teala i shpalli:

“...Ibrahimi, që gjithnjë i plotësoi obligimet.”

53- Nexhm: 37

Ndërsa Davudit a.s., Allahu Teala i shpalli:

“O Davud, nuk ka rob që mbështetet në Mua e jo në krijesat e Mia, e që qiejt e Toka t’i përgadisnin telashe, e që Unë të mos i jap rrugëdalje.”

⁷ Tirmidhiu, që e konsideron hadith të mirë (*hasen*). E transmetojnë edhe Nesai në veprën ***el-Kubra*** dhe Taberani.

FJALËT E AS'HABËVE DHE DIJETARËVE NË KËTË TEMË

Said ibn Xhubejr r.a., tregonte: *“Një herë akrepi ma kafshoi dorën. Nëna ime e bëri një ilaç, por unë e zgjata dorën e shëndoshë, dhe ajo e vendosi ilaçin aty.”*

Ibrahim b. Ahmed el-Havasi e lexoi ajetin:

“Ti mbështetju Atij të përjetshmit që nuk vdes...”

(25-Furkan: 58), e pastaj tha: *“Pas këtij ajeti, njeriut nuk i lejohet t'i mbështetet askujt, pos Allahut.”*

Një dijetarit, në ëndërr i është thënë: *“Kush i mbështetet Allahut, ai përfiton fuqinë.”*

Një tjetër dijetar ka thënë: *“Risku, i cili tashmë të është garantuar mos të largojë nga ibadetet farz, sepse atëherë e humbë ahiretin, ndërsa në dynjallëk prapë merr vetëm aq sa të është përcaktuar.”*

Jahja b. Muadh ka thënë: *“Robi e gjen riskun edhe pa e kërkuar, e kjo është dëshmi e qartë se edhe risku e kërkon pronarin.”*

E Ibrahim b. Edhemi tregon: *“E pyeta një murg se ku e merr ushqimin, e më tha:*

- Nuk e di unë, pyete Rabbin tim.

Harem b. Huajam e pyeti Uvejs Karanin:

- *Ku po më urdhëron të shkoj për të banuar?; e*

Uvejsi ia rekomandoi Shamin. Haremi e pyeti:

- *Si janë kushtet e jetesës aty?; e Uvesi tha:*

- *Turp për këto zemra me dyshime! As këshilla nuk ju sjell dobi këtyre.*

Një dijetar ka thënë: *“Kur je i kënaqur me përcaktimin e Allahut, e gjen rrugën për të gjitha mirësitë.”*

E lusim Allahun Teala për edeb të bukur!

Pjesa e parë

HAKIKATI I TEVHIDIT, QË ËSHTË ESENCA E TEVEKKULIT

Dije se edhe tevekkuli është një nga dyert e imanit, e të gjitha dyert e imanit kompletohen me dituri, gjendje dhe veprim. Edhe tevekkuli vjen nga dituria; dituria është baza e veprimi është frut i diturisë, ndërsa gjendja është ajo çka kërkohet me emërtimin *tevekkul*.

Fillimisht të shpjegojmë diturinë, që është baza. E me dituri, këtu nënkuptohet imani. Sepse, imani është vërtetim (*tasdik*), e çdo vërtetim me zemër është dituri. Nëse kjo forcohet, atëherë quhet *jekin*. Por jekini ka shumë dyer, e ne këtu kemi nevojë për jekinin mbi të cilin do të ndërtojmë tevekkulin. e kjo është,

tevhidi, që e interpretojnë fjalët:

“La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh” (*Nuk ka zot pos Allahut, Allahu është një, Ai nuk ka ortak*),

besimi (*iman*) në fuqinë e Allahut, me fjalët:

“Atij i takon i gjithë pushteti (*Lehul mulk*)”;

si edhe besimi në urtësinë dhe mirësinë e Allahut, që interpretohet me fjalët:

“...dhe Atij i takon falendërimi (*Lehul hamd*).”

Ai që thotë: ***La ilahe illallahu vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kulli shej'in kadir***⁸, imani i tij, që është bazë e tevekkulit, do t'i plotësohet, në rast se kuptimi i këtyre fjalëve bëhet cilësi e domosdoshme dhe dominuese në zemrën e tij.

Tevhidi është bazë, fjalët për të zgjaten shumë. Tevhidi i takon diturisë *mukashefe*. Megjithatë, disa dituri *mukashefe* janë të ndërlidhura me veprimet dhe gjendjet e njerëzve, pra me diturinë *muamele*, e cila mund të plotësohet vetëm me diturinë *mukashefe*. Prandaj ne do të paraqesim prej saj vetëm atë që sa ndërlidhet me diturinë *muamele*, sepse tevhidi është një det i madh, pa bregdet. Në këtë kuptim, do të themi se *tevhidi* ka katër gradë:

- *lëvozhgën*;
- *lëvozhgën e lëvozhgës*;
- *thelbin*; dhe
- *thelbin e thelbit*;

Mendjeve të dobëta këtë ia shpjegojmë me shembullin e arrës, që e ka lëvozhgën e fortë, pastaj një

⁸ Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe falënderimi. Ai ka fuqi mbi çdo gjë.

lëvizohet më të butë brenda, dhe brenda saj, thelbin. E *thelb i thelbit* të arrës do të jetë yndyra e saj.

Grada e parë e tevhidit është që personi ta shqiptojë ***La ilahe illallah*** me gjuhë, por e shqipton pavëmendshëm, ose nuk e beson me zemër, siç është tevhidi i mynafikut.

Grada e dytë e tevidit është që edhe me zemër ta besojë atë që e thotë, ashtu siç beson shumica e myslimanëve. Ky është besimi i njerëzve të rëndomtë.

Grada e tretë e tevhidit është që tevhidi të kuptohet me *keshf*, përmes nurit të Allahut Teala. Kjo është shkalla e atyre që janë më të afërt Allahut (*mukarrebun*). Personi në këtë gradë sheh shumë gjëra, por e di se ato vijnë nga Një Krijues, që i sundon të gjithat.

Grada e katërt e tevhidit është që personi sheh vetëm Një, e këtë e kuptojnë të singertët (*es-siddikun*). Sufitë e quajnë '*fena fi't-tevhid*'⁹, sepse i këtilli nuk e sheh as veten e vet, ai sheh vetëm Një. I zhytur në tevhid, në tevhid edhe zhduket, prandaj nuk e sheh as veten, e as krijesat tjera.

⁹ zhdukje në tevhid

I pari, i cili tevhidin e shprehë vetëm me gjuhë, është i mbrojtur nga *shpata* në këtë botë, pra nga dënimi i Sheriatit, që gjykon vetëm të dukshmen.

I dyti është *muvaḥhid*; ai e beson me zemër atë që e thotë, dhe zemra nuk i mohon. Kjo është si një nyje në zemër, që nuk mund të hapet a zgjerohet. Nëse nuk e dobëson imanin me gjynahe dhe vdes me atë iman, do të shpëtojë nga vuajtjet në ahiret. Ka disa rrugë të mashtrimeve që e zgjidhin dhe dobësojnë këtë nyje. Ato janë bidatet. Por ka edhe mënyra për ta mbrojtë zemrën nga këto bidate dhe për ta forcuar imanin në zemër, e kësaj i thuhet *dituri e kelamit (ilm'ul-kelam)*. Ai që i njeh këto dituri quhet *mutekellim*. Qëllimi i tij është t'i kundërshtojë bidatxhitë të cilët dëshirojnë ta dobësojnë imanin në zemrat e njerëzve të rëndomtë. Ai quhet edhe *muvaḥhid* sepse e mbron kuptimin e drejtë të shprehjes së tevhidit në zemrat e njerëzve të rëndomtë nga sherri i badtxhive, dhe e përforcon imanin e tyre.

Edhe i treti quhet *muvaḥhid*. Atij e vërteta (*hakk*) i shfaqet e tillë çfare është; ai sheh vetëm një Krijues pa e detyruar zemrën që ta besojë kuptimin e hakikatit. Ky është imani dhe tehvidi i njerëzve të rëndomtë dhe kelamxhive, sepse tevhidi mes tyre nuk dallon, pos që kelamxhiu edhe i largon mashtrimet e bidatxhive.

E i katërti është *muvaahhid* i cili nuk sheh asgjë tjetër përpos Një, i cili ‘të gjithën’ nuk e sheh përmes shumësisë së saj, por përmes njëshmërisë së Tij. Ky është qëllimi më i lartë në tevhid.

I pari është si lëvozhga e jashtme e arrës, që nuk ka ndonjë dobi, sepse është e hidhur kur hahet e kur e shikon nga brenda, është e shëmtuar. Nuk përdoret as si lëndë djegëse, sepse e fikë zjarrin dhe vetëm sa e shton tymin. Nëse lihet brenda në shtëpi, vetëm se zë vend. Ka vlerë vetëm për aq kohë sa do të mbrojë arrën, e më pas hidhet. Kështu është edhe grada e parë e tevhidit që shqiptohet vetëm me gjuhë, e pa bindje në zemër. Është i padobishëm dhe sjell dëm brenda, e nga jashtë është i shëmtuar. Megjithatë, është i dobishëm për aq sa e ruan lëvozhgën e brendshme, deri sa të shkatërrohet. E lëvozhgë e brendshme janë zemra dhe trupi.

Tevhidi i mynafikut e mbronë trupin e tij nga shpata e gaziut,¹⁰ sepse gaziu nuk është urdhëruar ta çajë zemrën e tij dhe të shikojë çfarë ka brenda. Zaten, shpata prenë pjesën e jashtme. Mynafiku nga kjo përfiton deri në vdekje. Por kur vdes, nga tevhidi i tij nuk mbetet kurrfarë dobie.

¹⁰ *gazi*: ai që lufton me armiq; i kthyer gjallë nga lufta si fitimtar.

Lëvozhga e brendshme ka vlerë më të madhe se sa lëvozhga e jashtme sepse e mbron thelbin, e kur të ndahet nga thelbi mund të përdoret për djegie, por është me vlerë më të vogël se thelbi. Njëjtë edhe dëshmimi i besimit me zemër pa keshf ka më shumë dobi se sa shqiptimi i thjeshtë, pa dëshmi.

Kjo dobi nga *lëvozhga e brendshme* është më e vogël në krahasim me *thelbin* - me zgjerimin e gjoksit nga nuri i Allahut që shkëlqen në të, kur imani i mbështetet në myshahede dhe keshf.

Ky zgjerim është qëllimi i këtyre ajeteve:

“Atë që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për Islamin.” 6-Enamë: 125,

si edhe:

“Atij që Allahu ia ka zgjeruar kraharorin për besimin islam, ai është në një dritë (nur) të sigurt prej Rabb-it të vet.” 39-Zumer: 22

Thelbi, i cili çmohet më shumë se lëvozhga dhe është më me vlerë se ajo, nuk shpëton nga *“përlyerja”* (përzierja e gjërave të tjera), gjatë shtrydhjes së yndyrës së tij.

Njëjtë, edhe tevhidi në veprim është qëllim më i lartësuar i udhëtarit shpirtëror, por nuk është i çliruar nga “përljerja” me tevhidin e gjuhës dhe me kthim kah shumësia në krahasim me atë i cili nuk sheh asgjë tjetër pos të Vetmin, të Vërtetën (*Vahidi Hakk*).

Mund të pyesësh: *Si mund të paramendohet që personi sheh vetëm Një, e në të njëjtën kohë ai e sheh qiellin, Tokën dhe shumë trupa tjerë fizikë, Si mundet shumësia të jetë një?*; atëherë dije se kjo është pika e fundit e diturisë mukashefe. Të fshehtat e kësaj diturie nuk lejohet të shkruhen në libër. Arifët thonë: “*Është kufr të shpallet fshehtësia e rububijetit.*” Ajo nuk ndërlidhet me diturinë muamele. Megjithatë, ajo mund të shpjegohet, sa për ta larguar mendimin tënd se kjo është e pamundur:

Varësisht mënyrës së vrojtimit, diçka mund të jetë nganjëherë e shumtë, e nganjëherë tek. Për shembull, nëse i mendon të gjitha pjesët e një personi veç e veç, kjo bëhet shumësi, por nëse e mendon atë person si njeri, ai bëhet një. Siç është njeriu shumësi kur shikojmë shpirtin, trupin, gjymtyrët, arteriet, eshtrat dhe lukthin e tij, ai gjithashtu është një njësi e vetme. Shumë njerëz, kur e shohin njeriun, e shohin si një dhe nuk i japin vëmendje pjesëve të tij të shumta.

Gjithçka në ekzistencë ka shumë komponente në vete, të ndryshëm mes vete. Sipas njërit prej këtyre komponenteve diçka konsiderohet si një, e sipas të gjithë komponenteve tjerë ajo është shumësi, e disa shumësi janë më të shprehura se tjerat. Shembulli i njeriut, ani pse jo plotësisht i përshtatshëm për qëllimin tonë këtu, tregon se si shumësia shihet një. Kjo të bën të kuptosh se duhet ruajtur nga mohimi i gradës që nuk e ke arritur, dhe se duhet besuar në të. Meqenëse ti beson në atë tevhid për të cilin flet, për këtë do të kesh edhe sevap, përshtatshëm besimit tënd, ani pse kjo në çka ti beson nuk është cilësi dhe gradë e jotja, sikur kur beson në peygamberllëk edhe pse nuk je peygamber, e do të kesh sevap.

Kjo gjendje, ku shihet vëtëm Një, nganjëherë vazhdon e nganjëherë lajmërohet si vetëtimë dhe largohet, e në të shumtën e rasteve është e tillë. Gjendja e vazhdueshme është më e rrallë. Pikërisht për këtë fliste Husejn ibn Mensur el-Hallaxh, kur e pa Havvasin, që ka qenë nga ata që mbështeteshin shumë në Allahun e si gjithmonë ishte në udhëtim, dhe e pyeti:

- *Pse udhëton?*; në çka Havvasi u përgjigj:
- *Për ta rregulluar gjendjen time në tevekkul*;
- në çka Hallaxhi i tha:

- *Po e harxhon jetën në rregullimin e të brendshmes. Ku është aty zhdukja (fena) në tevhid?!*

Përderisa veprimi i Havvasit ishte drejt përmirësimit të gradës së tretë të tehvidit të tij, Hallaxhi po e ftonte në gradën e katërt. Shkurtas, kjo është grada e muvahhidit në tehvid.

Nëse ti thua se kjo gradë duhet të shpjegohet së paku aq sa të mund të kuptohet tevekkuli në këtë gradë, atëherë do të them se për gradën e katërt të tehvidit nuk është xhaiz të shpjegohet, e as tevekkuli nuk ndërtohet në këtë gradë. Gjendja e tevekkulit shfaqet në gradën e tretë të tehvidit.

Grada e parë është tevhidi i mynafikut; kjo është e vetëkuptueshme, e sa për gradën e dytë, ajo është besim (*itikad*), dhe kjo ekziston te të gjithë myslimanët. Ajo forcohet me dituritë e kelamit. Kelami përfshinë edhe refuzimin e bidatxhive. Më të rëndësishmet i kemi përmendur në librin ***‘El-Iktisadu Fi’l-i’tikad.’*** Grada e tretë është grada ku ndërtohet tevekkuli, sepse vetëm besimi me tehvid, nuk krijon gjendje të tevekkulit. Prandaj, pa hyrë në detaje, ta shpjegojmë vetëm ndërlidhjen e tevekkulit me këtë tevhid. Zaten, një libër i këtillë edhe nuk mund të përfshijë detajet e tij.

Përmbledhje e shkurtë: duhet të dihet se nuk ka tjetër krijues përpos Allahut Teala, dhe se Ai nuk ka ortak në krijimin dhe bërjen e riskut, dhurimit, privimit, jetës, vdekjes, pasurisë, varfërisë, dhe gjithçkaje tjetër që bartë një emërtim të caktuar. Kur kjo gjendje të t'zbulohet ty, atëherë nuk do të shikosh dikë tjetër, pos Tij. Vetëm prej Tij do të frikësohesh, tek Ai do t'i mbash shpresat, nga Ai do të marrësh forcë dhe te Ai do të mbështetesh. Ai është *fail* (bërës; veprues) i vërtetë, askush tjetër. Gjithçka është nën urdhrin e Tij. Pa vullnetin e Tij askush nuk mund të lëvizë një grimcë. Kur të të hapen dyert e fshehtësitë shpirtërore (*mukashefe*), ky realitet do të shfaqet më qartë se sa ajo që e sheh me sy.

Shejtani të pengon nga ngritja në këtë gradë të tehvidit ashtu që mundohet të fus shirk në zemër, përmes dy shkaktarëve:

- a) dhënia rëndësi zgjedhjes e vullnetit të krijesave;
- b) dhënia rëndësi materies '*jo të gjallë*'.

Dhënia rëndësi materies '*jo të gjallë*', është sikur mbështetja jote në shiun, që të mbjellat të mbijnë e të zhvillohen, mbështetje në re se do të jepnin shiun, në të ftohtit që retë të mblidhen, në erë që anija të lundrojë.

E gjithë kjo është shirk në tevhid dhe padituri për esencën e gjërave. Prandaj Allahu Teala thotë:

“Kur hipin në anije, ata i luten Allahut me devotshmëri të sinqertë, por kur Ai i sjell në tokë shëndoshë e mirë, menjëherë ata i veshin Atij ortakë.”

29-Ankebut: 65

Thuhet se një nga kuptimet e këtij ajeti është se ata thanë: *“Nëse nuk pushon stuhia, nuk do të shpëtojmë”*, kështu që shirku i tyre ishte që e lidhën shpëtimin e vet me ndaljen e erës.

Ai, të cilit bota i shfaqet ashtu siç është, ai e di se era është ajër e nuk lëviz vetvetiu, nëse nuk e lëvizë diçka tjetër. Njëjtë është edhe me diçka që e vë ajrin në lëvizje, dhe kështu radhazi. Kjo vazhdon deri te Lëvizësi i Parë (*Muharrik*), i Cili nuk ka lëvizës e as që ka nevojë për lëvizje. Ai është *Aziz* dhe *Xhelil*. Ai që beson se era e shpëton nga deti, është si ai që do t'i prehet qafa, e sundimtari jep dekret për faljen e tij dhe e lëshojnë, e ky fillon të flasë për penën e letrën ku është shkruar dekreti, e thotë: *“Po të mos ishte pena e letra, nuk do të shpëtoja!”*

Ky shpëtimin e vet e sheh te pena e letra, jo te ai që e mbanë penën, e kjo nuk është tjetër pos kulm i injorancës.

Kush e di të vërtetën, e di se pena nuk shkruan vetvetiu, por i është nënshtruar dorës së shkruesit, dhe ai nuk e falënderon penën, por do ta falënderojë shkruesin. Bile, prej gëzimit që ka shpëtuar, aq hutohet sa që nuk di se si ta falënderojë sundimtarin dhe shkruesin, e pena dhe letra as nuk i vijnë ndërmend. Dielli, Hëna, yjet, shiu, retë, Toka, të gjitha kafshët dhe mineralet, të gjallë dhe jo të gjallë, janë nën urdhrin e Allahut, siç i është nënshtruar pena dorës së shkruesit. Kjo le të shërbejë si simbol për ty, sepse ti mendon që sundimtari e ka shkruar dekretin për faljen.

E vërteta është se shkrues është Allahu Teala:

“... ti nuk i gjuajte (në të vërtetë) kur i gjuajte ata, por Allahu i gjuajti...” 8-Enfal: 17

Kur ti e di se krejt çka është në qiej e Tokë janë të nënshtruara Allahut Teala, shejtani largohet nga ti i dëshpëruar dhe e humbë shpresën nga përzierja e tevhidit tënd me këtë lloj shirku. Por, ai kthehet te ti me shkaktarin tjetër që e përmendëm - dhënia rëndësi zgjedhjes e vullnetit të krijesave, e të thotë: *Ku po e sheh ti që gjithçka është prej Allahut? Filani po të jep furnizim me vullnetin e vet, ashtu siç ai vet do; ose ta jep atë furnizim, ose ta ndalë. Ai mund të ta këpus kokën me shpatën e tij; Ai ka forcë mbi ty; nëse do ta këput kokën,*

nëse do të kursen. E si të mos i frikësohesh e të mos mbashë shpresë te ai, kur fati yt është në duart e tij?! Ti këtë po e sheh, nuk mund të dyshosh. Dhe natyrisht, nuk e sheh penën sepse është e nënshtruar, por si nuk e sheh shkruesin, të cilit pena i nënshtrohet?!

Këtu ju rrëshqitën këmbët shumicës, përpos robëve të singertë të Allahut, ata mbi të cilët shejtani i mallkuar nuk ka kurrfarë autoriteti. Me nurin e basiretit ata edhe shkruesin e shohin të nënshtruar, që vepron pasi që është i obliguar.

Nga ana tjetër, të gjithë të dobëtit e shohin penën si të nënshtruar ndaj shkruesit. Ata e kuptojnë se gabimi i tyre është si gabimi i buburrecit për shembull, që ecë nëpër letër dhe e sheh majën e penës si rrëshqet nëpër letër, e nuk e ngrehë shikimin te dora e gishtat, e lëre më te vet shkruesi. Buburreci gabon sepse do të mendojë se pena vetvetiu i lë gjurmët e zeza në prapavijën e bardhë. Shikimi i tij është i kufizuar për shkak të mangësisë në bebëzën e syrit. Njëjtë është edhe me njeriun, kur gjoksi i tij nuk është i zgjeruar me nurin e Allahut për Islam, ai nuk mund të vrojtojë të Gjithëfuqishmin, Mbizotëruesin ndaj qiejve e Tokës. Rruga e tij ngritet vetëm deri te shkruesi dhe aty mbetet, e kjo është plotësisht padituri.

E ata që posedojnë dituri dhe basiret, Allahu Teala me Fuqinë e Tij bën që atyre t’ju flasë secili atom në qiej e në Tokë. Këta dëgjojnë se si secili atom e lavdëron dhe falënderon Allahun Teala dhe si dëshmojnë pafuqinë e vet, me gjuhën e tyre të qartë, pa germa e pa zë. Këtë nuk e dëgjojnë vetëm ata që janë të privuar nga dëgjimi shpirtëror. Nuk po mendojmë në dëgimin e zërit e tingullit. Me këtë nuk dallon nga gomari. Fjalën e kemi për dëgimin e të folurit që bëhet pa germa e pa zë.

Nëse ti thua: *Kjo është e çuditshme, mendja po e kundërshton logjikën, na shpjego mënyrën se si flasin ato atome, me çka flasin, si lavdërojnë, si falënderojnë dhe si dëshmojnë pafuqinë e vet*; dije se secili atom në qiej dhe Tokë, si edhe poseduesit e basiretit, kanë lutjet e tyre të fshehta. Kjo nuk ka fund. Këto janë fjalë që merren nga oqeani i të folurit të Allahut Teala, që nuk përfundon.

Thuaj: "Sikur të ishte deti ngjyrë për t'i shkruar fjalët e Rabbit tim, deti (uji i tij) do të shterej para se të përfundojnë fjalët e Rabbit tim, e edhe sikur të sillnim shtesë edhe një si ai (deti)." 18-Kehf: 109

Ata bisedojnë me sekretet e botës së dukshme (*mulk*) dhe padukshme (*meleket*), e tregimi i sekretit nuk lejohet.

Zaten, gjoksat e njerëzve të pastër janë varre të sekreteve. A e ke parë ndonjëherë njeriun e besueshëm me sekretet e sundimtarit, e ky t'i tregojë publikisht para të gjithëve? Nëse do të ishte e lejueshme të tregojmë çdo fshehtësi, Resulallahu s.a.v.s., nuk do të thoshte:

“Sikur ta dinit atë që unë e di, pak do të qeshnit, e shumë do të qanit.”¹¹

Sikur t’ju tregonte atë që e dinte, ndoshta edhe do të qanin shumë. Resulallahu s.a.v.s., duke na ndaluar tregimin e sekretit të kaderit, thotë:

“Kur të përmendet caktimi (*kader*) heshtni, kur të përmenden yjet (astrologjia), heshtni, dhe kur të përmenden as’habët e mi, heshtni.”¹²

Gjithashtu, as Huzejfe r.a., nuk do të zgjedhej prej të tjerëve që të nderohet me disa sekrete.

¹¹ Hadithi është përmendur disa herë.

¹² Taberani nga Ibn Mesudi

Domethënë, ekzistojnë dy pengesa që poseduesit e basiretit nuk i tregojnë lutjet e grimcave nga bota e dukshme dhe e padukshme:

1. Ndalimi i tregimit të sekretit, dhe
2. Fjalët e tyre janë aq shumë sa nuk mund të numrohen.

Por, të kthehemi te shembulli i parë, me penën. Do të themi diçka për të folurit e tyre, vetëm aq sa të kuptohet e përmbledhur mënyra e ndërtimit të tevekkulit në ato gjëra.

Të folurit e atyre do ta paramendojmë përmes germave e zërave, ani pse nuk manifestohet me to. Por kjo do të jetë e domosdoshme, për ta kuptuar. Pra, dikush që e shikon letrën me dritën (nur) që ia dhuroi Allahu Teala, duke parë fytyrën e letrës të nxirë me bojë, e pyet:

- *Çfarë ndodhi me fytyrën tënde? Ishte e bardhë dhe e ndritshme, e tash në të u lajmërua nxirje? Pse u nxi? Çka e shkaktoi këtë?*”; e letra i përgjigjet:

- *Bëhu i kuptueshëm, nuk ia nxiva unë vetes fytyrën! Pyet ngjyrën! Ajo ishte në shishen e saj, pushonte në shtëpinë e vet, e përnjëherë mori rrugë, erdhi e u përhap në fushën e fytyrës time, e ma nxiu fytyrën.*

Personi tha: *“Kjo të vërtetën e tha”*; e pastaj e pyeti ngjyrën, e ngjyra i tha:

- *Bëhu i kuptueshëm, unë isha në shishen time, e shtrirë dhe e qetë, e besoja se përgjithmonë do të mbetem aty. Atëherë pena mu vërsul, më nxorri nga shtëpia ime, më përhap gjithandej, siç po e sheh, nëpër një farë fushe të bardhë. Nuk është faji im. Pyete penën, jo mua! Personi i tha ngjyrës:*

“Të vërtetën e thua!”, e iu kthye penës dhe i tha:

- *Pse bërë padrejtësi, e nxorre ngjyrën prej shtëpisë së saj, dhe e përhape mbi letër të bardhë duke e nxirë letrën. Pena tha:*

- *Pyete dorën e gishtat! Isha veç një kallam që rritej breg një lumi, e kënaqesha në gjelbrim. Atëherë u lajmërua dora me thikë, ma rrjepi lëvoren e m'i shqeu rrobat. Më preu rrënjët, mi ndau fijet, më mprehi, e kokën ma shpoi, e pastaj më futi në të zezën e ngjyrës dhe më drejtoi me majën e kokës sime mbi letër. Me pyetjen tënde vetëm hodhe kripë në plagën time. Largohu prej meje, e pyt atë që më solli në këtë gjendje.*

Personi tha: *“Të vërtetën e tha”*; e atëherë e pyeti dorën për zullumin dhe armiqësinë e saj ndaj penës dhe përdorimin e saj, në çka dora i tha:

- Unë nuk jam tjetër pos asht, mish e gjak. A ke parë ti mishi të bëjë zullum, apo një trup të lëvizë vetvetiu?! Unë jam si një kalë në dorën e kalorësit, e kalorësi quhet fuqi. Ai udhëheq me mua dhe më dërgon nëpër vende të ndryshme. A nuk i sheh arat, gurët e drunjtë; asnjëri prej tyre nuk e braktisë vatanin e vet, e as nuk lëvizin vetvetiu, sepse asnjërin prej tyre nuk e kalëron një kalorës i tillë i fuqishëm! A nuk e sheh se dora e të vdekurit është krejt e njëjtë si unë, me mish, eshtra e gjak, e me penën nuk kam asnjë lidhje. Për gjendjen time, pyet fuqinë. Unë jam vetëm një kali, të cilin e shqetëson ky që po e kalëron.

Personi i tha: “Të vërtetën e thua”, e atëherë e pyeti fuqinë për arsyen e saj që e shfrytëzon ashtu dorën, në çka fuqia i tha:

- Mos më qorto mua! Sa ka të tillë që qortojnë, e vet janë të qortuar, dhe sa ka të qortuar, e që nuk kanë faj! Si nuk e kupton gjendjen time?! Si mund të mendosh se unë po i bëj padrejtësi dorës? Unë isha në dorë para se ajo të lëvizë, por as nuk e lëviza unë, as nuk e nënshtrova! Isha në gjumë, aq i qetë sa që menduan se jam i vdekur a që fare nuk ekzistoj, sepse as nuk lëvizja vet e as që lëvizja dikë. Ndërkohë erdhi një përfaqësues, ai më zgjoi dhe më detyroi të bëj punët që i shihni. Unë kam fuqinë të bëj atë që thotë ai, e nuk kam fuqi të

kundërshtoj. Ai përfaqësues quhet Vullnet. Unë e njoh atë vetëm me emër dhe përmes sulmit të tij. Ai më zgjoi nga gjumi i thellë e më shqetsoi, më bëri të bëj gjërat që i patë. Pyete atë për gjendjen time, jo mua.

Personi prapë tha: “Të vërtetën e tha”, e atëherë iu kthye vullnetit dhe pyeti:

- Çfarë të shtyri që këtë fuqi të qetësuar e të heshtur ta sjellësh në gjendje të veprimit e ta nënshtrosh, sa tash ajo as s’ka shpëtim?;

Vullneti tha:

- Mos u ngut, prit pak. Ndoshta edhe unë kam ndonjë arsyetim, e ti po më qorton. Unë nuk lëviza vetvetiu, por u lëviza nga një forcë që më sundoi me një urdhër të vendosur. Para ardhjes së kësaj force unë isha i qetë, por prej zemrës më erdhi lajmëtari i dijes dhe më urdhëroi me gjuhën e mendjes të aktivizoj fuqinë time. Kështu i detyruar, u shfaq. Unë jam i shkretë, i nënshtroar forcës dhe diturisë. Isha në qetësi, deri sa nuk u lajmërua ai nënshtroes trim e vendimmarrës. Qoftë ai i drejtë apo jo, unë jam nën urdhrin e tij. Çfarëdo që të vendosë ai, unë nuk kam fuqi ta kundërshtoj. Të jesh i sigurt, deri sa ai është i zënë me veten, edhe unë jam i qetë, por pres vendimin e tij. E kur ai merr vendimin, sipas natyrës dhe forcës time më

duhet t'i nënshtrohem, e kështu vjen në shprehje forca me të cilën zbatohet vendimi i tij. Për gjendjen time ti pyete diturinë dhe mos më qorto më, sepse unë jam siç tha poeti:

*Kur dëshirova të ikë nga një shoqëri,
E ata me këtë e pajtuan -
atëherë e dija se në të vërtetë,
ata vet ishin që u larguan.*

Personi tha: “*Të vërtetën e tha*”; e atëherë iu drejtua diturisë, mendjes e zemrës, duke kërkuar nga ta shpjegim e duke i qortuar për zgjimin e vullnetit dhe detyrimin që ai të shfaqë fuqinë.

Mendja tha: “*Unë jam një dritë, por unë nuk shkëlqej vetvetiu. Mua më ndezë dikush tjetër, pastaj unë shkëlqej*”;

zemra tha: “*Unë jam një fletë (levha) që nuk hapem vetvetiu; dikush tjetër më hap*”;

e dituria tha: “*Unë jam një qëndisje; kur drita e mendjes të shkëlqejë në bardhësinë e zemrës, unë qëndisem aty. Unë nuk mundem të qëndisem vetvetiu aty, sepse për të shkruar në zemër, kishte nevojë për penën. Mua aty pena më qëndisi. Pyet penën për gjendjen time, sepse shkrimi bëhet vetëm me penë.*”

Atëherë ky që pyeste u tërhoq, i pakënaqur, e tha:

- U lodha në këtë rrugë. Kalova aq shumë nivele, dhe prej cilit do që kërkoja ta mësoj të vërtetën, ai më dërgonte te tjetri. Por, të gjitha me kënaqësi i dëgjova. Nga secili dëgjoja fjalë të arsyeshme. Oj dituri, nga fjalët tua “unë jam vetëm një qëndisje - një shkrim, më shkruan pena”, unë nuk pa kuptoj asgjë. Sepse unë e njoh penën prej kallamit, fletën (levha) prej drurit ose metalit, shkrimin me bojë, dritën nga flaka e zjarrit, e këtu po dëgjoj fjalë si “fletë”, “dritë”, “shkrim” e “penë”, por nuk po e shoh asnjërën nga to. Dëgjoj zhurmën e mullirit, por nuk shoh miell.¹³

Në këtë, dituria i tha:

- Nëse vërtet kështu e kupton, atëherë nuk je pajisur me njohuri të thella, furnizimin e ke të pamjaftueshëm e mjetin e transportit e ke të dobët. Rrugës që je nisur fshihen shumë rreziqe. Më mirë të kthehesh e lëre këtë dëshirë. Nuk është për ty. Lëre! Kjo rrugë është për ata që janë krijuar për këtë rrugë. E nëse ti prapë dëshiron të shkosh deri në fund, dëgjo mirë dhe dije se në këtë rrugë janë tri botë:

E para është **alemi mulk** dhe **shehadet** (bota e dukshme). Letra, boja, pena, dora që ti i njeh janë nga kjo botë. Ti i kalove këto më lehtësi.

¹³ Proverb arab.

*E dyta është **alemi melekut** (bota e fshehur). Kjo botë është pas meje. Kur të më kalosh mua, do ta arrish atje. E aty ka shkretëtirë të gjerë, male gjigante e dete tepër të thella. Nuk e di si do të shpëtosh nga aty.*

*Dhe e treta është **alemi xheberut** (bota e fuqisë), që gjendet në mes të botës së mulkut dhe asaj të melekutit. Ti i kalove tri nivelet e para të kësaj bote, atë të fuqisë, vullnetit dhe dijes. Këto janë mjete mes botës së dukshme (mulk) dhe asaj të fshehtë (melekut). Rruga e botës së mulk-ut është e lehtë, por bota e melekutit është e vështirë. Bota xheberut, qëndron mes këtyre dyjave si një barkë në lëvizje mes tokës e detit; as nuk lëviz mbi ujë e as nuk pushon lëvizja në tokë. Ai që ecë nëpër tokë, ecë në botën e materies (mulk). Nëse mbledhë fuqi, ngjitet në anije dhe lundron me të, do të jetë sikur ai që ecë nëpër botën e xheberutit. Por, vetëm kur arrinë të ecë mbi ujë, pa anije, atëherë ai ecë në botën e melekutit. (do të thotë se ecja në ujë pa anije është e nevojshme për të kuptuar fshehtësinë e brendshme të kësaj pune). Nëse nuk mund të ecësh mbi ujë, kthehu! E kalove Tokën dhe e le anijen prapa. Para teje ka vetëm ujë të pastër. E kur e sheh penën me të cilën shkruhet dituria në fletën (levha) e zemrës, para fillimit të botës së melekutit, me të cilën ecet mbi ujë, atëherë fitohet jekini. A nuk ke dëgjuar që Resulallahu s.a.v.s., për Isanë a.s., ka thënë:*

“Po ta kishte jekîn edhe më të fortë, do të ecte edhe mbi ajër.”¹⁴

Personi që hyri në këtë rrugë shpirtërore, tha:

- *Tash u hutova! Nga rreziqet e rrugës që e përshkrove, në zemër më lindi frikë. Nuk jam i sigurt a mundem të kaloj nëpër ato hapësira të gjera e të rrezikshme që m'i përshkrove. A ka ndonjë mënyrë që t'i kaloj këto pengesa?; e dituria i tha:*

- *Po, ka. Hapi sytë, e më shiko me kujdes. Nëse të shfaqet pena me të cilën unë shkruaj në fletën e zemrës, mund të ndodhë që je i denjë për këtë rrugë. Kush e kalon botën e xheberutit dhe troket në një nga dyert e melekutit, në fillim e sheh penën. A nuk e sheh që Resulallahut s.a.v.s., qysh në fillim iu shfaq pena, kur i zbriti ky ajet:*

“Lexo! Rabbi yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte. (96: 3-5)?

Udhëtari shpirtëror atëherë tha:

- *I hapa sytë, e prapë nuk shoh kallamë e as dru. Unë e njoh penën vetëm prej tyre; e në këtë, dituria i tha:*

¹⁴ Hadithi tashmë është përmendur.

- Ti po ikë prej asaj që e kërkon! A nuk e di ti se plaçkat e shtëpisë i përgjajnë pronarit të shtëpisë?! Dhe se Dhati (Qenia) e Allahut Teala nuk i përngjanë qenieve tjera?! As dora e Tij nuk i përngjanë duarve tjera, as Pena e tij penave tjera, as të folurit e Tij të folmes që ti e njeh, as shkrimi i Tij shkrimeve tjera. Këto gjëra hyjnore i takojnë botës së melekutit. Allahu Teala në Dhatin e Tij nuk është materie, nuk është i kufizuar në një vend, për dallim prej të tjerëve. Dora e Tij nuk është nga mishi, ashti e gjaku, për dallim prej duarve tjera; Pena e Tij nuk është nga kallami, as levha e Tij nuk është nga druri; të folurit e Tij nuk është me tinguj e germa; shkrimi i Tij nuk është formë dhe numra, e as ngjyra e Tij për shkrim nuk është ngjyra që ti e njeh. Nëse nuk i vështrohet kështu, unë të shoh pos si dy-gjinor, në mes të mashkullit e femrës; luhatesh mes dyjave, e nuk përket në asnjërën anë. Ti e ndave Dhatin (Qenien) dhe cilësitë e Allahut Teala nga qeniet dhe cilësitë tjera, e ndave të folurit e Tij nga zërat e germat! Tani pa heziton për dorën e Tij, penën, levhen dhe shkrimin e Tij. Nëse nga fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

“Allahu e krijoi Ademin sipas pamjes së Vet”,
ti kupton pamjen e dukshme që shihet me syrin fizik, pa dyshim bëhesh myshebbihe.¹⁵ Edhe çifutit i është thënë:

¹⁵ Ai që thotë (mendon) se Allahu është i ngjashëm njeriut; antropomorfizëm.

“Nëse bëhesh një çifut i drejtë e i pastër - bëhu, përndryshe mos luaj me Tevrat”! Nëse e ke kuptuar pamjen e brendshme nga hadithi, e që shihet me basiret (syrin e zemrës), e jo me besar (syrin fizik), atëherë thuaj: “Subhanallah” dhe vazhdo rrugën. Sepse ti je në luginën e shejtë. Nga thellësia e zemrës dëgjo çfarë po të zbulohet. Shpresohet se pranë zjarrit do të gjesh një udhëzues¹⁶ dhe se nga perdja e Arshit do të thirresh ashtu siç u thirr Musa a.s.:

“Vërtet Unë jam Rabbi yt...” (20-Ta Ha: 12).

Kur i dëgjoi këto nga dituria, udhëtari shpirtëror i kuptoi të metat e veta dhe e kuptoi se ka mbetë mes myshebbihe dhe përkryerjes. Sapo e kuptoi gabimin e vet, nga mërzia, zemra iu dogj si zjarr e dha flakë.

Vaji në llambën e zemrës së tij do të jepte dritë thuajse edhe pa zjarr, por kur fryu dituria në këtë zemër, vaji i nxehur aty u ndez menjëherë, dhe u bë dritë mbi dritë. Atëherë dituria i tha:

- Tash shfrytëzoje këtë mundësi! Hapi sytë! Ndoshta nga zjarri të shfaqet udhëzimi!

¹⁶ Aluzion në tregimin në Kur'an për Musanë a.s., kur me familjeu nis te faraoni, e mbërrijti në Sina.

Ai i hapi sytë dhe me dritën e zjarrit, e pa penën hyjnore. Ishte pikërisht e tillë çfarë e kishte përshkruar dituria, as nga druri, as nga kallami, pa majë e pa bisht, pandërprerë shkruan në zemrat e njerëzve, lloj-lloj diturish. Kjo penë, edhe pse vet pa maje, në secilën zemër e ka një majë. Personi, i habitur nga kjo, tha:

- Dituria është mik i mirë, Allahu e shpërbleftë. Tani m'u shfaq e vërteta e cilësive të penës e që m'i kishte shpjeguar dituria. Tani e shoh si penë, ani pse nuk përngjanë në penat tjera.

Iu falënderua diturisë, e në ndarje i tha:

- Shumë gjatë qëndrova me ty, dhe kërkova shumë prej teje. Tash e kam nijet të shkoj te pena e ta pyes për gjendjen e saj.

Kur arriti te pena, i tha:

- Oj penë, përse vazhdimisht shkruan në zemra të njerëzve, e me këtë nxit vullnetin që ta shfaqë kaderin?; e pena nga bota e melekutit i tha:

- Shpejt harrove çfarë tha pena nga bota e dukshme (mulk). Edhe përgjigja ime është si përgjigja e saj. Udhëtari shpirtëror tha:

- Si ashtu, ti nuk i përngjanë asaj?; e pena tha:

- A nuk ke dëgjuar që Allahu Teala e krijoi Ademin a.s., sipas pamjes së Vet? Udhëtari shpirtëror tha:

- *Po, kam dëgjuar, e pena tha:*

- *Atëherë për gjendjen time ti pyet Sundimtarin, që me dorën e Tij të djabathtë më lëviz vazhdimisht. Unë jam nën urdhrin e Tij. Nuk ka dallim mes penës hyjnore dhe penës së njeriut, pos dallimit në formë, që është i dukshëm. Udhëtari shpirtëror pyeti:*

- *Kush është dora e djabathtë e kësaj gjithësie?; e pena tha:*

- *A nuk e ke dëgjuar ti ajetin:*

“Edhe qiejt janë ngritur me dorën e djabathtë (forcën) të Tij” (39-Zumer: 67)?

- *Po, e kam dëgjuar, u përgjigj ky, e pena tha:*

- *Si gjithçka, edhe pena është në dorën e Tij. Ai e drejton penën si të dëshirojë.*

Pas këtyre fjalëve, udhëtari shpirtëror shkoi drejt dorës, bile edhe e pa. Te ajo pa edhe më shumë mrekulli, se sa te pena. Përshkrimi i tyre nuk lejohet. Zaten, përshkrimin e tyre nuk mund ta mbajnë as njëmijë vëllime. Si përmbledhje e shkurtër: Ajo është e *Djabathta*, por jo si të djabattat; dora e Tij nuk është si duart; gishti i Tij, nuk është si gishtat. Me të vërtetë, personi shikoi si po lëviz pena në dorën e Tij, dhe atëherë e kuptoi arsyetimin e penës. Kësaj here udhëtari e pyeti dorën pse po e lëviz penën, e dora nga bota e melekutit i tha:

- Përgjigja ime është e njëjtë me përgjigjen e dorës nga bota e dukshme që të drejtoi te forca; sepse dora vetvetiu nuk mund të bëj asgjë. Pa dyshim forca vë në lëvizje dorën.

Udhëtari shpirtëror u nis drejt botës së forcës. Kur i pa mrekullitë aty, mrekullitë që i kishte parë më herët mbetën të pavlera. Udhëtari shpirtëror e pyeti forcën për sebin e lëvizjes së dorës:

- Pse e vë në lëvizje dorën?; e forca i tha:

- Unë jam vetëm cilësi. Pyete të Plotfuqishmin (Kadir)¹⁷! Esenca është te bartësi i cilësisë, jo te cilësia.

Në atë moment, i hutuar, udhëtari shpirtëror guxoi të pyes të Plotfuqishmin për gjendjen, e pas perdes iu përkujtua ajeti:

“Ai nuk mund të pyetet për atë që punon, kurse ata (njerëzit), do të pyeten.” (21-Enbija: 23),
dhe madhështia hyjnore e mbështolli, e i ra të fikët.

Kur erdhi në vete, tha:

- Subhanallah! Sa madhështor që je Ti! Më fal gabimin, pendohem te Ti, tek Ti mbështetem, besoj se Ti je Mbizotëruesi ndaj çdo gjëje, i Vetmi, që sundon

¹⁷ **EL-KADIR** - i Plotfuqishëm; Fuqia e të Cilit nuk mund të krahasohet. Me fuqinë e Tij ka krijuar të gjitha krijesat.

gjithçka! Vetëm Ty unë të frikësohem. Vetën Ty të dëshiroj! Nga ndëshkimi Yt - kërkoj strehim tek Ti, nga zemërimi Yt - kërkoj rizanë Tënde! E imja është vetëm që të lutem Ty, që të kërkoj prej Teje, të strehohem tek Ti, e them: “Bëje gjoksin tim të gjerë, që të njoh Ty! Zgjidhe nyjen nga gjuha ime që të lavdëroj Ty, të falënderoj Ty!”

Atëherë, pas perdes dëgjoi duke iu thënë:

- Mos të të kaplojë dëshira se mund të lavdërosh më tepër se sa lëvdërimi i zotërisë së peygamberëve, Muhammedit, s.a.v.s.. Ktheju atij, bëj atë që ai ka porositur, largohu nga ajo që ai ta ndalon, çfarëdo që ai të tha edhe ti thuaje. Sepse ai, a.s., nuk tha tjetër, përpos:

“Subhaneke la uhsi sena’en alejke, ente kema esnejte ala nefsike”, (Allahu im, Ti je pa të meta, unë nuk jam i denjë të të lavdëroj Ty ashtu siç Ti vet e Lavdëron Vetën)¹⁸, prandaj edhe ti thuaj kështu.

Atëherë udhëtari shpirtëror tha:

- O Allah, po nëse gjuha nuk ka aftësi të lavdëroj Ty, a mundet atëherë zemra të të njohë?; e pas perdes i thuhet:

¹⁸ Hadithi tashmë është përmendur.

- *Kujdes të mos kalosh kufijtë e siddikëve (robëve të sinqertë)! Drejtoju siddikut më të madh (Ebu Bekir), përshatju atij, sepse ata janë as'habët e pejgamberit. As'habët e pejgamberit janë si yje, cilit do t'i përshtatesh udhëzohesh në rrugë të drejtë. A nuk dëgjove kur Siddiki Ekber ju tha: "Njohja më e madhe është njohja e pamundësisë për të arritur njohjen." Nga grada jonë të mjafton ta dish se je i pafuqishëm të shohësh bukurinë (Xhemel) dhe madhësitinë (Xhelal) tonë.*

Në këtë pikë, udhëtari shpirtëror u kthye, ju kërkoi falje dorës, penës, diturisë, vullnetit, forcës dhe të tjerëve pas tyre për pytyet dhe qortimet, e ju tha:

- *Kërkoj ndjesë, pranojeni gabimin tim! Unë sapo erdha në këtë vend, e secili që është axhami hutohet. Qortimi im ndaj juve vjen nga padituria ime. Tash e kam të qartë arsyetimin tuaj. M'u shfaq se Ai që është Një në sundim të botës së mulkut, të melekutit, dhe botës xheberut, është i Vetmi (el-Vahid), që sundon mbi gjithçka (el-Kahhar). Ju jeni vetëm nën forcën e Tij, ju jeni krijesa që Ai i drejton si dëshiron. Ai është i pari (evvel) dhe i fundit (ahir), i dukshmi (zahir) dhe i padukshmi (batin).*

Kur e tregoi gjendjen në botën e dukshme, nuk ia pranuan aq lehtë, e i thanë:

- Si mund Ai të jetë i pari dhe i fundit, kur këto janë dy cilësi të kundërta, dhe si mund të jetë i dukshmi e edhe i padukshëm? I pari nuk mund të jetë i fundit, e çka duket nuk mund të jetë e padukshme!

Udhëtari shpirtëror tha:

- Ai është i pari, sepse e gjithë ekzistenca erdhi prej Tij, me rend, njëra pas tjetrës. Dhe Ai është i fundit sepse gjithçka i kthehet Atij. Ata ngrihen pandërprerë, shkallë-shkallë, dhe në fund do të arrijnë Atij. Aty është fundi i rrugëtimit. I padukshëm është për ata që janë zhytë në botën e dukshme, e kërkojnë ta njohin Atë me pesë shqisat e tyre. I dukshëm është për ata që shikojnë me syrin e zemrës, me ndihmën e dritës që digjet në zemër.

Ja, i këtillë është tevhidi i udhëtarëve shpirtëror që ecin qëndrueshëm në rrugën e tevhidit, i atyre që u është zbuluar se Bërësi i vëtëm është vetëm Një.

Nëse ti thua: *Një tevhid i këtillë shkon deri aty sa ndërtohet në botën e melekutit; e çfarë është gjendja e atyre që këtë nuk e kuptojnë, ose që e mohojnë; përgjigja është kjo: Nuk ka ilaç për ata që mohojnë, pos t'ju thuhet se mohimi i botës së melekutit nga ata është i ngjashëm me mohimin e botës së xheberut nga Sumeni.*

Këta botën e kanë limituar në pesë shqisat e veta. Mohojnë forcën, vullnetin dhe diturinë, sepse këto nuk perceptohen me pesë shqisat, andaj këmbëngulin në botën materie.

Nëse dikush thotë se është pjesë e të këtillëve, se nuk mund të udhëzohet pos në botën e dukshme, me ndihmën e pesë shqisave, se nuk di asgjë jashtë kësaj; atëherë mohimi i tij është sikur mohimi i sofistëve (argumentuesve të rrejshëm), që thonë: *“Nuk jemi të sigurt në atë që shohim. Ndoshta ato vetëm po i ëndërrojmë.”*E nëse thotë se vërtetë është prej tyre, se edhe ai vet dyshon në shqisa, atëherë konstatohet se natyra e tij është e çrregulluar dhe se është gati e pamundur të shërohet. Të tillin duhet lënë në ato pak ditë që i kanë mbetur. Mjekët nuk mund të shërojnë bash secilin pacient. Kaq për ata që mohojnë. E për atë që nuk mohon, por as nuk kupton, detyra e udhëtarit shpirtëror është t’ia kontrollojë syrin e zemrës me të cilin mund ta shohë në botën e melekutit.

Nëse e sheh që në esencë është shikim i shëndoshë, por i mjegulluar, do të merret me pastrimin e tij, siç bën doktori me sytë tanë fizikë. Nëse kjo ka sukses, ia tregojnë rrugën shpirtërore. Edhe Resulallahu, s.a.v.s., ka vepruar kështu me as’habët havas.

Nëse shërimi i basiretit të tij është i pamundur, atëherë nuk hyn në rrugën e tevhidit siç e shpjguam, nuk do ta ketë mundësinë të dëgjojë dëshmitë e tevhidit nga grimcat e alemi-mulk dhe alemi-meleikut. Atij mund t'i flitet vetëm me fjalë të përbëra nga shkronjat dhe tingujt dhe duke braktisë kulmin e tevhidit, duhet lëshuar në nivelin e kuptimit të tij, sepse edhe bota e dukshme (alemi-shehadet) gjithashtu ka tevhid. Secili e di që shtëpia mund të ketë vetëm një zot shtëpie, si vendi që mund të ketë vetëm një sundimtar. Të këtillit, përshtatshëm kuptimit të tij, do t'i thuhet: *“Rabbi i botëve është Një. Udhëheqës është Një. Po të kishte më shumë, do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka.”*

Le ta krahasojë këtë me shembujt nga kjo botë. Në këtë mënyrë, përshtatshëm kuptimit të tij, fara e tevhidit do të mbjellet në zemrën e tij. Allahu Teala e ka caktuar që njerëzve t'ju flitet përshtatshëm aftësisë së tyre për të kuptuar. Prandaj Kur'ani u shpall në gjuhën arabe, që njerëzit ta kuptojnë.

Nëse ti pyet: *a mund të përdoret një tevhid i këtillë si bazë për tevekkul*, përgjigja është *Po*; kur bindja forcohet dhe vendoset në zemër, atëherë keshfi vepron dhe lëvizë gjendjet. Por, të shumtën e rasteve kjo bindje është e dobët dhe mund të lëkundet.

Prandaj poseduesi i kësaj bindje, ka nevojë për një kelamxhi që ta mbrojë veten, ose ta njohë vetë diturinë e kelamit. Këtë ai duhet ta mësojë prej mësuesit, prindit ose dikujt nga vendi i tij. Por, ai që e gjen rrugën me dritën e udhëzimit, përmes nurit, nuk ka nevojë për këto. Edhe po të ngritet perdija nga syri i tij, bindja e tij nuk do të shtohet, pos që do ta kishte parë pak më qartë. Sikur ai që e sheh ndonjë person në agim dhe të njëjtin e sheh edhe pas agimit; nuk ka dyshim se është i njëjti person, por pas agimit e sheh më qartë.

Dallimi në mes të poseduesve të keshfit dhe poseduesve të besimit është sikur dallimi në mes të magjistarëve të faraonit dhe pasuesve të Samirit. Magjistarët e faraonit, pasi që ishin deri në hollësi të njoftuar me magjinë, përshtatshëm përvojës së tyre të madhe, e panë se muxhize e Musasë a.s., i kaloi kufijtë e sihirit (magjisë). Atyre ju zbulua e vërteta, prandaj edhe nuk u brengosën për fjalët e faraonit:

"...unë do t'ua pres duart e këmbët tërthorazi"

(20-Ta Ha: 71),

por thanë:

"pasha Atë që na krijoi, nuk të japim përparësi ty ndaj argumenteve që na erdhën, e ti bëje atë që mendon ta bësh, dhe mund ta zbatosh vetëm atë që i takon jetës së kësaj bote!" (20-Ta Ha: 72)

Sa për pasuesit e Samirit, pasi që besimi i tyre ishte i bazuar në shfaqjen e gjarprit nga bastuni i Musasë a.s., kur e panë viçin që e bëri Samiri dhe e dëgjuan si pëlliste, ata u kthyen dhe e dëgjuan Samirin duke thënë:

“Ky është zoti juaj dhe zoti i Musasë”

(20-Ta Ha: 88), dhe iu drejtuan viçit e nuk menduan se a mund t'ju sillte ndonjë dobi a dëm.

Gjithkush që beson duke e parë gjarprin, edhe kur e sheh viçin mund të shfaq mosbesim, sepse të dyja janë nga bota e dukshme, e në botën e dukshme dallimet dhe kundërshtitë janë të shumta. Ndërsa në botën e melekutit nuk ka kundërshti e mospërputhje.

Nëse ti thua: *Ajo që tregoni për tevhid është e qartë, sado që është kuptueshme se ndërmjetësuesit dhe sebetet janë plotësisht të nënshtruar, përpos njeriu, që është posedues i vullnetit dhe nëse dëshiron lëviz, nëse dëshiron ndalet. E si atëherë ti pohon se edhe njeriu është i nënshtruar?;* atëherë dije se, nëse themi se njeriu dëshiron kur ai do të dëshirojë dhe nuk dëshiron kur nuk do të dëshirojë, pra themi se dëshira, kërkesa, vullneti plotësisht janë në duart e njeriut - këtu këmba rrëshqet dhe është vend ku gabohet.

Është fakt i njohur që njeriu bën atë që dëshiron, por njeriu bën edhe atë që nuk e dëshiron. Pra, dëshira dhe vullneti nuk janë plotësisht në duart e tij. Shumë gjëra që nuk i dëshiron, prapë i bën. Përndryshe, ai vullnet në lidhje zinxhirore me një vullnet tjetër do të shkonin deri në pafundësi, që nuk është e mundur. Pasi vullneti dhe dëshira nuk janë te ai, forcën e harxhon duke e përdorë në gjëra aq sa ka forcë; kur i paraqitet vullneti, fuqia domosdoshëm përdoret atje dhe personi nuk ka mundësi ta kundërshtojë këtë. Domethënë, fuqisë domosdo i duhet lëvizje. Kur vullneti përcaktohet, ai domosdo shfaqet në zemër dhe fuqia domosdo lëviz. Këto domosdoshmëri janë të njëpasnjëshme. Njeriu nuk mund ta zhduk ekzistimin e vullnetit, e fuqinë mund ta përdorë vetëm në atë që është caktuar nga Allahu. Njeriu në të gjitha këto është i detyruar.

Nëse ti thua: *Kjo që ti e tregon është detyrim i pastër (xhebr-i mahz), e detyrimi është e kundërta e zgjedhjes së lirë, e ti e pranon zgjedhjen e lirë. Si mundet pra një person edhe të jetë i detyruar edhe të ketë zgjedhje të lirë?*; unë them që, sikur të t'ngritej perdja, edhe ti do ta kuptoje se njeriu vërtetë është i detyruar në zgjedhjen e tij të lirë. Por, si mund ta kuptojë këtë ai që nuk e kupton zgjedhjen e lirë?

Prandaj, shkurtimisht, do të shpjegojmë zgjedhjen e lirë me gjuhën e kelamxhive, sepse qëllimi me këtë libër është njoftimi për diturinë praktike. Megjithatë, do të them se fjala *punë, veprim (fiil)* përdoret në tri mënyra:

Kur thuhet se njeriu shkruan me gishta, merr frymë me rrugët e frymëmarrjes, e kur zhytet në ujë e çan ujin, me këtë po flasim për shkrimin, frymëmarrjen dhe çarjen e ujit. Por njeriu është domosdo i detyruar në këto. Nga kjo pikëpamje, të gjitha janë një. Ato edhe dallojnë në disa çështje nga njëra-tjetra, e këtë do ta shpjegoj në tri pika:

Çarjen e ujit kur njeriu zhytet në ujë, e quajmë *veprim natyror*, frymëmarrjen e quajmë *veprim i vullnetshëm* deri sa shkrimin e quajmë *zgjedhje e lirë*. Detyrueshëmëria shprehet në aktin natyror, sepse kur njeriu zhytet në ujë, çarja e ujit është e detyrueshme. Njëjtë me frymëmarrjen, ngase lëvizja e gurmazit në raport me vullnetin për të marrë frymë është si çarja e ujit në raport me peshën që hyn në ujë. Kur ka peshë në materie, me siguri uji që çahet. Ndërsa pesha nuk është prej tij, siç nuk është as vullneti në duart të tij.

Por, kur para vetes e sheh gjilpërën si vjen drejt syrit, kapakët e syve të tij mbyllen me dëshirën e tij të lirë, dhe edhe po të dojë t'i mbajë të hapur, nuk do të mundet, ani pse ky është veprim i forcës dhe vullnetit. Duke qenë kështu, domosdoshmëria bëhet pjesë e *veprimeve natyrore*.

Sa për të tretën, kjo është zgjedhje dhe ngjashmëria është si në rastin e shkrimit dhe të folmes, e thuhet: *nëse dëshiron, shkruan dhe flet, e nëse nuk dëshiron, nuk shkruan dhe nuk flet*. Njeriu mendon se kjo është plotësisht në duart të tij, e kjo është vetëm injorancë, që nuk e njeh kuptimin e zgjedhjes. Prandaj, ta shpjegojmë këtë:

Vullneti i nënshtrohet mendjes, e cila përcakton se a është diçka e përshtatshme për ty. E gjërat e përshtatshme për ty ndahen në dy: në gjërat që dëshmimi yt, qoftë i jashtëm a i brendshëm, i kupton pa hezitim, dhe në gjërat rreth të cilave mendja heziton.

Atë që e kupton plotësisht e pa hezitim, është për shembull, drejtimi i gjilpërës kah syri, ose i shpatës kah trupi yt. Në diturinë tënde nuk do të ketë luhatje që për ty është më mirë që këto të refuzohen.

Kështu, dituria e zgjon vullnetin, e vullneti e zgjon forcën, e përmes forcës kapakët e syrit lëvizin për ta mbrojtur syrin, ose dora mbrohet prej shpatës. Kjo mbrojtje nuk është e menduar dhe realizohet instinktivisht, përmes vullnetit.

Ka edhe gjëra, në ndarjen e të cilave mendja ndalet dhe nuk është e sigurt se a përshtaten a jo. Atëherë personi ka nevojë për të menduar, që të vijë deri në një përfundim. Kur përmes të menduarit vjen në përfundim se njëra mundësi është më e mirë se tjetra, pa hezitim orientohet andej. Dhe këtu lind vullneti. Kur vullneti ngritet për veprimin që mendjes i është treguar si më i mirë, ai vullnet quhet '*zgjedhje*', që del prej të mirës. Kjo zgjedhje paraqet impuls drejt asaj që mendjes i është shfaqur si më e mirë, dhe është esenca e atij vullneti. Dallimi është se njëra është e pamenduar, pra instinktivisht, e tjetra bëhet e ditur pas të menduarit. Pra, zgjedhja vjen prej një vullneti të veçantë. Prandaj thuhet se për ta njohur më të mirën nga dy të mira dhe më të keqen nga dy të këqija, ka nevojë për mendim, dhe nuk është e mundur që vullneti të shkojë kundër gjykimit të zgjedhur, pasi është menduar rreth çështjes.

Nëse njeriu, për shembull, do të dëshironte që vetes t'ia këpusë kokën, ai nuk do të mund ta bënte këtë, jo pse nuk ka fuqi në duar apo nuk ka shpatë, por pse i mungon vullneti i cili do ta vënte fuqinë në lëvizje. E vullneti ka humbur sepse ai vihet në lëvizje me gjykimin e mendjes ose të shqisave, që një veprim i tillë t'i përshtatet, e vetëvrasja nuk i përshtatet. Prandaj, ani pse posedon fuqi, nuk mund të vetvritet, pos nëse është nën ndonjë vuajtje që nuk mund ta durojë. Aty mendja gjendet para dilemës, sepse i duhet të zgjedhë në mes të dy të këqijave. Nëse pas të menduarit do të mbizotëronte mendimi se është më mirë të jetojë, ai nuk e vret veten. Por nëse gjykon se megjithatë do të jetë më mirë të vdes, dhe vendimi është i prerë, atëherë do të lindin edhe vullneti dhe fuqia për ta vrarë veten.

Për shembull: personi që është duke vuajtur nga goditjet e shpatës, nëse është buzë humnerës, mendon ta hedhë veten aty, me qëllim që të vdes. Por, nëse është në vuajtje nga goditje të lehta të shpatës, mendja do t'i gjykojë se më lehtë e ka të durojë goditjet e shpatës, se sa të hidhet në humnerë. Do të ndalet e nuk do të jetë në gjendje të hidhet. Nuk do t'i ngjallet kurrfarë impulsi për këtë, sepse impulsi i vullnetit është i nënshtruar gjykimit të mendjes dhe shqisave, derisa forca i është nënshtruar vullnetit, e lëvizja forcës.

Gjithçka është aq ngusht e paracaktuar, sa njeriu as nuk është i vetëdijshëm për këtë. Ai është vetëm një govatë nëpër të cilin rrjedhin këto gjëra. As nuk bëhet fjalë se këto janë prej tij. Prandaj, kuptimi i shprehjes “*të jetë i detyruar*” (*mexhbur*) është në atë se gjithçka njeriut i ndodhë nga tjetër kush, jo nga vet ai, deri sa kuptimi i shprehjes “*liria e zgjedhjes*” (*muhtar*) është se njeriu është vetëm vendi i vullnetit i cili te ai zgjohet me detyrim (*xhebr*) pasi që mendja të sjellë gjykimin se një veprim i caktuar është më i mirë.

Pra, edhe vet gjykimi ndodhë me detyrim. Sipas kësaj, njeriu është i detyruar në zgjedhje. Për shembull, djegia është punë e zjarrit dhe për zjarrin është një detyrim i pastër, deri sa puna e Allahut Teala është zgjedhje e pastër. E puna e njeriut është mes këtyre dyjave (*xhebr-i mahz* dhe *ihtijar-i mahz*) dhe ai është i detyruar në zgjedhje. Dijetarët janë munduar të gjejnë një shprehje të tretë për këtë, pasi që vërtetë bëhet fjalë për një element të tretë, e duke u mbështetur në librin e Allahut Teala, atë e quajtën *kesb*¹⁹. Kjo shprehje nuk është në kundërshtim as me *xhebr* as me *ihtijar*, por i bashkon këto dy kategori, për atë që kupton.

¹⁹ fitim; përfitim; punoj; përpiqem; fitimi me punë dhe përpjekje; rruga e fitimit.

Veprimi i Allahut Teala quhet “*ihthijar*”- zgjedhje, por me një kusht që nga zgjedhja e Allahut nuk duhet të kuptohet zgjedhja e Tij pas ngurrimit. Sepse kjo mëdyshje është e pamundur t’i përshkruhet Atij. Asnjë nga të gjitha fjalët me të cilat shërbehen gjuhët e botës nuk mund të përdoren për Allahun Teala, përpos si metaforë. Por, diturisë që po e shpjegojmë nuk i takon të flasë për këtë dhe fjalët zgjaten shumë.

Tash ti mund të më thuash: *Po thua se dituria e lind vullnetin, vullneti fuqinë, fuqia lëvizjen, që secila rrjedhë nga një e mëparshme. Nëse e thua këtë, ti po gjykon se diçka krijohet më vonë, pa fuqinë e Allahut. E nëse këtë nuk e pranon, çfarë kuptimi ka fjala jote se ato shfaqen njëra pas tjetrës?*; atëherë, dije se është padituri e pastër të thuhet se një pjesë e kësaj rrjedhë nga pjesa tjetër, pa marrë parasysh se a quhet kjo ‘*lindje*’ (*tevellud*) ose përdoret ndonjë term tjetër.

E gjitha është e barabartë me kuptimin e asaj që quhet *el-Kuvva el-ezelijja* (*fuqia e gjithmonshme pa fillim dhe pa mbarim*). Ajo është baza, të cilën nuk e kuptojnë të gjithë njerëzit, por vetëm ata të thelluar në dituri. Vetëm ata e kuptojnë të vërtetën e esencës së kuptimit të kësaj.

Kuptimi i njerëzve të rëndomtë i përmbahet fjalëve të thjeshta me një dozë ngjasimi (*teshbih*) me fuqinë tonë, e kuptimi i njerëzve të rëndomtë është shumë larg nga e vërteta. Të shpjegohet e gjithë kjo do të na dërgonte shumë larg, pos kur tregojmë për gjëra të përcaktuara, si në rastin kur e kushtëzuara e përcjellë kushtin e vet dhe si ato janë të lidhura me njëra-tjetrën. Le të themi vetëm se disa bazohen në to me krijimin e tyre, siç e përcjellë e kushtëzuara kushtin e vet. Nga fuqia e përjetshme (*ezel*) shfaqet dituria, pastaj vullneti, me pas jeta dhe vendi për jetë. Siç nuk mund të thuhet se jeta shfaqet nga trupi, që është kusht për jetën, njëjtë është edhe me gradat tjera të rregullimit. Por disa nga kushtet janë të dukshme për njerëzit e zakonshëm (*avam*), e të tjerat janë të dukshme vetëm për të zgjedhurit (*havas*), atyre që posedojnë *keshf* me ndihmën e nurit të Hakut. Përndryshe, edhe lëvizja përpara edhe qëndrimi prapa është vetëm sipas drejtësisë dhe nevojës.

Kështu është me të gjitha veprimet e Allahut Teala. Po të mos ishte kështu, kategoritë e nxitimit dhe shtyerjes nuk do të ishin të ndërlidhura, ngjashëm me veprimet e të çmendurit, e sa i lartësuar është Allahu nga të folurit e të padijshmëve. Për këtë tregojnë edhe fjalët e Allahut:

“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë” 51-Dharijat: 58,

dhe:

“Ne, nuk i kemi krijuar qiejt dhe Tokën, as atë që gjendet në mes tyre, për t’u zbavitur (pa qëllim),

Ne i kemi krijuar ato me qëllim të caktuar, por shumica e tyre nuk e dinë.” 44-Duhan: 38, 39.

Gjithçka që gjendet mes qiejve e Tokës është krijuar mbi një rregull. Nuk është e mundur as të paramendohet se kjo mund të jetë ndryshe përpos sipas rregullit në të cilin është. Asgjë nuk vonohet, pos që është në pritje të parakushtit të vet. Sepse është e pamundur që e kushtëzuara të ndodhë më herët se parakushti i saj, dhe e pamundura nuk mund të llogaritet se do të ndodhë.

Dituria vjen pas “*pikës*” (spermës) vetëm për shkak të mungesës së kushteve të jetesës, njëjtë si vullneti që vjen pas diturisë që nuk “vonohet” për asgjë tjetër, pos që i mungon parakushti i diturisë. E gjitha kjo rrjedhë sipas principit të domosdoshmërisë dhe rregullit të së vërtetës. Nuk ka rastësi këtu. E gjithë kjo është rezultat i një hikmeti dhe rregulli.

Kjo është e vështirë të shpjegohet, por megjithatë do të sjellim një shembull për gjërat që janë përcaktuar, në mënyrë që ta shpjegojmë për ata me mendje të dobët:

Pra, të paramendojmë njeriun pa abdes, të zhytur në ujë deri te fyt, por ende nuk e ka larë fytyrën, ani pse uji ia prekë të gjithë trupin. Abdesi i tij është i lidhur për kushtin e larjes edhe të fytyrës. Njëjtë edhe përcaktimi i fuqisë së përjetshme (*eze/*), që i rrethon gjërat që janë miratuar më parë dhe pret që të plotësohen kushtet që ato të ndodhin.

Ai që mendon që larja e fytyrës i bën me abdes edhe gjymtyrët tjera, me një logjikë të këtillë është i paditur, ngjashëm me besimin e një personi që mendon se lëvizja del në shesh me fuqi, fuqia me vullnet, e vullneti me dituri. Në fakt, duart u bënë me abdes vetëm pasi që fytyra u bë me abdes, pra kur fytyra bëhet me abdes, janë bërë me abdes edhe duart, me ujin që tashmë i ka prekur, e jo me pastrim të fytyrës. Sepse siç nuk ndryshon uji me larjen e fytyrës, as duart nuk kanë ndryshuar. Por ka ndodhur ekzistimi i kushtit (*shart*) dhe kështu u bë i qartë veprimi e sebebipit.

Kështu duhet kuptuar daljen e paracaktimit (*mukadderat*) nga fuqia e përjetshme - ezel. Fuqia është e përhershme (*kadima*), ndërsa përcaktimi është krijuar më vonë, ndryshon dhe ka afat (*hadis*). Kjo po troket në derën e një diturie tjetër nga dituritë mukashefe. Nuk do të flasim për to, sepse qëllim e kemi vetëm të tregojmë tevhidin në veprim. Veprues është me të vërtetë vetëm Ai, i Vetmi. Ai ofron edhe frikë edhe shpresë. Vetëm te Ai ka mbështetje.

Nga oqeani i tevhidit, ne jemi në gjendje të shpjegojmë vetëm një pikë nga deti i gradës së tretë të tevhidit. Për ta shpjeguar plotësisht, është e pamundur, edhe në një jetë të gjatë sa e pejgamberit Nuh, a.s.. Kjo është si tharja e detit duke marrë ujin pikë për pikë.

Por, e gjithë kjo përfshihet me fjalët: ***‘La ilahe ilallah’*** (Nuk ka zot pos Allahut); sa fjalë e lehtë për t’u thënë me gjuhë dhe e lehtë t’u besuar me zemër kuptimi i saj. Dhe sa e lartësuar dhe e vlefshme është esenca dhe hakikati i kësaj për dijetarët që kanë hyrë thellë në dituri!

Nëse thua: *Si është e mundur të bashkohen tevhidi me sheriatin kur kuptimi i tevhidit është që nuk ka bërës tjetër pos Allahut Teala, ndërsa sheriatu veprimet ua*

ngarkon njerëzve? Si mund të thuash Allahu e bëri një punë, e edhe njeriu e bëri të njëjtën?; unë them: Po. Kjo është e pakuptueshme nëse *bërësi* ka vetëm një kuptim. Por, nëse janë dy kuptime, dhe emërtimi është përmbledhje e të dyjave, atëherë nuk ka kundërshti; kur thuhet se sundimtari e ka vrarë një person, njëjtë thuhet që këtë e ka bërë xhelati; sundimtari e vret në mënyrën e vet, e xhelati në mënyrën e vet. Njëjtë edhe njeriu është veprues sipas një kuptimi, e Allahu veprues i të njëjtës sipas një kuptimi tjetër. Kuptimi i asaj që Allahu Teala është Bërësi i vërtetë vjen nga fakti se Ai është Shpikësi, Krijuesi dhe Përzgjedhësi.

Siç është sëmundja e lidhur me të sëmurin, ashtu fuqia i lidhet Allahut. Pra, çfarëdo që të jetë lidhja me fuqinë, vendit të fuqisë i thuhet *bërës*. Prandaj thuhet se edhe xhelati është vrasës edhe sundimtari është vrasës, sepse vrasja ka lidhje me fuqinë e të dyve. Këto janë dy lidhje të ndryshme dhe për këtë arsye të dy bëhen bërës. Në këtë mënyrë, edhe caktimi (kader) i Allahut është i lidhur me dy fuqi.

Me qëllim të harmonizimit dhe përshtatjes, Allahu Teala në Kur'an veprat nganjëherë ia përkshuan melekëve, nganjëherë njerëzve, e nganjëherë Vetes. Kështu, për vdekjen thotë:

Thuaju: “Do t’jua merr shpirtin meleku i vdekjes, i cili është caktuar për ju.” 32-Sexhde: 11

Më pastaj thotë:

“Allahu ua merr shpirtrat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes.” 39-Zumer: 42

Allahu Teala gjithashtu thotë:

“A shihni atë që po e mbillni?” 56-Vakia: 63,

duke na folur neve, e në tjetër rast:

“Ne lëshuam shi të mjaftueshëm.

Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës,

Dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra

Edhe rrush e perime.” 80-Abese: 25,- 28.

Ai thotë:

“Ne dërguam tek ajo Shpirtin Tonë – Xhebrailin, e ai iu paraqit asaj në formën e mashkullit të përkryer.”

19-Merjrem: 17,

derisa në vend tjetër thotë:

“Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë”

(66-Tahrim: 12), ndërkaq ai që fryu ishte Xhebraili a.s..

Edhe për rastin kur Allahu Teala thotë:

“Dhe kur ta lexojmë atë, ti përcille leximin e tij!”

(75-Kijamet: 18), në *tefsir* (komentim) thanë:

“Kur ta lexojë Xhebraili.”

Tutje, Allahu Teala thotë:

“Luftoni kundër tyre, që Allahu t’i dënojë ata me duart tuaja.”

(9-Tevbe: 14), duke e përshkruar luftën si vepër të njerzve e dënimin si vepër e Tij, e dënimi i tyre edhe është vrasja.

Allahu Teala e thotë këtë qartazi:

“Ju nuk i keni mbytur ata, por i ka mbytur Allahu”,

dhe vazhdon në po këtë ajet:

“...dhe ti nuk i gjuajte kur i gjuajte, por Allahu i gjuajti...”,

(8-Enfal: 17), që është bashkim i qartë i mohimit dhe pohimit. Mirëpo mendohet në atë se ti nuk ke gjuajtur në mënyrën si gjuan Allahu, ti ke gjuajtur në mënyrën si gjuajnë njerëzit, sepse këto janë dy kuptime të ndryshme.

Allahu Teala gjithashtu thotë:

**“I Cili, me anë të penës ia mësoi,
ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”** 96-Alak: 4, 5

dhe:

“Rahmani

Ai ia mësoi Kur'anin

E krijoi njeriun.

la mësoi atij të folurit (të shprehurit)”

55-Rahman: 1- 4

“Dhe pastaj është obligim yni që ta shkoqisim atë.”

75-Kijame: 19

“A më tregoni për farën që e derdhni,

A ju e krijoni atë, apo Ne jemi që e krijojmë?”

56-Vakia: 58, 59

E Resulallahu s.a.v.s., e përshkroi melekun e ngarkuar me vendosjen e farës në brendësinë e nënës:

“Ky melek hyn në mitër, e merr embrionin në dorë, i jep formën e trupit, dhe pyet:

- O Rabb, mashkull apo femër? I shëndetshëm apo i mangët?; në çka Allahu Teala përgjigjet ashtu siç do Ai, e meleku krijon (sipas atij urdhri).”²⁰

²⁰ Bezzar dhe Ibn Adijj nga Ajsher.anha. Baza e hadithit është *muttefekun alejhi* nga Ibn Mesud r.a..

Njëri nga gjenerata e parë (*selef*), ka thënë: “*Meleku i quajtur Ruh (Shpirt) i frynë shpirtat (ervah) në embrion. Çdo frymë e tij që hyn në embrion bëhet një shpirt. Prandaj edhe është quajtur Ruh.*”

Kjo është e vërtetë. Të zgjedhurit e Allahut këtë e kanë parë me syrin e zemrës. Por shpirti, që përbëhet nga fryma e Tij, njihet përmes transmetimit, e pasi nuk ka një transmetim më të qartë në këtë çështje, mbetet fjalë abstrakte.

Për shenjat dhe dëshmitë e Tij, Allahu Teala thotë:

“A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?” 41-Fusilet: 53,

si edhe:

“Allahu dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Tij.”

(93-Ali Imran: 18), duke treguar kështu se Ai është dëshmi e Vetvetes.

Këtu nuk ka kundërshti. Mënyrat për të sjellë dëshmi janë të ndryshme. Sa shumë ka njerëz që Allahun Teala e njohën duke i vrojtuar krijesat, e sa ka që secilën krijesë e njohën përmes Allahut Teala, ashtu siç ka thënë dikush: “*Rabbin tim e njoha me Rabbin tim. Pa Rabbin tim, nuk do ta njihja Rabbin tim!*”

Kjo është kuptimi i ajetit më lartë:

- ***A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?*** (41-Fusilet: 53).

Allahu Teala e cilësoi Vetën si ***Ai që jep jetë dhe vdekje***, e duke i angazhuar për këtë dy melekët e Tij. Në një lajm thuhet:

“Po debatonin dy melekë mes vete; meleku i vdekjes dhe meleku i jetës. Meleku i vdekjes tha:

- *Unë i vdes të gjallët!*, në çka meleku i jetës tha:

- *Unë i ngjalli të vdekurit!*

Në këtë, Allahu Teala ju shpalli:

- *Bëni atë që e bëni, atë me çka Unë ju kam nënshtruar, sepse nuk ka përveç Meje që jep jetë dhe vdekje.*”

Po shihet se një veprim mund të përdoret në drejtime të ndryshme, dhe në këtë nuk ka kundërshti, nëse e kupton. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., i tha atij që mori hurmen:

“Merre këtë hurme! Po të mos vije ti te kjo, me siguri kjo do të vinte te ti.”²¹

²¹ Ibn Hibban në veprën *Revdatul-ukala* nga Huzejl ibn Shurahbil. E shënon edhe Taberani. Transmetuesit e këtij hadithi janë të besueshëm.

Ardhjen ia ka përshkruar edhe atij, edhe hurmes, ani pse dihet se hurma nuk mund të shkojë te njeriu ashtu si njeriu mund të vijë te hurma. Për këtë arsye, kur një i penduar tha: *“Pendohem te Allahu Teala, jo te Muhammedi (a.s.); u tha:*

- E ka kuptuar çka i takon kujt.²²

Ai që ia përshkruan të gjitha veprimet Allahut Teala, ai e njeh hakikatin. Ai që ia përshkruan ndonjë vepër dikujt tjetër përveç Allahut, ai vetëm sa po përdorë metaforë dhe simbole në fjalimin e tij. Siç ka rrugë hakikati, edhe metafora ka rrugë. Gjuhëtari e quan shpikësin *krijues*, duke i shikuar lëvizjet e njeriut dhe duke menduar se njeriu krijon me fuqinë e tij.

Siç e pranoi xhelatin *veprues* të vërtetë dhe sundimtarin *veprues* metaforik, njëjtë në mënyrë metaforike, njeriun e bëri *veprues* të vërtetë, e Allahun Teala *veprues* metaforik. Por, kur hakikati i zbulohet të zgjedhurit, atëherë ai e kupton se çështja është krejtësisht e kundërta. Do t’i thotë gjuhëtarit se nuk ka krijues të vërtetë përveç Allahut Teala. Hakikat është të thuhet se Allahu është krijues i vërtetë, e të tjerët janë vetëm metaforikë.

²² Hadithi është përmendur në *Librin për Zeqatin*.

Kur kuptimi i hakikatit rrodhi nga gjuha e një arapi, me ose pa njohuri, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“Fjalët më të vërteta që ndonjë poet i ka thënë, janë fjalët e Lebid-it: *Gjithçka pos Allahut është bosh!*”²³, pra, gjithçka që nuk ka ekzistencë në vetvete, por falë tjetrit, është bosh, sepse hakikati i tij nuk është në vetvete, por është me dikë tjetër. Atëherë, vërtetë që realitet (Hakk) është i Gjalli (Hajj) dhe i Përjetshmi (Kajjum) që nuk ka të ngjashëm. Sepse Ai ekziston vetvetiu. e gjithçka pos Tij ekziston me fuqinë e Tij. Ai është Hakk, e gjithçka tjetër është bosh. Prandaj Sehl et-Tusteri ka thënë: *“O meskin, Ai ishte, e ti nuk ishe. Ai do të egzistojë, e ti nuk do të jesh. E tash kur ti je, thua: ‘unë, unë!’ Edhe tash bëhu ashtu siç ishe dikur kur nuk ishe, sepse Ai është sot, njëjtë siç ishte dikur.”*

Nëse thua: *Tash po del se bërësi i vërtetë është Allahu, në çdo gjë, dhe tash po kuptohet që njeriu është i detyruar për gjithçka. Çfarë kuptimi kanë atëherë sevapi, dënimi, zemërimi e kënaqësia (rizaja)? Si mund dikush të ketë zemërim për veprimin e vet?*”, dije se kuptimin e kësaj e kemi treguar në *Librin për falënderimin*, prandaj nuk duam ta zgjasim duke përsëritur.

²³ Muttefekun alejhi, nga Ebu Hurejre r.a..

Këto që i përmendëm janë shenja të tevhidit nga i cili lind gjendja e *tevekkulit* (mbështetje në Allahun). Kjo kompletohet me besim në mëshirë (Rahmet) dhe urtësi (Hikmet). Sepse tevhidi kërkon të shikohet Shkaktari i shkaqeve, deri sa besimi në Mëshirë dhe gjerësinë e saj kërkon mbështetjen në atë Shkaktar.

Gjendja e *tevekkulit* kompletohet - siç do ta shohim më vonë, me besim në përfaqësuesin (vekil). Kjo është një derë e madhe besimi. Tregimet e atyre që kjo ju është zbuluar janë të shumta. Ne do të tregojmë përmbledhjen e tyre në mënyrë që një person që kërkon gradën e *tevekkulit* do të jetë plotësisht i bindur, pa kurrfarë dyshimi, duke besuar plotësisht.

Sikur Allahu Teala të kishte krijuar të gjithë njerëzit në gjendjen më të zgjuar dhe më të ditur e t'ju kishte dhënë atyre dituri aq sa mund të bartin, e duke derdhur në ta urtësi që nuk mund as të përshkruhet, pastaj t'u jep përsëri mend, dituri dhe urtësi - aq sa është numri i tyre, e pastaj t'ju zbulojë të ardhmen e tyre, t'i njoftojë me fshehtësitë e *meleikutit* (botës tjetër) e t'i njoftonte për hollësitë e mëshirës dhe fshehtësitë e dënimit që ata të thellohen në kuptimin e të mirës e të keqes, dobisë e dëmit; e më pas t'ju kërkojë të kujdesen së bashku për botën e dukshme e të padukshme sipas

diturisë dhe urtësisë që ju është dhënë, bile edhe duke ndihmuar njëri-tjetrin, siç kujdeset Allahu, kujdesi i tyre nuk mund të ketë peshë as sa krahu i mushkonjës; ata as nuk mund të heqin a të ndryshojnë as edhe një atom të vetëm. Nuk mund të heqin as një sëmundje, një turp, një mangësi, një varfëri apo telashe që e ka gjetur dikë; fuqia e tyre nuk mjafton të heqin mirëqenien, shëndetin, përsosmërinë, pasurinë dhe lumturinë e atij të cilit Allahu Teala ia ka dhuruar këto. Bile, nëse i shikojnë me kujdes gjërat që Allahu krijoi në qiej dhe në Tokë, nëse mendojnë për një kohë të gjatë, ata nuk do të shohin ndonjë tepricë apo mangësi. Gjithçka që Allahu Teala ka shpërndarë mes robëve të Tij, prej riskut, exhelit, rehatisë, gëzimit e mërzhisë, dobësisë e forcës, besimit (*iman*) e mosbesimit (*kufr*), nënshtrimit e kryengritjes, e kupton që të gjitha janë plotësisht të drejta (*adl*), pa kurrfarë zullumi. Në fakt, kjo është në renditje e domosdoshme dhe e duhur, pikërisht ashtu si duhet dhe sa duhet. Aspak nuk është e mundur të jetë më e mirë, as më e plotësuar, as më e përsosur se kjo. Sikur të paramendojmë se kjo mund të ishte më mirë, dhe Ai, ani pse ka fuqi, nuk e ka bërë më të mirë - kjo do të ishte koprraci, që është e kundërt me mirësinë, dhe do të ishte padrejtësi, që shkon kundër drejtësisë.

Nga ana tjetër, po të mos ishte në mundësi të krijojë botë të tillë, atëherë kjo do të ishte pafuqi, që nuk i takon Allahut.

Megjithatë, edhe nëse çdo varfëri dhe dëm është e metë në këtë botë, në botën tjetër (ahiret) është një përsosmëri. Nëse është mangësi në ahiret për një person, për tjetrin është bekim. Sepse vlera e ditës nuk do të njihej pa natën. Nëse nuk do të kishte sëmundje, njerëzit e shëndetshëm nuk do ta shijonin shëndetin e tyre. Po të mos ishte xhehnemi, nuk do ta vlerësonin xhenetin.

Kafshët sakrifikohen për njerëzit dhe njerëzit i prejnë ato, dhe ky veprim nuk konsiderohet zullum. Dhënia përparësi më të përkryerit (*kamil*) ndaj asaj më të mangët (*nakis*) është drejtësi, dhe është e njëjta drejtësi me bereqetet e banorëve të xhenetit karshi dënimit të banorëve të xhehenemit, të sakrifikohen njerëzit e kufrit për ata të besimit (iman).

Po të mos ishte krijuar i mangëti, nuk do të njihej as i përsosuri. Po të mos ishin krijuar kafshët, as vlera e njerëzve nuk do të shfaqej.

Edhe përsosmëria edhe mangësia kuptohen nga ndërlidhja mes vete. Domosdoshmëri e bujarisë dhe urtësisë (hikmet) është që mangësia dhe përsosmëria të krijohen së bashku.

Ashtu siç është e drejtë të këputet dora me gangrenë për shpëtimin e trupit, edhe kur të mangëtin e sakrifikon për të përsosurin është njësoj drejtësi, e edhe ndryshimi në ndarjen në mes të njerëzve në këtë botë dhe ahiret është drejtësi.

Kjo temë është një tjetër det që është shumë i madh, i gjerë, i thellë, me anë të gjera e me valë të mëdha, afër detit të tevhidit. Shumë njerëz janë fundosë në këtë det. Ata nuk e dinin thellësinë e tij, sepse atë thellësi e dinë vetëm dijetarët. Në fund të këtij deti është sekreti i kaderit, me të cilin shumë prej tyre janë të mahnitur dhe kanë ndaluar të shpjegojnë atë që e kanë parë.

Shkurtimisht, edhe e mira edhe e keqja janë të caktuara, atë që e ka caktuar Ai, ajo gjithsesi ndodhë duke pasuar Vullnetin e Tij (*meshie*). Nuk ka forcë që mund ta ndryshojë caktimin e Tij. Të gjitha, të mëdha e të vogla, çdo gjë që është përcaktuar, do të ndodh.

Ajo çfarë të ka ndodhur nuk ka mundur të të anashkalojë, e ajo që të ka ikur nuk ka mundur të të gjejë:

“Të gjitha, të mëdhatë e të voglat, janë shënuar në rreshta.” 54-Kamer: 53

Le të mjaftohemi me këtë që e thamë, që i takojnë diturive të zbulimit (*mukashefe*) e që janë themel i gradës së tevekkulit e t'i kthehemi tash, me lejen e Allahut, diturisë praktike (*muamele*). Allahu na mjafton, dhe sa mbrojtës i mirë është Ai!

Pjesa e dytë

PËR TEVEKKULIN DHE GJENDJET E TIJ

Këtu do të flasim për përshkrimin e tevekkulit nga shehlerët, krahas shpjegimeve si vijon: përkufizimi i tevekkulit nga shehlerët, shpjegim i tevekkulit në fitim të furnizimit për atë që jeton vetëm dhe për atë me shumë fëmijë, shpjegim i tevekkulit përmes braktisjes së kursimit, shpjegim i tevekkulit në kompenzimin e dëmit, shpjegim i tevekkulit në largimin e telasheve e të sëmundjes me mjekim, dhe më shumë, e Allahu Teala me rahmetin e Tij është garantues i suksesit!

GJENDJA E TEVEKKULIT

E përmendëm se gradën e tevekkulit e përbëjnë dituria, gjendja dhe veprimi. Për *diturinë* kemi folur veçmas. Sa për *gjendjen*, në realitet tevekkuli përbëhet nga gjendja. Dituria (ilm) është themeli i tij, e veprimi (*amel*), frut. Ata që deshën ta shpjegojnë shkallën e fundit të tevekkulit, e zgjatën shumë. Secili foli nga pozita e vet, për kufirin e vet, e këto janë gjendje të njerëzve të tasavvufit. Nuk ka dobi të citohen të gjitha, prandaj ta heqim perden nga kjo e të themi se *tevekkul* rrjedhë nga *vekale* (dhënie e autorizimit, përfaqësim).

Thuhet: “*Filani, rastin e vet ia dorëzoi (vekele) tjetrit*”, pra, ia lëshoi rastin tjetrit dhe u mbështet në të. Personi i tillë quhet *vekil* (përfaqësues), derisa ky që mbështetet në të quhet *muvekkil*. Sa herë që është i sigurt në të dhe i mbështetet, nuk do të dyshojë për dobësi të tij, e as që do të besojë se te ai ka pafuqi e mangësi. Do të thotë, tevekkuli është mbështetje vekilit.

Të sjellim një shembull të vekilit në një kontest: ta paramendojmë dikë të akuzuar rrejshëm. Ai nuk do të mbështetet në personin që i është caktuar si vekil e që duhet ta zbulojë gënjeshtren, përderisa nuk bindet se ai i posedon katër cilësi: (1) njohuri të plotë të rastit, (2) fuqi të plotë për veprim, (3) përsosmërinë e gjuhës (*fesahat*) dhe (4) dhembshuri.

Sa për njohurinë, vekili pra me këtë do ta zbulojë gënjeshtren, ku asnjë detaj i turbullt dhe asnjë mashtrim nuk do të mbesin të panjohur.

Me fuqi, mendohet në zbulimin e të vërtetës me guxim, duke mos pasë frikë dhe turp. Sepse ai e gjen shumë herë anën e gabuar të kundërshtarit, e mund të mos e tregojë për shkak të frikës, ose turpit, ose ndonjë arsye tjetër.

Sa për përsosmërinë e gjuhës, edhe kjo është pjesë e fuqisë, dhe i përket fuqisë së gjuhës që qartazi ta thotë atë që zemra e tregon. Nuk është secili dijetar në gjendje të tregojë çdo gabim që e gjen.

Dhe në fund, kur bëhet fjalë për dhembshurinë, kjo nënkupton se duhet të angazhohet plotësisht për personin që e mbronë (muvekil). Nëse nuk tregon vëmendje, vetëm fuqia nuk do të mjaftojë, ndërsa është kusht që vekili ta mbrojë të drejtën e tij.

Nëse dyshon në këto katër cilësi, ose së paku në njërin nga to, ose lejon që kundërshtari të jetë më i mirë në to, besueshmëria ndaj vekilit zvogëlohet. Zemrën do ta ketë të shqetësuar, e brenga do ta detyrojë të provojë dhe të kompenzojë mangësitë e vekilit e kështu ta mposhtë kundërshtarin. Gjendja e tij ndryshon në raport me besimin ndaj vekilit të tij. Pra, kështu ndryshojnë gjendjet e muvekkilit, deri sa i beson plotësisht vekilit, për shembull, nëse vekili mbledhë mallra për muvekkilin pa u kujdesur a është hallall apo haram.

Muvekkili beson që vekili përdor të gjitha mundësitë nga dhembshuria e tij dhe kështu siguron një nga katër cilësitë që duhet të posedojë vekili.

Në këtë mënyrë, duhet të mendohet se vekili me siguri i posedon edhe cilësitë tjera. Kjo është e mundur me prova të gjata dhe me përhapjen e fjalës përt të si më i famshëm, më i aftë në shpjegim, më të përgaditurin për të ndihmuar të vërtetën dhe si njeriu më i aftë që mund të ndajë të vërtetën prej gënjeshtërs.

Nëse përmes këtij shembulli e ke kuptuar tevekkulin në domethënien e tij të gjerë, edhe tevekkulin konkretisht - mbështetjen në Allahun Teala, mund ta krahasosh me këtë. Nëse te ti vendoset besimi, qoftë me *keshf* ose me bindje të fortë (*i'tikat*), se nuk ka bërës tjetër pos Allahut, ashtu si tashmë e treguam, e bashkë me këtë beson plotësisht në diturinë e plotë të Tij, në fuqinë e Tij që t'ju mjaftojë robëve të Tij, plotësinë e mirësisë dhe kujdesit ndaj të gjithë grupeve shoqërore dhe individëve, se pas fuqisë së Tij nuk ka fuqi tjetër, pas diturisë së Tij nuk ka dituri tjetër, pas kujdesit të Tij ndaj teje dhe mirësisë së Tij nuk ka tjetër kujdes e mirësi – në atë rast zemra jote, pa dyshim, i është mbështetur Atij, të Vetmit, duke mos u kthyer kah askush tjetër, bile as kah forca e vet, sepse fuqia dhe forca janë vetëm prej Allahut.

Nëse nuk mund ta gjesh këtë gjendje në vete, ka dy arsye për këtë:

Arsyeja e parë është njohuria e dobët për ndonjë prej katër cilësive që i përshkruam, dhe e dyta është dobësia e zemrës, sëmundja e saj e cila vërehet me dominimin e qyqarllëkut dhe shqetësimit (e frikës) dhe me lloj-lloj fantazie. Sepse zemra, edhe nëse nuk ka dobësi në bindje, ndonjëherë mund të shqetësohet duke iu nënshtruar frikës. Nëse personi, për shembull, merr mjalt e pastaj i vjen në mendje ndonjë arsyetim, ndoshta natyra e tij ia refuzon mjaltin. Nëse dikujt do t'i duhet të flejë me të vdekurin, në dhomë të njëjtë, natyra do t'ia refuzonte këtë, ani pse e di se ai është i vdekur, trup i palëvizur, dhe ani pse e di se deri sot nuk ka ringjallje të një të vdekuri në ligjin Hyjnor, ai nuk dëshiron të jetë vetëm në një dhomë me të vdekurin. Nuk frikësohet nga të tjerët të pajetë, por prej tij po. Kjo është frikë dhe një lloj dobësie në zemër, dhe sado e vogël që është, njeriu nuk mund të shkëputet plotësisht nga kjo. E nëse shtohet, atëherë bëhet sëmundje, aq sa frikësohet edhe të flejë vet në dhomë të mbyllur.

Prandaj, *tevekkul* kompletohet me forcën e zemrës dhe forcën jekin, të dyja bashkë. Sepse qetësia e zemrës kompletohet vetëm me këto dyja. Qetësia në zemër është tjetër dhe bindja është tjetër. Sa shumë ka jekin që me të nuk ka qetësi, sikur në rastin e Ibrahimit a.s., kur Allahu Teala i tha:

- ***A nuk ke besuar?...***, e Ibrahim (a.s.) tha:
- ***Unë kam besuar, por po dëshiroj të më qetësohet zemra!*** (2-Bekare: 260)

Ibrahimi a.s., kishte besuar bindshëm në ringjalljen e të vdekurit, por ai dëshiroi ta shihte me sytë e vet, për tu vendosur në imagjinatën e tij (*haja*). Sepse nefs i përshtatet imagjinatës dhe qetësohet me të, prandaj ai nuk mund të jetë i qetësuar në gjendjen e parë me jekin, përderisa të mos arrijë gradën e nefsit të qetësuar (*en-nefsul-mutme'inna*).

Sa ka të qetësuar (*mutme'inn*), e që nuk kanë jekin, siç janë pjesëtarët e besimeve tjera dhe sekteve të ndryshme. Çifuti është me zemër të qetësuar në hebraizmin e vet, njëjtë i krishteri në fenë e tij, ani pse aspak nuk kanë jekin, por i pasojnë supozimet e veta dhe teket e nefsit. Megjithëse, atyre ju ka mbërritur udhëzimi nga Rabbi i tyre, e që është sepse për jekin, por ata u larguan prej kësaj.

Do të thotë se frika dhe guximi janë që nga lindja, e bashkë me to, jekini nuk sjell dobi, dhe kjo është një nga sebePET, të kundërt me tevekkul.

Kur këto sebepe mblidhen, besimi në Allah bëhet më i fortë. Thuhet se në Tevrat është e shkruar: *“I mallkuar është ai që pret madhështi prej dikujt si vetja!”*

E Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush mbahet më i madh se robët (njerëzit si vetja), Allahu Teala e përulë atë.”²⁴

Pasi e di kuptimin e tevekkulit dhe gjendjen e quajtur *tevekkul*, dije që kjo gjendje ka tri shkallë të forcës dhe të dobësisë.

Shkalla e parë është ajo që tashmë e kemi përmendur, pra, gjendja e mbështetjes në Allahun Teala, duke besuar në kujdesin e Tij, siç i mbështetet vekilit.

Shkalla e dytë është më e fortë dhe shihet në marrëdhënien e tij ndaj Allahut Teala sikur fëmija i vogël me të ëmën, që nuk njeh askë tjetër pos saj, as nuk i dorëzohet dikujt tjetër pos saj, siç edhe i mbështetet ekskluzivisht vetëm asaj. Kur e sheh, i kapet për rroba e nuk e lëshon. Nëse i ndodhë diçka në mungesë të saj, fjala e parë që do ta thotë do t'i jetë: *“oh nëna ime!”*

²⁴ Ukajli në librin ‘*Duafa*’, dhe Ebu Nuajm në ‘*Hilje*’ nga Omeri r.a.

Në zemër, më së pari i kujtohet nëna. Ajo është strehimi i tij. Ai mbështetet në kujdesin e saj, në brengën e saj ndaj tij dhe në bashkëndjenjën e saj, në atë mënyrë që nuk është ndryshe prej një vlerësimi që e posedon i rrituri.

Konsiderohet se kjo është prej natyrës. Sikur t'i kërkohej që t'i shpjegojë në detaje ato cilësi, ai nuk do të mund ta bënte këtë, e as t'i sjellë ndër mendje. Krejt kjo e tejkalon njohjen.

Ai që mendon vetëm në Allahun Teala, kthehet kah Ai dhe mbështetet te Ai, do t'i dhurohet cilësia e përmendur, siç i dhurohet fëmijës për nënën e vet. Do të ketë tevekkul të pastër, njëjtë si fëmija, që me gjithë qenien e vet i mbështetet nënës.

Dallimi mes të dyjave është në atë që fëmija i lidhur me nënën nuk di për tevekkulin në zemrën e vet; ai njeh vetëm nënën e tij. Nuk është më e mundur ta ndërrojë atë për diçka tjetër. Ai zhduket në atë mbështetje. Por, ai që mbështetet Allahut nuk është kështu. Sepse, mbështetja e tij është e vetëdijshme. Kjo vetëdije e bën të mendojë për tevekkulin e vet edhe për gjendjen e tevekkulit të vet.

Kur e pyetën Sehl et- Tusterin se cila është grada më e ulët e tevekkulit, duke dhënë një shenjë të kësaj, tha:

- *Braktisja e dëshirave.*

U pyet pastaj për gradën e mesme, e tha:

- *Braktisja e zgjedhjes.*

Në fund e pyetën për tevekkulin më të lartë, por Sehl nuk e definoi, vetëm se tha:

- *Këtë e njeh ai që e arritë gradën e mesme.*

Grada e tretë është grada më e lartë e tevekkulit; ku personi para Allahut Teala, në lëvizje dhe qetësi, duhet të jetë si i vdekuri para atij që lan të vdekurin.

Me fjalë tjera, beson se fuqia e përjetshme (*ezel*) e lëviz atë ashtu si e lëviz xhenazen dora e atij që e lan xhenazen. Personit që i është forcar bindja (*jekin*) se lëvizja e tij, fuqia, vullneti, dituria dhe cilësitë e tjera janë prej Allahut, ai pret atë çfarë do të ndodhë, dhe këtu dallon nga fëmija. Për shkak se fëmija strehohet tek nëna e tij, ai qanë, i kapet për rroba dhe vrapon pas saj. E pronari i tevekkulit, është ndoshta si një fëmijë i mençur, i cili do ta dinte saktë se, edhe nëse nuk qanë, nëna do ta kërkojë, edhe nëse nuk i kapet për rroba, ajo do ta merr në krahë, edhe nëse nuk kërkon qumësht, ajo do ta ushqejë. Prandaj nuk shqetësohet.

Edhe personi që është në këtë gradë, bëhet i tillë. Kjo gradë e tevekkulit është braktisja e duasë dhe dëshirës duke u mbështetur në fisnikërinë dhe kujdesin e Allahut Teala. Kjo lind nga vet gjendja e tij; ai e di se Allahu i jep edhe më shumë se sa dëshiron, sepse e sheh se nimetet i jepen pa i kërkuar e pa i merituar.

Dallimi midis gradës së dytë dhe të tretë është se ai që është në gradën e dytë nuk e braktisë duanë dhe kërkesat, ani pse kërkon vetëm prej Allahut, jo nga dikush tjetër. E ai që është në shkallën e tretë, nuk kërkon asgjë.

Nëse ti pyet se a është e mundur të paramendohen ekzistencat e gjendjeve të tilla, atëherë dije se diçka e tillë nuk është e pamundur, por ato gjendje janë shumë të vlefshme e të rralla. E dyta dhe e treta janë grada më të larta, derisa grada e parë është më e lehtë të arrihet.

Nëse arrin në gradën e dytë dhe të tretë, aty vazhdueshmëria është shumë e vështirë. Në gradën e tretë kalon aq shpejt, pothuaj si zbardhja e ngjyrës së fytirës kur njeriu frikësohet. Hapja e zemrës duke e menduar forcën dhe fuqinë është natyrore. E kundërta e kësaj është e përkohshme.

Kur njeriu frikësohet, gjaku tërheqet, pra *frikësim* është shprehje që tregon për tërheqjen e gjakut nga e jashtmjja e lëkurës në të brendshmen e saj, me ç'rast nga lëkura largohet ngjyra e ngjyrtë që ishte aty. Lëkura është një perde e hollë përmes së cilës është e mundur të vërehet gjaku, prandaj tërheqja e gjakut e bën atë të zbehët. Por kjo nuk zgjatë. Njëjtë, edhe tërheqja e plotë e zemrës nga fuqia, forca dhe shkaqet tjera të dukshme, nuk vazhdon shumë.

Në gradën e dytë, ai i përngjanë verdhësisë së atij që ka ethe, e kjo mund të zgjasë një apo dy ditë, derisa grada e parë i përngjanë verdhësisë së pacientit të cili sëmundja është përhapur, të cili nuk habitë nëse kjo gjendje i zgjatë, bile ndodhë edhe fare të mos i kalojë.

Nëse ti pyet: *Te personi që është në këto gjendje, a ka ndonjë situatë në të cilën ai merr masë dhe ndërlihet me se bënë?*; atëherë dije se në gradën e tretë nuk ka aspak diçka të tillë, përderisa të zgjasë ajo gjendje. Bile, dikush që është në atë gradë është si i hutuari. Në gradën e dytë braktisë çdo masë, por strehohet tek Allahu si fëmija të nëna e vet.

E në gradën e parë nuk e braktisë esencën e marrjes së masave dhe zgjedhjes së lirë, por braktis disa masa, sikur ai që i beson vekilit të vet për ndonjë kontest; dhe braktisë secilën masë që nuk vjen nga vekili i vet, por nuk braktisë asnjë masë të cilës vekili ia nënvizon rëndësinë. Bile, nuk i braktisë as masat pa ndonjë shenjë të qartë, por që dihet se janë nga adeti i vekilit.

Për shembull, nëse vekili thotë:

- *Unë flas vetëm në praninë tënde;*

muvekkili padyshim që merr masa që të jetë gati. Kjo nuk është në kundërshtim me tavekkulin. Sepse kjo nuk është mbështetje as në forcën e vet, e as në forcën e dikujt tjetër. Ndoshta, për shkak të besueshmërisë së tij të plotë vekilit, i përshtatet kërkesës së tij. Sepse nëse nuk do të kishte besim në vekilin, as nuk do të dëgjonte fjalën e tij. Sa për ato që i di nga përvoja; ai e di se vekili i vet do ta luftojë kundërshtarin e këtij vetëm me dosje të kompletuar në dispozicion. Nëse plotësisht i mbështetet vekilit, si rezultat i kësaj, ky i siguron dokumentet që i kërkon vekili. Pra, muvekkili nuk është i çliruar nga prania e vekilit, e as nga përgatitja e dosjes. Nëse braktis diçka nga kjo, tavekkuli i tij do të jetë me të meta.

Ndërsa, kur pret i habitur në praninë e vekilit, i vetëdijshëm, pasi t'i ketë zbatuar kërkesat e tij, është sikur të jetë ngritur në gradën e dytë dhe të tretë, dhe asnjë forcë tjetër nuk kërkohet prej tij. Sepse i ka përmbushur kërkesat. Ky, duke iu mbështetur vekilit, në qetësi ndjek rrjedhën e punës.

Kur të mendosh për këto që t'i thashë, të gjitha dyshimet në lidhje me tevekkulin do të zhduken dhe do ta kuptosh se, siç nuk është nga kushtet të tevekkulit braktisja e të gjitha masave, njëjtë nuk është tevekkul të merresh me çdo masë. Ne do ta shpjegojmë këtë në detaje kur të flasim për veprimet.

Pra, nëse muvekkili merr masa paraprake të nevojshme për të siguruar dokumentet dhe të jetë i pranishëm në gjykatë, kjo nuk është e kundërt me tevekkulin e tij. Sepse ai e di se po të mos ishte vekili, prezenca e tij dhe sigurimi i dokumenteve do të ishin të pavlerë, lodhje e thjeshtë, pa kurrfarë dobie. Në këtë çështje nuk ka dobi nga forca dhe fuqia e vet. Ndoshta vekili, pjesëmarrjen e tij dhe sigurimin e dokumenteve e ka pranuar si një mbështetje në trajtimin e çështjes, e për këto e ka njoftuar muvekkilin me shenja dhe me adetin e vet.

E gjithë forca dhe fuqia janë vetëm të vekilit, ani pse një shembull i këtillë nuk e jep plotësisht kuptimin e asaj që po e flasim, pasi që vekili nuk është krijues i forcës dhe fuqisë së vet. Ndoshta ky vekili e bëri të dobishme forcën dhe fuqinë. Kjo është e vërtetë në kuptimin e plotë vetëm për vekilin e vërtetë. Ai është Allahu Teala, sepse Allahu Teala e krijon forcën dhe fuqinë, që ne e sqaruam në pjesën e tevhidit.

Allahu Teala i bën ato të dobishme, sepse Ai i krijoi sebebet dhe mjetet për të qenë ato të dobishme. Pra, forca dhe fuqia e vërtetë i përket Allahut.

Ai që e dëshmon këtë do të ketë shpërblim të madh, që e premton hadithi për atë që thotë:

“La havle ve la kuvvete illa bilah”

*(Fuqia dhe forca janë vetëm prej Allahut).*²⁵

Kjo nganjëherë mund të jetë edhe e habitshme, duke hapur pyetjen se si të jepet gjithë ai shpërblim për vetëm këtë fjali, të lehtë për gjuhën? Ata nuk e dinë se ky shpërblim është shpërblimi i perceptimit që e përmendëm në kapitullin e tevhidit.

²⁵ Hadithi për këtë është përmendur në *Librin për dua*të.

Ndryshimi në shpërblim për fjalitë:

La havle ve la kuvvete illa bilah, në krahasim me shpërblimin për fjaltë

'La ilahe illallah' është sikur ndryshimi në kuptimet mes këtyre dy fjalive.

Sepse, në shprehjen:

La havle ve la kuvvete illa bilah, vetëm forca dhe fuqia ndërlidhen me Allahun Teala, ndërsa në fjalinë

La ilahe illallah, gjithçka ndërlidhet me Allahun.

Mendo për dallimin mes gjithçkaje dhe dy gjërave, dhe kupto dallimin e kelime-i tevhidit (*la ilahe illallah*).

Siç thamë edhe më parë që tevhidi i ka dy lëvozhga dhe dy bërthama, ashtu i ka edhe fjalja:

La havle ve la kuvvete illa bilah, e edhe fjalitë tjera të ngjashme në të njëjtën mënyrë i kanë dy lëvozhga dhe dy bërthama.

Shumica e njerëzve janë të lidhur për lëvozhgat, duke mos kaluar në bërthamë, e kjo sipas hadithit:

"Kush thotë La ilahe ilallah nga zemra, me besnikëri dhe singëritet, e ka merituar xhennetin."²⁶

²⁶ Taberani, nga Zejd ibn Erkam, si edhe Ebu Ja'la nga Ebu Hurejre r.a..

Pushteti nuk arrihet me të folur, e lëvizja e gjuhës është vetëm llaf dhe shprehje. Edhe besimi i zemrës është gjithashtu një fjalë, e kësaj i thuhet *hadithi nefs*. Besnikëria dhe singeriteti vijnë pas kësaj. Bota e melekutit ju hapet, shtrihet e stoliset vetëm mukarrebunëve, të afërtit dhe të singertët e vërtetë.

Natyrisht, edhe atyre që janë me fat e ju afrohen këtyre me grada shpirtërore, te Allahu Teala ju takojnë grada të veçanta. A nuk e sheh se, kur Allahu Teala në suren Vakia i përmend *mukarrebunët* dhe sabikunët, njoftoi për zbukurimin e melekutit, duke thënë:

**“në divane të qëndisura (me gurë të çmuar),
mbështetur në to, karshi njëri tjetrit”**

(56-Vakia: 15,16), por kur tregon për *as’habi jemin*, u mjaftua me përmendjen e ujit, flladit, frutave, pemëve e hyrive, dhe nuk përmendi asgjë tjetër përveç kënaqësive të asaj që pihet e hahet dhe kënaqësive të martesës. Ndërsa këto janë kënaqësi që vazhdimisht i shohim te kafshët.

E kafshët janë nga kjo botë, ata nuk kuptojnë asgjë nga kënaqësitë e xhenetit, edhe po të ishin në shkallën më të lartë në xhenet. Nëse këto kënaqësi do të kishin vlerë, ato nuk do t’ju jepeshin kafshëve, dhe gradat e melekëve nuk do të ishin më të larta se të tyre.

A nuk i shikon gjendjet e kafshëve? Ato përdoren për bartje, shëtisin në lëndina, pinë ujë, qëndrojnë në hijet e pemëve, hanë ushqime të ndryshme, sigurojnë nevojat e tyre në mënyrën më të përsosur.

A mendon se kjo gjendje e tyre është më e këndshme se sa gjendja e melekëve? Sepse te melekët nuk ka asgjë nga këto. E melekët në gradën më të lartë në xhenet (*a'la-i illijjin*) janë afër Allahut. Si mund ta braktisë njeriu Xhebrailin dhe veten e të bie në nivelin e gomarit?

Dihet se të ngjashmet e tërheqin njëra tjetrën dhe se ka më shumë të tillë që janë të prirë për zanatin e këpuctarit se sa për shkrim. Natyra dhe karakteri i tyre më shumë anon kah këpuctaria se sa shkrimi. Njëjtë është ai që ka prirje më shumë për kënaqësitë e kafshëve sesa kënaqësitë e melekëve. I tilli, padyshim, më shumë i përngjanë kafshës se sa melekut.

Për ta thuhet:

“Ata janë si kafshët, bile edhe më të hutuar.”

7-Araf: 179

Ata janë janë më të hutuar se kafshët, sepse kafshët nga krijimi nuk kanë mundësinë të kërkojnë gradën e përsosmërisë. Pra, mos-kërkimi i përsosmërisë nga ana e tyre është për shkak të paaftësisë së tyre. Njeriu e ka këtë aftësi. Ai ka pjekuri dhe mundësi. E ai që ka mundësi të arrijë përsosmërinë, por nuk mundohet në këtë drejtim, meriton qortimin.

Meqenëse këto fjalë largojnë nga tema kryesore, më mirë t'i kthehemi qëllimit.

Tashmë e kemi shpjeguar kuptimin e fjalëve

La ilahe illallah, dhe

La havle ve la kuvvete illa bilah’;

personi i cili nuk i thotë me vetëdije dhe nuk ua di kuptimin, te ai as nuk mund të paramendohet gjendja e tevekkulit.

Ti mund të thuash: *Nga fjalët:*

La havle ve la kuvvete illa bilah,

ka vetëm dy gjëra që ndërlidhen me Allahun Teala, dhe ka një shpërblim aq të madh. A do të ketë shpërblimin (sevapin) e njëjtë dikush që thotë: ‘Qiejt dhe Tokën i ka krijuar Allahu’?; e unë them se jo, nuk do të ketë shpërblim të njëjtë.

Sepse, sevapi (shpërblimi) matet me vlerën e asaj nga e cila fitohet ai sevap. Dy të ndryshme assesi nuk mund të jenë të ngjashme. Mos shiko madhësinë e qiejve e Tokës, nëse mund të flitet në mënyrë figurative për vogëlsinë e forcës dhe fuqisë.

Vlerat nuk maten sipas madhësisë. Të gjithë e dinë se Toka dhe qiejt janë krijuar nga Allahu, e jo nga njerëzit. Por rasti i forcës dhe fuqisë është i veçantë, së paku për mu'tezelitë, filozofët dhe shumë grupe tjera që merren me cikërrima sa edhe fija e flokut, dhe mendimet e tyre janë të ndryshme, e në fakt ky është një vend i rrezikshëm ku këmba mund të rrëshqasë.

Aty janë shkatërruar të pakujdesshmit, sepse konkluduan se ata posedojnë diçka, e kjo në tevhid nuk është gjë tjetër pos shirk, duke pohuar krijues tjetër pos Allahut. Ai që me ndihmën e Allahut e kalon këtë pengesë, grada e tij shpirtërore ngritet dhe pozita shpirtërore i forcohet. Ky është personi i cili i përjeton plotësisht fjalët ***La havle ve la kuvvete ila bilah***, e tashmë treguam se në tehvid janë vetëm dy pengesa. Njëra është 'vrojtimi' i qiejve dhe Tokës, Diellit, Hënës, yjeve, reve, shiut dhe materieve tjera jo të gjalla, deri sa tjetra është 'vrojtimi' i vullnetit të krijesave të gjalla, që është edhe pengesa më e madhe dhe më e rrezikshme.

Të kalohen këto do të thotë të arrihet plotësisht fshehtësia e tevhidit, që është edhe sevapi më i madh i fituar për ato fjalë. Prandaj, esenca e tevekkulit është në braktisje të forcës dhe fuqisë tënde, e mbështetje në të Vetmin (Vahid), të Vërtetin (Hakk). Kjo do të jetë edhe më e qartë inshallah, kur të flasim për veprimet e veçanta që ndërliken me tevekkul.

FJALËT E SHEHLERËVE PËR GJENDJET E TEVEKKULIT

Me këto fjalë të shehlerëve, qëllimi ynë është të shpjegojmë se ajo që ata e thanë nuk është asgjë tjetër nga ato që ne i kemi thënë. Por, secili prej shehlerëve ka treguar vetëm për njëdonjë prej gjendjeve të tevekkulit. Ebu Musa ed-Dejbili tregon se e ka pyetur Ebu Jezid Bistamiun se çfarë është tevekkul, e Bistamiu tha:

- *E çfarë thua ti?*; e Ebu Musa tha:

- *Mësuesit tanë thanë: “Edhe nëse grabitqarët dhe gjarpërinjtë ju rrethojnë nga e djathta dhe e majta, zemra juaj nuk duhet të dridhet.”* Atëherë Bistamiu tha:

- *Mirë kanë thënë, edhe kjo është afër tevekkulit! Por, kur banorët e xhennetit kënaqen në xhennet dhe banorët e xhehenemit të vuajnë në xhehenem, e ti të bësh dallim mes tyre, veç ke dalë nga tevekkuli.*

Ebu Musa na njofton për gjendjen më të lartë të tevekkulit, pra për gradën e tretë të tevekkulit, ndërsa fjalët e Bistamiut janë nga kategoritë më të larta të diturisë, që shpjegojnë esencën e tevekkulit. Kjo është dituri e hikmetit dhe atë që e ka thënë Allahu Teala ajo është e domosdoshme të ndodhë; sipas esencës së diturisë dhe hikmetit, nuk ka dallim mes banorëve të xhennetit dhe atyre të xhehenemit.

Kjo është më e vështira dhe më e thella nga llojet e diturisë. Pas kësaj vjen sekreti i kaderit, që është i ndaluar të shpjegohet. Ebu Jezid Bistamiu flet gjithmonë nga gradat dhe gjendjet më të larta.

Në gradën e parë të tevekkulit, mbrojtja nga gjarpërinjtë nuk është e kundërt me tevekkulin. Ebu Bekr r.a., ishte mbrojtur nga ta në shpellë²⁷, kur i mbylli vrimat e tyre, deri në atë masë sa transmetohet se këtë e bëri edhe me këmbën e vet, e që kjo aspak të mos ketë ndikuar në zemrën e tij.²⁸ Thuhet se këtë e bëri nga dhimbshuria që kishte për Resulallahun s.a.v.s., e jo për vete, e humbja e tevekkulit lidhet me aktivizimin e zemrës për një punë të veten.

²⁷ Shpella në të cilën, gjatë Hixhrit me Resulallahun s.a.v.s., u fshehën nga mushrikët që po i ndiqnin nga Meka.

²⁸ Hadithi tashmë është përmendur.

Megjithatë, ne do të tregojmë se as diçka e ngjashme, bile edhe më shumë, nuk e kundërshton tevekkulin. Pra, aktivizimi i zemrës për shkak të gjarprit quhet frikë, derisa ai që mbështetet në Allahun Teala duhet të ketë frikë vetëm nga Allahu, i Cili udhëheq me gjarprin. Ato nuk kanë forcë as fuqi, pos me Allahun.

Nëse ikë nga frika dhe merr masa, nuk do të thotë se mbështetet në forcën dhe fuqinë e vet, por mbështetet në forcën, fuqinë dhe përcaktimin e Allahut Teala, e kjo nuk është e ndaluar.

E pyetën Dhunnun-i Misrin çka është tevekkul, e tha:
“Është mospranimi për zot askënd përvec Allahut, që është shenjë e tevhidit, si edhe ndërprerja e sebepeve, e kjo është shenjë e veprimit.”

Me pjesën e parë ka treguar për diturinë e tevhidit, e me pjesën e dytë, për veprat. Megjithatë, me këtë thënie nuk tregohet përkufizimi i saktë i gjendjes së vërtetë të tevekkulit. Prandaj edhe i thanë:

- *A mund të na e shpjegosh pak më shumë?;* e ai tha:
- *Të gjesh kënaqësi në robërim, jo në madhështi.*

Kjo është shenjë e largimit vetëm nga forca dhe fuqia.

Edhe Hamdun el-Kassar in e pyetën për tevekkul, e ai tha: *“Sikur t’i kishe dhjetëmijë dërhëmë e të kesh një dërhëm borxh, nuk duhet të jesh i sigurt se mund ta kthesh borxhin. Por, edhe sikur të kishe borxh dhjetëmijë dërhëmë, nuk duhet të humbasësh shpresën se nuk mund ta kthesh atë borxh.”*

Ky është tregues për gjerësinë e fuqisë së Allahut dhe në caktimet e Tij ka lidhje të padukshme, përveç atyre të dukshmeve.

Ebu Abdullah el-Kureshi për tevekkul, tha:

“Tevekkuli është lidhja për Allahun në çdo situatë”;
e kur e lutën ta shpjegojë më shumë, tha:

- Është braktisja e secilës lidhje që çon te lidhja tjetër (shkak-pasojë), deri sa krejt çështja të lihet në duart e Hakkut.

Ky tevekkul është si tevekkuli i Ibrahimit a.s., kur Xhebraili a.s., e pyeti:

- ***A ke nevojë për diçka?***; e Ibrahimit a.s., iu përgjigj:
- *Nuk dua asgjë prej teje.*

Tha kështu sepse pyetja e Xhebrailit a.s., ishte sepse që dërgon te një tjetër sepse; pra në mbrojtjen e Ibrahimit a.s., nga Xhebraili a.s..

E braktisi ndihmën e Xhebrailit a.s., duke besuar se Allahu Teala, nëse Ai do, e detyron Xhebrailin a.s., që ta mbrojë Ibrahimin a.s.; ai nuk e shikoi Xhebrailin a.s., sepse e kishte besimin te Allahu. Kjo është gjendja e atij që është dalldisur në botën shpirtërore, që nuk e sheh më askënd përveç Allahut. Kjo është një gjendje shumë e rrallë, një gjendje e lartë, që kalon shpejtë.

Ebu Seid Harraz ka thënë: *“Tevekkul është qetësi pa lëkundje dhe lëkundje pa qetësi.”*

Me këtë përshkrim është e mundur që e ka treguar gradën e dytë. Qetësia pa lëkundje është lidhja e zemrës me Allahun për të gjetur qetësi, e lëkundja pa qetësi është lutja për strehim te Allahu. Si fëmija kur kthehet pranë nënës së tij dhe aty gjen qetësi me dhembshurinë e saj.

Ebu Ali ed-Dekkak ka thënë:

“Tevvekuli i ka tri shkallë: tevekkul, teslim (dorëzim) dhe tefviz (braktisje, ai që çdo gjë ia dorëzon Allahut Teala). I pari, mutevekkili, beson në premtimin e Allahut, i dyti, ai që dorëzohet, është i kënaqur (razi) me diturinë e Tij, e i treti, është i kënaqur (razi) me çfarëdo vendimi të Allahut Teala.”

Kjo tregon që këndvështrimi i personit është i ndryshëm në krahasim me atë që shikohet. Dituria është themeli. Pasohet nga premtimi, e pas kësaj vjen vendimi. Personi që mbështetet Allahut Teala, nuk është për t'u habitur që mendon diçka nga këto. Sepse të mësuarit e tyre përmes keshfit është më i dobishëm se sa tregimet dhe transmetimet.

Këto janë në lidhje me gjendjen e tevekkulit. Shehlerët kanë shumë më tepër fjalë për tevekkul, por ne mos ta zgjasim. Dëshirojmë ndihmën e Allahut.

VEPRIMET E ATYRE QË I MBËSHTETEN ALLAHUT

Dije se, nga dituria (*ilm*) lind gjendja (*hal*), e nga gjendja lind veprimi (*amel*).

Disa mendojnë se *tevekkul* është braktisje e angazhimit fizik (mosveprim) dhe përgatitjes me zemër. Ashtu mendojnë injorantët. Kjo, me sheriat është haram (e ndaluar). Si mund të arrihet një gradë e fesë përmes asaj që feja e ndalon?

Duke e ngritur perden këtu, themi se veprimi i tevekkulit shfaqet në përpjekjet e personit sipas diturisë së vet, në qëllimin e vet. Përpjekjet e njeriut me fuqinë e vullnetit janë për arritjen e ndonjë dobie që për momentin nuk e ka, për ndonjë përfitim, ose për ruajtjen e ndonjë dobie që tashmë e ka, siç është kursimi, ose për mbrojtje nga dëmi që mund të paraqitet, siç është sigurimi nga hajnat dhe kafshët grabitqare, ose mbrojtje nga dëmi që tashmë është paraqitur, siç është mjekimi nga sëmundja.

Pra, lëvizja e personit nuk del jashtë këtyre katër rasteve: përfitimi i dobisë, ruajtja e dobisë, mbrojtja nga dëmi dhe largimi i dëmit.

Le të shpjegojmë tani shkallët e tevekkulit për secilin nga këto katër raste, duke u bazuar në dëshmitë e sheriatit.

Rasti i parë PËRFITIMI I DOBISË

Sebepet me të cilat mund të sigurohen gjërat e dobishme janë tri kategorish: e para është sebepi i sigurt, e dyta është dyshimi i fortë dhe e treta është një gjë e supozuar me të cilën nefsia nuk mund ta lidhet plotësisht dhe nuk mund të jetë i qetë.

Kategoria e parë,
sebepi i sigurt, shihet në rastin kur sebebpet janë direkt të lidhura me caktimin e Allahut dhe dëshirën e Tij, sikur kur para teje të vendoset ushqimi, e ti je i uritur dhe të duhet ushqim, por nuk e zgjatë dorën për të marrë ushqimin, e thua: *“unë i mbështetem Allahut, Ai do të më ushqejë”*, sepse si kusht i tevekkulit llogaritet edhe braktisja e angazhimit, e këtu ka angazhim e lëvizje në zgjatje të dorës, si dhe në përtypje dhe gëlltitje të ushqimit. Kjo është budallallëk me brirë!

Kjo nuk ka kurrfarë lidhje me tevekkul. Nëse ti pret që Allahu Teala të *mbjellë* në ty ngopjen pa ngrënë, të bëjë që ushqimi të vij tek ti e ta urdhërojë një melek që ta përtypë ushqimin për ty e ta vendosë në lukthin tënd, atëherë ti vërtetë nuk ke dituri për ligjin e Allahut.

Njëjtë nëse nuk mbjell, e pret që Allahu Teala ta mbushë arën me grurë, ose që gruaja jote të lind fëmijë pa pasur marrëdhënie, si Mejremi r.anha, kjo vërtetë do të ishte çmenduri. Në këtë gradë, tevekkuli nuk është me veprim, por me gjendje (*hal*) dhe dituri (*ilm*).

Sa për diturinë, dihet se Allahu krijoi ushqimin, dorën, dhëmbët, forcën e lëvizëse, dhe në realitet është Ai që ty jep ushqim e pije.

Sa i përket gjendjes; qëtësimi i zemrës tënde dhe besimi yt të jetë në veprimin e Allahut, jo në duart e tua e në ushqim.

Si mund të besosh në forcën e dorës tënde, kur përnjëherë mund të paralizohet, e ta humbë funksionin?! Si mund të besosh në forcën tënde, kur përnjëherë mund ta humbasësh mendjen, e forca e lëvizjeve tua shfuqizohet e bëhet e pavlerë?! Si mund të besosh që ushqimi para teje është i sigurt kur Allahu Teala mund të bëj që dikush ta marrë atë ushqim prej teje, ose ta dërgojë një gjarpër aty, e të largon ty nga ai ushqim?!

Për të gjitha këto dhe të ngjashme, nuk ka ilaç tjetër përveç ndihmës së Allahut, prandaj beso në ndihmën e Tij dhe vetëm Allahut mbështetju. Nuk është pengesë për tevekkulin e personit në këtë gjendje që të zgjasë dorën e tij drejt ushqimit.

Kategoria e dytë

janë sebetet të cilat nuk janë aq të sigurt, por megjithatë në mungesë të tyre, pasojat nuk ndodhin. Të mendohen të realizueshme pasojat e tyre në mungesë të vet këtyre sebepeve, është goxha e pamundur. Shembull i kësaj është si personi që udhëton pa ushqim nepër shkretëtirë, ku njerëzit gati nuk kalojnë kurrë. Diçka e këtillë nuk është kusht për tevekkul; personi që del në shkretëtirë, është e nevojshme të bartë me vete ushqim. Është adet i *selefi salihin* që të merret me vete ushqim në shkretëtirë. Ushqimin e merr, por i mbështetet Allahut e jo ushqimit, siç folëm edhe më herët. Por, të niset në një udhëtim të tillë pa ushqim, megjithatë lejohet. Bile, kjo është një nga gradat më të larta të tevekkulit. Prandaj edhe e praktikonin vetëm të veçantit (*havas*).

Nëse thua se kjo është hedhje e vetes drejt e në rrezik dhe vdekje, atëherë dije se për të qenë hallall udhëtimi në shkretëtirë pa ushqim, ka dy kushte:

Kushti i parë është kur personi, duke e luftuar nefsin, e edukon atë që të durojë pa ushqim për rreth një javë, kështu që gjatë kësaj kohe në zemër nuk ndjen vështirësi në ibadet as ndonjë vesvese.

Kushti i dytë është të jetë i gatshëm të ushqehet me barishte. Pasi të plotësohen këto dy kushte, në të shumtën e rasteve, pas shtatë ditësh të kaluara në shkretëtirë, është e mundur që e takon dikë, ose mbërrin në ndonjë fshat, apo kasollë, ose së paku në barishte, e që do t'i mjaftojë. Pra, luftimi i nefsit është shtylla e tevekkulit.

Ja, kështu i mbështeteshin Allahut të veçantit dhe ata që këtyre ju përngjajnë. Dëshmi e kësaj është edhe fakti se Havvasi gjithmonë me vete kishte gjilpërë, një thikë të vogël, litar dhe një kovë, e thoshte: “ *Këto nuk janë në kundërshti me tevekkulin.*”

Ai e dinte se në shkretëtirë nuk ka ujë të rrjedhshëm, se nuk mund të nxjerret ujë nga bunari pa kovë e litar, se në shkretëtirë nuk mund të gjejë aq lehtë litar e kovë, se uji nevojitet çdo ditë, për abdes disa herë në ditë, e për të shuar etjen një herë në ditë ose edhe në dy ditë, pra, e dinte që nuk mund të ecje pa ujë në shkretëtirë.

Ai kishte vetëm një palë rroba, e ato mund t'i grisen, e kështu t'i shihet *avreti* (pjesa e turpshme e trupit), e ai e dinte që në shkretëtirë zakonisht nuk mund të gjejë gjilpërë e fije. Gjithçka që është në kuptimin e këtyre katër gjërave është pjesë e shkallës së dytë, sepse këto nuk janë plotësisht të sigurta, janë të dyshimta.

Pra, është e mundur që rrobat nuk do të grisen, ose që dikush t'i japë rroba tjera, ose që te bunari do ta gjejë dikë që do t'ia nxjerrë ujin. Por nuk mund të mendohet se ushqimi do të përtypet vetvetiu në gojën e tij. Në mes të këtyre dy kategorive ka dallime; e para është e sigurt ndërsa e dyta është e dyshimtë, edhe pse kjo e dyta përfshihet në kuptimin e parë. Prandaj edhe themi se, po të ngjitej një mutevekkil në ndonjë grykë mali, ku nuk ka as ujë e as barishte dhe ku njerëzit nuk kalojnë kurrë dhe qëndron atje, ai është gjynaqar, sepse po e hedhë veten në shkatërrim, e gjoja se po i mbështetet Allahut Teala. Tregohet se një zahid e braktisi qytetin dhe shkoi e qëndroi rrëzë një mali për një javë, duke thënë: *"Nuk do të kërkoj asgjë nga askush, deri sa Rabbi im të më sjellë riskun tim!"*

Kështu, qëndroi për një javë dhe gati sa nuk vdiq, e risku nuk i erdh. Atëherë tha:

- O Allah, nëse dëshiron që unë të jetoj, atëherë më jep riskun që Ti ma ke caktuar! Në të kundërtën, merrma shpirtin!; dhe u kthye në qytet, e sapo u ul i erdh një person me ushqim, e një tjetër me ujë. Ai hëngri e piu, por në vete ndjeu shqetësim, e Allahu Teala i shpalli:

- ***Hikmetin Tim deshe ta harxhosh me zuhd-in²⁹ tënd. A nuk e di ti se për Mua më e dashur është t'i ushqej robët e Mi përmes duarve të robëve të Mi se sa përmes fuqisë Time?!***

Kjo do të thotë se largimi nga të gjitha sebebet është kundër hikmetit të Allahut dhe është mosnjohje e ligjit (*sunnet*) të Allahut. Nuk duhet t'ju mbështetesh sebepeve; veprimi i përshtatshëm sunnetit të Allahut së bashku me mbështetje Allahut nuk është e kundërt me tevekkulin, siç e shpjeguam me shembullin në çështjen e përfaqësuesit. Por sebebet janë edhe të dukshëm edhe të fshehur. Kuptimi i tevekkulit është lidhja e zemrës me Atë i Cili i krijon sebebet, e jo me sebebet, dhe duke braktisë sebebet e dukshme e duke u mjaftuar me sebebet e fshehura.

²⁹ **Zuhd**, pa dëshira për këtë botë; që zemra të mos lidhet për asgjë tjetër pos Allahut Teala. Zuhd nuk është të braktisurit fizik të kësaj bote, por të braktisurit e kësaj bote me zemër; zuhd i vërtetë është që, duke iu mbështetur Allahut Teala, zemra dhe dora të largohen nga pasuritë e njerëzve; zuhd është mos-lidhja e zemrës me gjëra, por mbështetja Allahut Teala dhe të besuarit vetëm Atij.

Nëse ti pyet: *Cili është mendimi për personin që rri në qytet, por nuk punon për të fituar, a është një veprim i këtillë haram, mubah apo mendub?*; dije se haram nuk është. Derisa personi nuk e rrezikon jetën e tij duke udhëtuar në shkretëtirë, pasi që një udhëtim i tillë nuk është haram, përse të jetë haram qëndrimi në qytet? Risku mund të vijë edhe nga nuk e pret. Nganjëherë mund edhe të vonojë, me ç'rast është e mundur të presë deri sa të vijë.

Por është haram ta mbyllësh derën në atë mënyrë që askush të mos mund të hyjë. Nëse derën e ka të hapur, e nuk merret me ibadet por rri kot, atëherë më mirë e ka të dalë e ta kërkojë riskun e vet. Sidoqoftë, derisa nuk përballet me rrezikun e vdekjes nuk është haram as të rrijë kot. E kur shfaqet rreziku i vdekjes, atëherë duhet të dalë e të punojë, ose të lypë. Nëse zemra e tij është e angazhuar me Allahun e nuk e kthen kokën kah njerëzit, as kah ai që mund t'i lajmërohet në derë e t'i sjellë ushqim, por ushqimin e di dhuratë të Allahut, atëherë kjo gjendje e tij është më e pëlqyeshme dhe është nga gradat e tevekkulit.

Pra, zemra e tij le të jetë e angazhuar me Allahun, e të mos brengoset për risk, me siguri që risku i tij do t'i vijë.

Në atë rast dalin të vërteta fjalët e një dijetari që ka thënë se nëse robi ikë nga risku, risku e kërkon robin, njëjtë si kur ikë nga vdekja, e ajo vet i vjen. Bile, nëse lutet duke thënë: *“O Rabb mos më jep risk!”*, kjo lutje nuk do t’i pranohet, e për shkak që lutet kështu, bëhet gjynahqar dhe Allahu Teala i thotë:

“O i padijshëm, si mendon se - të kam krijuar, e nuk të jap riskun?!”

Prandaj Ibn Abbas r.a., ka thënë: *“Njerëzit janë në mosmarrëveshje në të gjitha çështjet përpos riskut dhe exhelit. Për risk dhe exhel nuk ka mosmarrëveshje pasi që nuk ka tjetër përveç Allahut që e jep riskun, dhe nuk ka tjetër përveç Allahut që e merr shpirtin.”*

E Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Sikur t’i mbështeteshit plotësisht Allahut, Ai do t’ju jepte riskun edhe juve sikur shpendëve; ata fluturojnë në mëngjes të uritur, e kthehen në mbrëmje të ngopur.”³⁰

³⁰ Muhammed ibn Nasr në librin *Ta’zim kadris-salah* nga Muadh ibn Xhebel, me zinxhir të dobët të transmetuesve. Shënon edhe Bejhekiu, nga Vuhejb Mekki, si hadith *mursel*.

Isa, a.s., ka thënë: *“Shikoni zogjtë - as nuk mbjellin, as nuk korrin, e Allahu Teala ju jep riskun. Nëse thua se kanë gushë të vogël, shikoi bagëtitë.”*

Ebu Jakub es-Susi ka thënë: *“Atyre që mbështeten në Allahun, risku ju sigurohet përmes robëve tjerë, ata nuk lodhen, derisa të tjerët lodhen në sigurimin e riskut për vete.”*

Njëri prej të parëve ka thënë: *“Të gjithë njerëzit e kanë furnizimin nga Allahu Teala, vetëm se disa e marrin me poshtërim, siç është rasti me lypësarinë, të tjerët me lodhje e pritje, si rasti i tregtarit, të tjerë me punë të mundishme, si zanatlija, e disa tjerë furnizimin e marrin me nder, sikur sufitet, të cilët e dinë që risku është prej Allahut, e ndërmjetësimit nuk i jepin rëndësi.*

Kategoria e tretë

është përqafimi i sebebip të pabazë, por që mund të sjellë pasoja, siç janë zhytjet thellë në finesat e planifikimit të mënyrave të fitimit dhe çështjet rreth kësaj. Kjo sjellje i nxjerrë njerëzit nga të gjitha gradat e tevekkulit, e shumica e njerëzve vepron pikërisht kështu.

Me këtë mendoj në ata të cilët pasurinë e lejuar (*mubah*) e arrijnë përmes mashtrimit. E sa i përket fitimit të dyshimtë, ky është kulmi i lakmisë për dynjallëk dhe mbështetje e plotë në sebepe. Këso sebepe, në raport me përfitimin e dobisë janë sikur largimi i ndonjë fatkeqësie me fryerje, fall e damkosje. Pra, të pritët ndihmë nga këto është në kundërshti me tevekkulin, sepse këto janë gjëra të pabaza. Ka shumë sebepe të pabazë si kjo, e që besohen, sa nuk ju dihet numri. Resulallahu, s.a.v.s., duke i përshkruar ata që i mbështeten Allahut, nuk ka thënë që ata nuk bëjnë gjëra të tilla, as nuk ka thënë se ata nuk fitojnë, nuk banojnë në qytete e nuk marrin asgjë nga askush. Përkundrazi, i ka përshkruar si njerëz që punojnë për fitim.

Sehl et-Tusrei ka thënë se tevekkul është braktisja e masës, dhe ka thënë: *“Allahu i krijoi krijesat dhe nuk i mbuloi me perde prej Vete. Por ata kanë mbetur pas perdes me planet e tyre të gabuara.”* Ndoshta me këto fjalë Tusrei deshti t’i nxjerrë në pah sebetet e largëta. Sepse sebetet e largëta kanë nevojë për masa, e sebetet e qarta jo. Do të thotë që sebetet ndahen në dy pjesë. Interesimi për njëërën pjesë, e nxjerr njeriun nga tevekkuli, por intersimi për pjesën tjetër jo.

SebePET që e nxjerrin njeriun nga tevekkuli tutje ndahen në dy: të sigurtë dhe të dyshimtë. SebePI që nuk e nxjerr njeriun nga tevekkuli, nëse ka tevekkul dhe dituri për gjendjen e vet, është mbështetja Allahut Teala, i Cili i krijon sebePET. Tevekkuli këtu nuk është në veprim, por në gjendje dhe dituri.

Sa për sebePE të dyshimtë, tevekkuli këtu është edhe në gjendje e dituri, edhe në veprim. Ata që i mbështeten Allahut, në ndërlidhjen me këto sebePE, ndahen në tri gradë:

Grada e parë është grada e havas-it (*të veçantit*) dhe atyre të ngjashëm me ta. Në këtë gradë është personi që ecë nëpër shkretëtira pa kurrfarë furnizimi, duke u mbështetur plotësisht Allahut Teala dhe me ndihmën e Allahut duron urinë një javë e më shumë, ose e siguron ushqimin nga barishtet, e nëse nuk mund ta gjejë asgjë, është razi të vdes.

Kur bëhet fjalë për personin që me vete e ka furnizimin, mund të ndodh që ai ta humb furnizimin ose i humbet deveja që e mbanë furnizimin mbi shpinë dhe për këtë arsye vdes nga uria. Pra është e mundur të vdes nga uria edhe ai që me vete e ka furnizimin, ashtu si është e mundur të vdes ai pa furnizim.

Grada e dytë është grada e atij që rri vazhdimisht në shtëpi ose në xhami, por që gjendet në qytet apo vendbanim më të madh. Kjo gradë është më e dobët se e para. Megjithatë, edhe i këtilli i mbështetet Allahut Teala, sepse e braktisë fitimin e ju lidhet sebepeve të fshehura, që do të krijojë Allahu Teala.

Por, duke qëndruar në qytet, ky e la një derë të hapur për sebetet e riskut. Sepse, të jetosh në qytet është një nga sebetet që e lehtësojnë arritjen e riskut. Sidoqoftë, qëndrimi në qytet nuk e prish tevekkulin e tij, nëse i drejtohet Allahut, i Cili i detyron qytetarët t'i japin riskun, e nuk ju drejtohet qytetarëve.

Grada e tretë është angazhimi në fitim, në mënyrën siç e kemi shpjeguar në kapitullin e tretë e të katërt të *Librit për edebet e fitimit*. As kjo mënyrë e angazhimit nuk e nxjerrë personin nga tevekkuli, sepse nuk mbështetet në aftësinë dhe forcën e vet, në reputacion dhe pasuri. Ai e di që të gjitha ato Allahu Teala mund t'ia shkatërrojë në moment. Në fakt, ai i mbështetet Allahut, i Cili ia mundëson t'i arrijë të gjitha këto. Sebetet i shikon si një penë në dorën e shkruesit, por nuk lidhet për penën, lidhet për shkruesin.

Tutje, nëse ai person fiton edhe për familjen, ose fitimin e vet e ndanë me fukaratë, në atë rast ai fiton me trupin e vet, por me zemër është larg nga ai fitim. Gjendja e tij është më fisnike se gjendja e atij që rri në shtëpi. dhe pret hazër.

Kur respektohen kushtet e veprimit së bashku me gjendje (*hal*) dhe njohuri (*marifet*), siç e përshkruam më lartë, dëshmi se fitimi nuk bie në kundërshtim me tevekkulin është rasti i Ebu Bekrit r.a; kur Ebu Bekri r.a., u zgjodh halife, ai në mëngjes u nis për në çarshi të punojë. Myslimanët tjerë nuk e mirëpritën këtë veprim dhe thanë:

- *Si po e bën këtë? Të kanë zgjedhë halife!;* e ai tha:
- *Nëse nuk kujdesem për familjen time, si të kujdesem për të tjerët?*

Kjo situatë vazhdoi deri sa as'habët ia caktuan një pagë Ebu Bekrit r.a., të mjaftueshme për një familje myslimane, dhe kur të gjithë u pajtuan, Ebu Bekr e braktisi tregtinë. Tërë kohën e tij e harxhoi në angazhim për të mirën e myslimanëve. Është e pamundur të thuhet se Ebu Bekr r.a., nuk ka qenë në gradën e tevekkulit. Kush është më i denjë se ai për këtë gradë?

Kjo tregon se ai iu mbështet Allahut Teala me braktisje të fitimit, në fakt me mosinteresim absolut për ushqimin dhe furnizimin e vet, duke e ditur se Allahu Teala është Ai i Cili e mundëson fitimin dhe i udhëheqë shkaqet ndëlidhëse. Kjo shkon bashkë me kushtet në të cilat ai ka pasë kujdes gjatë fitimit, siç është plotësimi vetëm i nevojave të domosdoshme, pa kurrfarë teprimi, fodullëku apo zhurme, që dërhemi për vete mos t'i jetë më i dashur se dërhemi për tjetrin. Ai që shkon në pazar, e më të dashur e ka dërhemin për vete se për tjetrin, ai e do dynjanë dhe është dhënë pas saj. Tevekkuli është i mundur vetëm me zuhd. Natyrisht, zuhdi mund të jetë edhe pa tevekkul, por tevekkuli pa zuhd jo. Ebu Xhafer Haddad, i cili plotësisht i mbështetej Allahut dhe ka qenë shejhu i Xhunejd-it, ka thënë:

“Njëzet vjet e kam fshehur tevekkulin tim, e kurrë nuk e braktisa çarshinë. Për çdo ditë fitoja nga një dukat³¹, e në mbrëmje ua jepja fukarave. As një hise prej tij nuk mbetej të kalonte natën me mua. Nuk isha rehat as të mbetej një kirat³² për hamam.”

E Xhunejd kurrë nuk foli në praninë e tij për tevekkul. Thoshte: *“Kam trup që para tij të flas për gradën e tij.”*

³¹ një dukat (një dinar) është dhjetë dërhëmë (argjend).

³² 1/16 pjesë e dërhemit.

Dije se, qëndrimi në teqe ose mesxhid që kanë të ardhura, ose në shoqata bëmirëse, është larg nga tevekkuli. Nëse nuk kanë të ardhura dhe shoqata bëmirëse, por dërgohet shërbëtori i teqes të mbledhë ushqim, veshje etj, për ata që bëjnë ibadet aty, ky tevekkul është i dobët. Megjithatë, tevekkuli i bëhet si i një personi që fiton. E forcon gjendjen (*hal*) dhe diturinë (*ilm*). E nëse ata që qëndrojnë në teqe ose mesxhid ku nuk kanë të ardhura dhe nuk kërkojnë asgjë por mjaftohen me atë që ju sjellet, ky tevekkul i tyre është më i fortë. Por pasi fiton famë teqja dhe duke e ditur që populli e viziton këtë teqe, qëndrimi aty është sikur në rastin që hyrja në pazar e çarshi përzihet me fitim. E ai që hyn në pazar mund të ketë tevekkul vetëm nëse i plotëson disa kushte, të cilat tashmë i përmendëm.

Nëse ti pyet se çfarë është më mirë, të qëndrohet në shtëpi apo të dalë për të fituar, atëherë dije se, nëse me braktisjen e fitimit i kushtohet ibadetit, e fitimi do ta pengonte, dhe nuk pret që dikush do të vijë e t'i sjellë diçka; i mbështetet Allahut dhe është i qëndrueshëm në durim, atëherë më mirë e ka të qëndrojë në shtëpi.

Nëse mërzitet në shtëpi dhe vazhdimisht mendon se kush çfarë solli, atëherë më mirë të punojë, sepse kthimi i zemrës kah njerëzit është lypësari me zemër.

Braktisja e kësaj është më e rëndësishme sesa braktisja e fitimit. Ata që iu mbështetën Allahut Teala, nuk e marrin atë në çka nefs i tyre drejtohet. Ahmed ibn Hanbel e urdhëroi Ebu Bekr Mervezi që një fukaraje t'i japë diçka si kompenzim për një shërbim që fukaraja ia kishte bërë. Fukaraja e refuzoi e ky u kthye, por Ahmed i tha:

- *Shko pas tij, e ofroja prapë! Tani do ta pranojë.*

Ky e arrijti dhe ia ofroi, e fukaraja e mori. Kur e pyetën ta shpjegojë veprimin fukarasë, Ahmed i tha:

- *Oferta ia pëlqei nefs, prandaj e refuzoi. E kur u largua, dëshira e shpresa i humbën, prandaj i pranoi.*

Havvasi, kur i jepnin ndonjë dhuratë, duke u frikësuar që pranimi i dhuratave i bëhet adet, nuk e merrte. Një herë, kur e pyetën për ndonjë ngjarje nga udhëtimet e tij, tha: *“Jam njoftuar me hazreti Hizrin a.s., i cili pranoi të udhëtojë me mua. Megjithatë, u largova nga ai, prej frikës se nefsit tim do t'i pëlqejë shoqërimi me të, e kështu të kem mangësi në tevekkul.”*

Prandaj, nuk ka asnjë kundërshti që ai me punë ta sigurojë fitimin, duke iu mbështetë Allahut Teala, sipas edebeve të fitimit dhe sharteve të nijetit për çka kemi folë në *Librin për fitimin*; pra, të mos ketë për synim që ta teprojë, as të mos mbështetet në pasurinë e vet.

Nëse ti pyet: *Cila është shenja që tregon se nuk është mbështetur në pasuri?*; unë them se, nëse ia vjedhin pasurinë, i dështon tregtia, ose i komplikohet ndonjë punë me të cilën ka qenë i kënaqur, dhe pas kësaj nuk ka ndonjë ndryshim në gjendjen e tij, kjo është dëshmi që nuk mbështetet në pasuri. Atë që një send nuk e qetëson, nuk do ta shqetësojë as humbja e atij sendi. Ai që shqetësohet kur humbë diçka, do të thotë se paska qenë i lidhur me atë.

Zanati i Bishrit ishte thurja e leshit, por ai e braktisi këtë sepse el-Bead i shkruajti: *“Kam dëgjuar se për riskun tënd po i mbështetesh zanatit. Nëse Allahu ta merr dëgjimin e shikimin, kush do të jepë riskun?”*

Këto fjalë të el-Beadit ndikuan në zemrën e Bishrit dhe ky e braktisi zanatin.

Disa thanë se e braktisi kur i vdiqën fëmijët dhe gruaja, por gjithashtu thuhet se Bishri e braktisi këtë zanat sepse emri i tij u përhap në të gjithë vendin e u bë i famshëm, siç ka ndodhur edhe me Sufjan se-Sevrin, i cili i kishte investuar pesëdhjetë dinarë në tregti, e kur mbeti pa familje, ua shpërndau të varfërve.

Nëse ti pyet: *Si mund të paramendohet që dikush ka kapital, e të mos e dashurojë atë, duke e ditur që tregtia nuk bëhet pa kapital?*; unë them se të shumtë janë ata në mesin e njerëzve që nuk kanë kapital, e që Allahu ju jep risk, siç janë të shumtë edhe ata që patën shumë pasuri por e humbën, e u shkatërruan.

Nëse njeriu mësohet dhe aftësohet shpirtërisht për atë që Allahu Teala atij nuk i jep asgjë tjetër përpos asaj që është më e mira për të, edhe nëse i shkatërrohet pasuria, ky e di se kjo është për të mirën e tij.

Po t'i mbetej ajo pasuri, mund të ndodhë që t'i bëhen shkas për pengesë në fenë e tij, pra në këtë rast, shkatërrimi i pasurisë së tij është një mirësi hyjnore për të. Më së shumti që mund t'i ndodhë është të vdes nga uria. Por edhe atëherë duhet të besojë se vdekja nga uria është më e mirë për të në ahiret, prandaj edhe ia ka caktuar ashtu Allahu, e nuk mund të ndryshohet. Kur beson në të gjitha këto, për të bëhet njëjtë, ka pasuri, apo nuk ka.

Në hadith thuhet:

“Njeriu mendon (bën plane) natën për tregti dhe dynjallëk, e sikur t’i bënte, do të shkatërrohej. Por Allahu Teala e shikon me mëshirë prej mbi Arshit dhe e largon nga ato mendime, e ai zgjohet në mëngjes me brengë dhe shqetësim. I shikon komshitë e akrabanë me sy të keq, e ju thotë:

- Kush ma kaloi, kush është më i zgjuar se unë?; e kjo nuk është gjë tjetër veçse një mëshirë e dhënë nga Allahu Teala.”³³

Prandaj Omeri r.a., ka thënë: *“Njëjtë e kam a zgjohem në mëngjes i pasur a i varfër, sepse nuk e di cila është më mirë për mua.”*

Te personi te i cili besimi në këto çështje nuk i është përkryer, tevekkuli as nuk mund të paramendohet. Për këtë arsye Sylejman Darani i tha Ahmed ibn Ebu Havarijj: *“E mbërrijta secilën gradë, përpos atë tevekkul të bekuar. As nuk munda ta nuhas!”*

Këtë e tha, përkundër reputacionit të tij të lartë! Ai pranoi se tevekkuli është një nga gradat që është e mundur të arrihet, por tha: *“unë nuk e kam arritur!”* E me siguri ka menduar në arritjen e tevekkulit më të lartë.

³³ Ebu Nuajm në *‘Hilje’* Ibn Abbasi r.a..

Përderisa nuk arrihet përkryrja në besimin që nuk ka krijues tjetër përpos Allahut Teala, e as furnizues tjetër pos Tij, dhe që gjithçka që Ai ia cakton robit të Tij - fukarallëk, pasuri, vdekje a jetë, është më e mirë për robin se sa ajo që robi ia dëshiron vetes; deri atëherë as gjendja e tevekkulit nuk do të jetë e përkryer. Tevekkuli ngritet pikërisht mbi besimin e fortë në këtë. Gradat tjera të fesë, të cilat përbëhen nga fjalët dhe veprat, ndërtohen mbi themelet e këtij besimi.

Shkurtimisht, *tevekkul* është një gradë e qartë, por që kërkon zemër dhe besim të fortë. Prandaj Sehl el-Tusteriu ka thënë: *“Kush e nënçmon fitimin, e ka nënçmuar sunnetin, e kush e nënçmon atë që ka braktisë fitimin, e ka nënçmuar tevhidin.”*

Nëse ti pyet: *A ka ndonjë ilaç për ta kthyer zemrën nga prirja për sebepe të dukshme dhe ta ndihmojë zemrën në mendimin e mirë për Allahun Teala lidhur me lehtësimin e sebepeve të fshehura?*; përgjigja është: natyrisht që ka! Duhet të dihet se mendimi i keq është nga shejtani e mendimi i bukur është nga Allahu Teala:

“Shejtani ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron për të këqija. Por, Allahu ju garanton falje (mëkatesh) e begati.” 2-Bekare: 268

Sepse, për nga natyra, njeriu është i uritur të dëgjojë frikën nga shejtani. Prandaj edhe thuhet për personin që anon ka mendimet e këqija (*su-i zann*), se është i uritur. Kur këtij mendimi të keq i shtohet frika dhe dobësia e zemrës dhe kur i sheh njerëzit duke u mbështetur në sebepe të dukshme, mendimi i keq do të mbizotërojë plotësisht, dhe tevekkuli nuk shfaqet. Bile, nëse kuptohet që risku vjen prej sebepeve të fshehura, gjithashtu e prishë tevekkulin.

Tregohet se një abid i cili nuk kishte të ardhura të caktuara, hyri në i'tikaf në një xhami, e imami i xhamisë i tha:

- *Më mirë për ty do të ishte të punosh diçka!*

Ai nuk foli asgjë, deri sa imami tri herë ia përsëriti të njëjtën, e atëherë i tha:

- *Ka një çifut këtu afër, që e ka marrë përsipër që për çdo ditë të më sjellë nga dy pogaçe.*

Në këtë, imami i tha:

- *Atëherë më mirë të qëndrosh në xhami.*

E abidi i tha imamit:

- *O njeri, me këtë tevhid të dobët, më mirë të mos ishe imam e të dalësh para Allahut e robëve të Tij! Ti për risk i dhe përparësi premtimit të çifutit ndaj premtimit të Allahut, që e ka garantuar riskun!*

Një tjetër imam e pyeti njërin nga xhemati se me çka po mbetet gjallë, e ky iu përgjigj: *“Ta fali edhe një herë namazin që e fala mbrapa teje, e pastaj të përgjigjem!*

Për formimin e mendimit të mirë (*husni-zann*) lidhur me arritjen e riskut nga Allahu Teala përmes sebepeve të fshehur, ndihmon edhe dëgjimi i tregimeve (*hikaje*) ku flitet për veprimet e mahnitshme të Allahut në dhënien e riskut robëve të Tij. Aty përmenden edhe mrekullitë e forcës së Tij, se si e shkatërron pasurinë e tregtarëve e të pasurve, dhe vdekjen e tyre nga uria, siç tregohet për Huzejfe ibn Mur'ishin, që përndryshe ishte shërbëtor i Ibrahim ibn Ed'hemit, e një herë e pyetën se çka është më e çuditshmja që kishte parë te ai, e ky filloi të tregojë: *“Rrugës për në Meke, mbetëm pa ushqim për disa ditë. Arritëm në Kufa. Hymë në një xhami të rrënuar, e Ibrahimimi më shikoi dhe më tha:*

- O Huzejfe, po e shoh që je i uritur!; e unë i thashë:

- Po, (është ashtu siç e sheh shejhu im), jam i uritur.

Ai më kërkoi ngjyrë dhe letër, e kur ia dhashë, shkroi këto vargje: “Ty të falënderoj, Ty të bëj shyqër, Ty të bëj dhikër, unë jam i uritur, unë jam i humbur, unë jam lakuriq. Këto janë gjashtë, unë garantoj për tri, e për tri tjerat, o Krijues, ti më garanto! Të falënderoj dikë tjetër përveç Teje është sikur të zhytem në zjarr, mbroje robin Tënd që të mos hyjë në zjarr.”

Pasi e shkroi këtë, ma dha letrën, e më tha:

- Dil jashtë, dhe mos e lidh zemrën tënde me askë, përveç Allahut! Letrën jepja të parit që e takon!

Unë u nisa, e i pari që e takova ishte një person mbi mushkë, ia ofrova letrën dhe ai e mori. E lexoi, dhe filloi të qajë. Më pyeti:

*- Ku është autori i kësaj letre;
e unë i tregova se është në filan xhami, e ai ma dha një qese me 600 dukatë. Pasi ai u largua, takova një person tjetër, e pyeta se kush ishte ky person me mushkë, e ai më tregoi se është një i krishterë. U ktheva te Ibrahim i tregova për të gjitha, e ai më tha:*

*- Mos e prek qesen! Tash vjen ai!
Pas disa minutash, hyri ai i krishteri, e uli kokën para Ibrahimit, ia puthi dorën, dhe e pranoi islamin.”*

Ebu Jakub el-Akta el-Basri tregon:

“Një herë, në Harem, isha i uritur për dhjetë ditë. Ndjeva dobësi në trupin tim prandaj dola në luginë, mos gjej diçka për të ngrënë e të shuaj urinë. E gjeta një rrepë të hedhur, e mora, por përnjëherë më kaploi një refuzim, thuaj se dikush të më thoshte:

- Durove urinë për dhjetë ditë, e tash kësaj po i vë kurorë me një rrepë të kalbur!

E hodha atë rrepë, e shkova në xhami. Sapo u ula, kur erdhi një i panjohur, u ul para meje dhe vendosi një bohçe para meje, e tha:

- Kjo tash është e jotja. E pyeta:

- Ku më njeh ti mua që ma solle këtë?; e i huaji filloi të tregojë:

- Para dhjetë ditësh, ishim në udhëtim në det, e anija jonë gati u fundos. Secili prej nesh u betua se, nëse na shpëton Allahu nga aty, do të ndajë ndonjë sadaka. Unë u betova se, nëse më shpëton Allahu, do t'ia dhuroj këtë të parit që e takoj në Harem. Ti je i pari që të takova.

- Hape bohçen; i thashë unë, e ai e hapi, e brenda kishte ëmbëlsira, simite me aromë, bademë e sheqer në kockë. Mora pak prej tyre, e thash:

- Këto tjerat dërgoja miqve tu, si dhuratë prej meje; e më pas i thashë vetes:

- Risku po të vjen që dhjetë ditë, e ti po e kërkon atë në luginë!"

Memshad Dinuri tregon: "Kisha një borxh, e për shkak të borxhit u mërzita. Pashë një ëndërr, e në ëndërr dikush më tha:

- O koprrac, ti duke u mbështetur te Ne e ke marrë këtë borxh. Ti merr, e jona është të japim!

Pas kësaj ëndrre nuk e mendova më as tregtarin, e as kasapin."

Benani Hammal tregon: *“Isha duke shkuar për në Mekë nga Egipthi. Me vete kisha të nevojshmet për rrugë. Më takoi një grua, e më tha:*

- O Benan, po e bartë mbi shpinë riskun! A mendon se Allahu Teala nuk do të japë risk?! E hodha riskun prej shpine, e për tri ditë nuk gjeta asgjë për të ngrënë. Rrugës e gjeta një bylyzyk, dhe mendova me vete:

- Do ta marr. Ndoshta e takoj pronarin e saj, Unë ia kthej, e ndoshta ai më jep diçka për ta ngrënë. Ndërkohë takova përsëri të njëjtën grua. Kësaj radhe, më tha:

- Ti qenke tregtar! Do të doje ta gjesh pronarin e këtij bylyzyku, që ai të të japë ty diçka! Pastaj m’i hodhi disa dërrhemë e më tha t’i shpenzoj. Më mjaftuan gati deri në Meke.”

Gjithashtu tregohet se Benan kishte nevojë për shërbëtore në shtëpi. Ju tregoi shokëve, e ata i mbledhën paratë për t’ia blerë një skllave. I thanë:

- Tash duhet të arrij një karavan, e do ta zgjedhim më të përshtatshmen. Kur karavani mbërrijti, të gjithë u pajtuan për të njëjtën skllave, se është më e mira për Benanin. E pyetën tregtarin sa kushton, por ai ju tha që nuk është për shitje. Këta insistuan, e tregtari tha:

- Është për Benan Hammalin. E ka dhuratë prej një gruaje nga Semerkandi. Ata ia dërguan Benanit shërbëtoresh, dhe ia treguan ngjarjen.

Tregohet se në kohët e vjetra një person ishte në udhëtim, e me vete kishte vetëm një simite. Mendonte:

- *Nëse e ha, më vonë vdes nga uria!* Allahu Teala caktoi një melek që t'i jetë afër, e i tha:

- ***Nëse e ha, jepi më shumë, nëse nuk e ha, asgjë mos i jep!*** Personi nuk e hëngri simitin dhe vdiq nga uria.

Ebu Seid el - Harraz ka treguar: *“Një herë isha në shkretëtirë, e nuk kisha asgjë me vete. Më kaploi uri e madhe, kur në largësi e pashë një fshat. U gëzova që po hyj në fshat. Në atë moment mendova si po mbështetem te dikush tjetër pos Allahut. Vendosa se nuk do të hyj në fshat, pos nëse më fusin vet. E hapa një gropë në zall, për t'u fshehur nga sytë e tyre, dhe u futa deri te gjoksi. Diku kah mesnata, dëgjova një zë të lartë, si thirrte:*

- *O fshatarë, Allahu Teala e ka një evlia të Tij që është ngjuar në zall! Nxjerreni!*

Më nxorrën e më dërguan në fshat.”

Tregohet se një person vazhdimisht ndalej te dera e hazreti Omerit r.a., deri sa një herë nuk e dëgjoi një zë si i thotë:

- ***O njeri, prej kujt ti vërtetë kërkon, prej Omerit apo prej Allahut Teala! Shko e lexo Kur'an. Ai të bën të pavarur nga dera e Omerit (r.a.).***

Personi shkoi e nuk dukej më, sa edhe Omeri r.a., filloi ta kërkojë. Ai ishte vetmuar e iu kishte kushtuar ibadetit. Omeri r.a., e gjeti, e i tha:

- *Po më mungon. Çfarë të largoi nga unë?*

- *Lexova Kur'an, e ai më bëri të pavarur nga Omeri dhe njerëzit e tij; u përgjigj ky, e Omeri r.a., i tha:*

- *Allahu të mëshiroftë! E, çfarë gjete aty?; e ky tha:*

- *I gjeta fjalët e Allahut: **“E në qiell është risku juaj dhe ajo që ju premtohet”*** (51-Zarijat: 22); dhe tha:

- *Furnizimi im është në qiell, e unë e kërkoj në Tokë!*

Hazreti Omeri filloi të qajë, e i tha:

- *Të vërtetën e fole!*

Pas kësaj, Omeri r.a., herë pas here e vizitonte këtë person.

Ebu Hamza el-Hurasani tregon:

“Një herë u nisa për në haxh, e diku rrugës rashë në një bunar. Mendova të kërkoj ndihmë për të dalë, por pastaj i thash vetes:

- *Vallahi nuk do të thërras për ndihmë! As nuk e përfundova këtë mendim, kur mbi bunar u paraqitën dy persona. Njëri i tha tjetrit:*

- *Ta mbyllim këtë bunar, të mos bjerë dikush në të. Sollën degë e dushk dhe e mbyllën majën e gropës. Më erdhi t'i thërrasë por i thash vetes:*

- E kë ta thërras? Ai që do të ndihmojë është më afër meje se ata. Kështu u qetësova. Qëndrova në atë gjendje për rreth një orë. Pastaj erdhi dikush. E hapi majën e bunarit dhe hodhi kovën poshtë. Thuaj se më thoshte të kapem për kovë. Dhe unë u kapa, e më nxorri jashtë, e kur e pashë – luan! Kaloi i qetë para meje. Në atë çast, e dëgjova një zë:

- O Ebu Hamza, a nuk është kjo më mirë?! Përmes rrezikut të shpëtuam nga rreziku!

Ngjarje të tilla janë të shumta. Kur besimi në Allahun forcohet, e njeriu edhe ka fuqi të durojë urinë një javë dhe beson se më e mirë për të është vdekja, duke i kuptuar këto gjendje, tevekkuli i kompletohet. Në të kundërtën, jo.

TEVEKKULI I ATIJ QË KA FAMILJE

Dije se, kur bëhet fjalë për tevekkul, ai nuk është i njëjtë si për personin që ka familje, si për atë që është i vetëm. Tevekkuli i atij që është i vetëm mund të jetë i drejtë vetëm me dy gjëra:

1. *Të jetë në gjendje të durojë urinë për një javë, pa u ankuar e as pa ndjerë siklet; dhe*
2. *Të ketë iman të fortë, siç e përmendëm më herët.*

Shembull: nëse nuk i vjen ushqim nga asnjë anë edhe nëse është detyruar në vdekje, të pranojë me kënaqësi. Sepse ai e di se tani nuk ka më risk dhe vdekja e tij është nga uria, edhe pse kjo është një mangësi në botë, në botën tjetër është begati. Nga dy riskët, i është dhënë më e mira, ajo e ahiretit. Kështu i përkryret tevekkuli i atij që është i vetëm.

Por familjari nuk është kështu, ai nuk mund të detyrojë familjen e tij të durojë urinë. Familjari nuk mund të presë që edhe pjesëtarëve të familjes t'ju forcohet besimi në tevhid e ta dinë se vdekja nga uria është në vetvete një risk i bekuar, ani pse kjo rrallë ndodhë. Njëjtë është edhe me çështjet tjera të imanit.

Prandaj, familjari mund të praktikojë vetëm tevekkulin e atyre që punojnë të sigurojnë kushtet e jetesës së familjes, pra grada e tretë e tevekkulit, si tevekkuli i hazreti Ebu Bekr es-Siddik r.a., kur u nis për çarshi që të punojë.

Ta lë famljen në kujdesin e Allahut e të shkojë në shkretëtirë, ose të mos punojë për të siguruar kushtet e jetës së tyre është haram., sepse nganjëherë kjo çon në shkatërrimin e tyre dhe ai do të përgjigjet për këtë.

E vërteta është që nuk ka dallim mes personit dhe anëtarëve të familjes së tij. Nëse familja për një kohë e ndihmon atë në durimin e urisë dhe gatishmërinë për vdekje nga uria, që të arrijë riskun e bekuar dhe të përfitojë begati në botën tjetër, në atë rast mund të mbështetet në Allahun Teala për ta, siç varet edhe vet nga Ai. Nuk i lejohet t'i shkatërrojë, pos nëse ata vet i ndihmojnë që me durim të përballojë urinë për një kohë të caktuar. Por, nëse këtë nuk mund ta bartë, zemra fillon t'i ndjejë siklet e ibadeti i bëhet i çrregullt, një këso tevekkuli nuk e ka të lejuar. Prandaj edhe tregohet se Ebu Turab en-Nahshabi e shikoi një dervish që e zgjati dorën drejt një lëvoreje shalqiri për ta ngrënë pasi nuk kishte ngrënë për tri ditë, e i tha: *“Dervishllëku nuk është për ty! Ti shko në treg e kërko punë”*.

Me fjalë tjera, nuk ka dervishllëk pos me tevekkul, siç nuk ka tevekkul pos me përmbajtje nga ushqimi për më shumë se tri ditë. Ebu Ali Ruzbari ka thënë: *“Kur një zahid pas pesë ditësh thotë: ‘kam uri’, dërgojeni në çarshi e thuani të punojë e të fitojë.”*

Prandaj, trupi i tij është familja e tij. Tevekkuli në atë që i sjellë dëm trupit të tij është sikur tevekkuli që e ndikon edhe familjen e tij. Dallimi është vetëm në atë se ai mund ta detyrojë veten me durim e uri, por jo edhe familjen.

Nga kjo ti e kupton se *tevekkul* nuk do të thotë shkëputje nga sebetet. Ndoshta është durimi i urisë për një kohë të gjatë dhe razillëk me vdekjen, kur ajo të vjen, ndoshta ëshë qëndrimi në fshatra dhe qytete, shetitja nëpër shkretëtira me bimë; e të gjitha këto janë sebepe për të jetuar, qoftë edhe me një lloj mundimi. Sepse vazhdimësia në tevekkul është e mundur me durim në uri, ndërsa tevekkuli në vendbanime është më afër sebepeve se sa tevekkuli në shkretëtirë, e në të gjitha ka nga një sebep. Pra, tevekkuli në asnjë mënyrë nuk ndahet nga sebetet, ani pse njerëzit mendojnë vetëm në sebepe të dukshme.

SebePET e padukshme njerëzit as nuk i konsiderojnë se bepe, që është pasojë e besimit të tyre të dobët, lakmisë së tyre, mungesës së durimit në përballje me telashet e kësaj bote, qyqarllëkut në zemrat e tyre me mendime të këqija dhe shpresave të tyre të kota.

Ai që i sheh sekretet e qiejve dhe Tokës, e kupton se Allahu Teala e rregulloi edhe botën e dukshme edhe të padukshmen në atë mënyrë që njeriun nuk e anashkaloN risku - bile edhe nëse nuk punon, të gjithëve Ai ju caktoi riskun, se risku askujt nuk i është ndërprerë, se Ai ia jep riskun edhe atyre që janë të paaftë. A nuk e sheh fëmjën në barkun e nënës, i cili nuk është në gjendje të kujdeset për riskun e vet, si Allahu Teala bëri që me kërthizë të jetë i lidhur për nënën e vet, e përmes kërthizës të ushqehet me ushqimin nga nëna?! Kjo nuk ndodhë me vullnetin e frutit. Më pas, kur të lind, a nuk sheh se si Allahu Teala te nëna mbjellë dashuri dhe mëshirë, që ajo të kujdeset për të. Meqë nuk ka dhëmbë të zhvilluar që ta përtypë ushqimin, ushqim ia bëri qumështin; trupi i tij është i dëbët për ushqim më të fortë, dhe gjirin e nënës e mbushi me qumësht. A janë të gjitha këto me vullnetin e foshnjës, apo të nënës?! Dhëmbët e mbrehtë dhe dhëmballat fillojnë t'i dalin vetëm kur është në gjendje të marrë ushqim më të fortë, e që të mund ta përtypë.

Dhe në fund, kur të rritet e pavarësohet, i dhurohet mundësia që të mësojë dhe të ecë rrugës së ahiretit. Meqenëse të gjitha këto janë nga Allahu, të jetë frikacak në çështje të riskut pasi të ketë arritur moshën e pjekurisë, është injorancë e pastër. Sepse me pjekurinë e tij nuk është pakësuar risku, ndoshta bile është shtuar. Nëse më herët nuk ka qenë i aftë të punojë, tash këtë mund ta bëjë. Fuqia e tij është shtuar. Natyrisht, mëshirë ndaj tij do të ndjejë nëna dhe babai. Mëshira e nënës është shumë e shprehur. E ka ushqyer disa herë në ditë. Një veprim i tillë i saj ka qenë rezultat i mbjelljes së dashurisë dhe mëshirës në zemrën e saj nga ana e Allahut Teala. Njëjtë, Allahu Teala mbolli dashuri, butësi dhe mëshirë në zemrat e të gjithë myslimanëve, në fakt, të të gjithë banorëve të atij vendi. Secili prej tyre, kur e di se dikush aty ka ndonjë nevojë, do të ndjejë dhimbje në zemër e do të jetë i butë ndaj tij. Diçka e shtyen t'ia plotësojë nevojën atij. Një herë ishte vetëm një person me mëshirë ndaj tij, tash janë me mijëra, e më shumë. Më herët nuk ishin të mëshirshëm ndaj tij sepse e shihnin nën mbrojtje të nënës dhe babasë, që më së shumti edhe brengoseshin. Njerëzit nuk e shihnin atë si nevojtar. E, po të ishte jetim, Allahu Teala do t'i jepte dikujt prej myslimanëve ose disa prej tyre mëshirë ndaj tij, që ta pranojnë e të kujdesen për të.

Deri tash, nuk është parë nën këtë qiell ndonjë jetim që ka vdekur nga uria, ani pse është i pafuqishëm. Allahu Teala e mbron jetimin përmes robëve të Tij, duke mbjellë në zemrat e tyre mëshirë. Pse atëherë njeriu duhet të brengoset për riskun pasi të arrijë pjekurinë, e në fëmijëri nuk është angazhuar për risk, kur e kishte vetëm një mëshirues, e tash i ka me mijëra?! Natyrisht, mëshira e nënës është më e fuqishme dhe me më shumë efekt, por është vetëm një, deri sa mëshria e më shumë individëve, ani pse secila prej tyre veç-e-veç më e dobët, së bashku e arrijnë qëllimin. Sa ka jetimë që Allahu Teala ju dhuroi kushte më të mira të jetës se sa atyre që kanë nënë e baba. Mangësia e mëshirës së individit nuk vërehet kur ka më shumë njerëz, kur njeriu largohet nga kënaqësitë e panevojshme e mjaftohet vetëm me atë që vërtetë është e domosdoshme. Sa bukur e tha një poet:

*Pena e Allahut, caktimet tashmë i shkroi,
për atë që do të ndodhë, lëvizi a pushoi.
Do të jesh i humbur nëse pas riskut vrapon,
kur edhe foshnjes në bark, riskun ia kupton.*

Ti mund të thuash: *Njerëzit brengosen për jetimin, sepse e shohin se është i pafuqishëm, deri sa për atë që është rritur e mund të fitojë as nuk interesohen, duke thënë se ai është i njëjtë si të tjerët, e thonë:*

- *Le të mundohet edhe ai!*; por unë them se kjo është e drejtë në rastin e atij që është i aftë e nuk punon. Tevekkuli nuk ka të bëjë me të.

Por nëse vazhdimisht rri në xhami ose në shtëpi, e të jetë i kushtuar diturisë, dhikrit dhe ibadetit, në atë rast njerëzit nuk e gjykojnë pse e ka braktisur punën. Nuk do të duhej ta gjykojnë. Ndoshta përkushtimi i tij ndaj diturisë, dhikrit dhe ibadetit, e fiton dashurinë e tyre dhe ata japin edhe më shumë se nevojat e tij. Atij i takon të mos ua mbyllë derën njerëzve dhe të mos ikë në mal. Në këtë botë ende nuk është parë një i devotshëm në një vendbanim, që të gjithë kohën ta kushtojë në dituri dhe ibadet e të vdesë nga uria. Bile, nëse ai dëshiron të ushqejë, jo vetëm veten, por një xhemat, njerëzit përreth tij me kënaqësi do të sjellin ushqim. Ai që është për Allahun Teala, edhe Allahu është për të. Ai që angazhohet për Allahun Teala, Allahu e mbjellë dashurinë për të në zemrat e njerëzve dhe ia nënshton njerëzit atij, siç e nënshtroi zemrën e nënës fëmijës së saj. Allahu Teala krijoi mjaftueshëm për banorët e Tokës dhe të qiellit. Ai që mund ta shohë këtë rregull, do t'i besojë Atij i Cili i rregullon të gjitha këto, dhe në këtë angazhohet. Ai do t'i besojë Atij i Cili e rregullon sebebpin, e jo sebebipit.

Natyrisht, nuk gjen çdo ditë hallvë e ëmbëlsira, mish zogëze e rroba të bukura dhe kuaj të racës së mirë. Nganjëherë mund t'i gjejë edhe këto. Ndodhë ajo që Allahu e cakton.

Atij që është i angazhuar me ibadet ndaj Allahut, padyshim, brenda javës i arrinë një simite, nga gruri ose tjetër. Zakonisht do të arrijnë edhe më shumë, në fakt, gjithmonë më shumë se që është nevoja. Arsyeja e vetme për ta braktisë tevekkulin është dëshira e nefsit për kënaqësi të vazhdueshme. Dëshira e nefsit për ushqim të mirë dhe rroba të mira e largon njeriun nga tevekkuli, e kjo nuk është rrugë e ahiretit. Padyshim, kjo kënaqësi nuk realizohet pa punë, bile nganjëherë nuk realizohet as me shumë punë.

Sipas atyre që ju është çelë basireti, ndikimi i punës është i dobët. Prandaj duhet të mbështetet Allahut Teala që e rregullon edhe botën e dukshme edhe të padukshme, i Cili ia jep riskun gjithkujt, e jo t'i mbështetet punës, sidomos se nganjëherë ndodh që Allahu Teala nuk jep risk, edhe nëse ky punon. Kur e kupton mirë këtë, pasi zemra dhe nefsi të fitojnë guxim, fjalët e Hasan Basriut fillojnë të japin frutat. Ai ka thënë: *“Do të doja që banorët e Basras të jenë fëmijët e mi, e një kokërr gruri të vlejë sa një dukat.”*

E Vuhejb b. el-Verd ka thënë: *“Edhe sikur qielli të ishte bakër e Toka plumb, nëse shqetësohem për riskun tim, do të mendoja se jam mushrik (pabesimtar).”*

Nëse i ke kuptuar këto, atëherë e ke kuptuar edhe se tevekkul është një gradë e vetëkuptueshme, që është e mundur të arrihet, nëse mposhtet nefs. Do ta kesh të qartë se ai që mohon esencën e tevekkulit, dhe në përgjithësi, mundësinë e tij, e mohon për shkak të paditurisë së vet. Unë ju ndaloj humbjen nga dy drejtime: njëri është mosarritja e (drejtëpërdrejtë) në shkallën e kënaqësisë së tevekkulit. E dyta është humbja e besimit në tevekkul përmes diturisë. Prandaj, të mbetet ty të jesh i kënaqur me të paktën, dhe të jesh i kënaqur me ushqimin, çfarëdo e sado qoftë. Risku pa dyshim vjen, edhe nëse ti ikë prej tij. Allahu ta dërgon riskun tënd përmes atij që ti as nuk e pret. Nëse je i zënë me devotshmëri e tevekkul, me përvojën tënde do ta kuptosh të vërtetën e ajetit:

“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi) dhe do t’i japë risk prej nga nuk e pret.” 65-Talak: 2, 3.

Nuk ka premtuar ta ushqejë edhe me mish zogëze. I ka premtuar kushtet që janë të domosdoshme për të jetuar, e kjo është bollëk.

Sebepet e fshehura që Allahu Teala i ka përgatitur për risk janë më shumë sesa sebebpet e dukshme. Burimet e tyre nuk mund të dihen. Ato shfaqen në tokë, e sebebpin e kanë në qiell. Allahu Teala thotë:

“Në qiell është furnizimi juaj dhe ajo që ju premtohet.” (51-Dharijat: 22), e fshehtësitë e qiellit nuk mund t’i kuptojë gjithkush. Xhunejditi i erdhën një grup, e i thanë se po kërkojnë riskun e vet, e Xhunejdi ju tha:

- *Nëse e dini ku e keni riskun, shkoni atje kërkojeni!*
- *Ne kërkojmë prej Allahut; i thanë.*
- *Nëse mendoni se Ai ju ka harruar, përkujtojeni.*
- *Atëherë të shkojmë në shtëpi, i mbështetemi Allahut e presim.*
- *I pasigurt është tevekkuli që mbështetet në përvoja.*
- *E ku është zgjidhja?*
- *Zgjidhe është mos-kërkimi i zgjidhjes dhe hileve.*

Ahmed b. Isa el-Harraz tregon: “*Isha një here në shkretëtirë, e më kaploi uri e madhe. Mendova ta lus Allahun Teala për ushqim, por i thashë vetes se kjo nuk i ka hije atyre që mbështeten në Allahun dhe preferova durimin. Atëherë dëgjova një zë:*

*Mendon se na është afruar,
e kush na vjen, ne s’e largojmë.
Ai kërkon ushqim nga ne,
thu’së s’sheh, as s’e shikojmë.*

E kuptove se ai që e mposhtë nefsin, i fuqizohet zemra, nuk i përulet qyqarllëkut dhe i forcohet besimi në caktimin e Allahut, ai do të jetë me zemër të qetësuar përgjithmonë dhe ashtu i mbështetet Allahut Teala. Nuk ka gjendje më të rëndë se të vdesësh jo i qetësuar, e të vdesësh - gjithsesi që duhet.

Prandaj, plotësia e tevekkulit arrihet me mjaftueshmëri dhe me bindje në atë që e premtoi Allahu. I Drejtë është ai i Cili ua garanton riskun atyre që me atë risk janë të kënaqur. Nëse do provoje, patjetër do të besojë në drejtësinë e premtimit të Allahut, se si risku yt vjen nga ku nuk e ke pritur. Në atë tevekkul të mos ketë pritje prej shkaqeve (të ndërlidhura) por le të ketë pritje vetëm prej Atij i Cili dhuron.

Nuk pret asgjë prej penës së shkruesit, por pret prej zemrës së shkruesit, që është burimi i lëvizjes së asaj pene. E lëvizjen e bën Ai që është Një, i Vetmi. Shikimi duhet të drejtohet vetëm kah Ai.

Ky është kusht për tevekkulin e atij që niset për shkretëtirë pa furnizim, ose qëndron në qytet e nuk bën asgjë.

Sa për atë që i është kushtuar ibadetit e diturisë, nëse brenda ditës është i kënaqur me një racion, çfarëdo, dhe nëse është i kënaqur me rroba të thjeshta, të këtillit risku do t'i arrijë vazhdimisht, edhe prej nga e pret edhe prej nga nuk e pret. Në fakt, do t'i arrijë edhe shumë më shumë. E shkalla e fundit e dobësisë dhe mangësisë është të braktisë tevekkulin e t'i jep rëndësi të madhe sigurimit të riskut. Prandaj, është e shëmtuar për njerëzit fetarë t'i japin rëndësi të madhe sigurimit të riskut, e për dijetarët është edhe më e shëmtuar, sepse për dijetarin kusht është mjaftfueshmëria me atë që e ka (*kanaat*). Dijetarit që është modest, do t'i arrijë risku, e nëse ka xhemat edhe atij xhemati i vjen risk i mjaftueshëm. Por, dijetari që nuk merr nga njerëzit dhe që dëshiron të hajë ushqim nga fitimi i tij, është i veçantë. E dijetari që nuk hyn në dituri *batin* dhe është i zënë me dituritë *zahir*, është e kuptueshme që në një mënyrë të angazhohet për risk. Por dietari që hyn në dituri *batin* (*sejr-i suluk*), nuk mund të jetë i angazhuar për risk.

Ai që është angazhuar me ibadet, më mirë është të pranojë riskun nga ata që japin për rizanë e Allahut. Duke vepruar kështu, edhe vazhdimisht angazhohet me ibadet edhe bëhet sepse që edhe ai që jep të fitojë sevab.

Ai që i sheh rrjedhat e ligjeve të Allahut, e sheh se risku nuk është sipas sebepeve. Prandaj një sulltan e pyeti një dijetar për budallanë që i arrinë risku me bollëk, e njeriu i mençur mbetet në pamjaftueshmëri, në çka ai i tha: *“Krijuesi deshi ta tregojë Vetën, sepse po t’i dhuronte secilit të mençur, e të privonte secilin budalla, njerëzit do të besonin se mendja i siguron risk pronarit të saj. Kur njerëzit e shohin se aty ka kundërshti, e kuptojnë se riskun e jep dikush tjetër dhe që nuk mund të mbështeten në sebetet e dukshme.”*

Poeti thotë:

*Po të jepej risku për mençuri,
kafshët do të ngordhnin, se s’kanë dituri.*

SHPJEGIM PËRMES SHEMBUJVE PËR GJENDJET E MUTEVEKKILIT RRETH LIDHJES ME SEBEPE

Dije se, gjendja e njerëzve me Allahun është e ngjashme ma ata lypës që qëndrojnë në një mejdan para derës së sulltanit dhe kërkojnë ushqim. Sulltani ju dërgon atyre shërbëtorë me bukë dhe urdhëron që dikujt t'i japin dy e dikujt një, dhe i urdhëron të mos e harrojnë asnjërin. Më pas urdhëron telallin t'i njoftojë të mbledhurit: *“Mos u lidhni me shërbëtorët e mi kur t’ju vijjnë, por qetësohuni aty ku jeni, e shërbëtorët vinë te ju, sepse ata janë të urdhëruar dhe i zbatojnë urdhrin me të cilin secilit prej jush i caktohet ushqimi. Ai që e shqetëson shërbëtorin duke kërkuar më shumë, do të dërgoj te ai shërbëtor tjetër, e kur të hapet dera do ta përcjellë deri te momenti i paraparë për dënim, e atë kohë e di vetëm unë dhe e mbaj të fshehur nga të tjerët. Ai që e merr copën e bukës që ia ofron shërbëtori dhe është i kënaqur, i kam përgatitur kostum ceremonial, e do t’ja veshë kur ta dënoj atë të parin për veprimin e tij. Ai që i merr dy copë bukë dhe është i kënaqur aty ku është, për të nuk ka dënim, por nuk ka as kostum ceremonial, Atij që shërbëtorët nuk i sjellin ushqimin, dhe e kalon natën në uri e pa inat ndaj shërbëtorëve, dhe nuk thotë: ‘sikur të më sillnin edhe mua ushqim!’, atë do ta bëj vezir dhe do t’ia dorëzoj pronën time.”*

Njerëzit këtu u ndanë në katër grupe:

Grupi i parë janë ata që i sundoi barku e nuk u brengosën për dënimin me të cilin kërcënoheshin, e thanë: *“E nesërmja është larg, gjendet zgjidhja, tash kemi uri.”* I shqetësonin shërbëtorët dhe merrnin nga dy bukë, prandaj në ditën për të cilën i kërcënoi sulltani, sigurisht do të dënohen.

Grupi i dytë nuk i shqetësuan shërbëtorët duke iu frikësuar dënimin, por i morrën nga dy bukë sepse uria i detyroi, prandaj i shpëtuan dënimin, por nuk morrën kostume ceremoniale, që i përgatiti sulltani.

Grupi i tretë thanë: *“Do të qëndrojmë ulur, që shërbëtorët të na shohin e të mos na anashkalojnë, e kur të na japin, do të marrim nga një bukë dhe me aq do të mjaftohemi, e ndoshta fitojmë edhe kostum ceremonial, si dhuratë.”* Këta e veshin kostumin ceremonial në ditën e shpërblimit.

Grupi i katërt u shpërndanë në katër anët e mejdanit para pallatit e u larguan nga shikimi i shërbëtorëve, duke thënë: *“Nëse shërbëtorët na përcjellin e na japin ushqim, do të marrim nga një bukë, e nëse na anashkalojnë, do të durojmë sonte urinë dhe në sajë të kësaj shpëtojmë nga zemrimi i sulltanit, e ndoshta edhe bëhemi vezirë, të afërt me sulltanin.”*

Nuk ia arritën qëllimit, sepse shërbëtorët i gjetën dhe secilit ia dhanë nga një bukë. Kjo u përsërit disa ditë. Një herë, shërbëtorët nuk i gjetën tre prej tyre, e kur ata i zuri nata e uria i mundonte, dy prej tyre thanë:

- Të kishim marrë ushqim; nuk e durojmë urinë!

I treti vetëm heshti, deri në mëngjes. Kjo heshtje e tij e afroi sulltanit, dhe sulltani e bëri vezir.

Pra ky është shembull për njerëzit e ngjashëm me ata lypës që qëndrojnë në një mejdan para derës së sulltanit. Mejdan është jeta në dynja. Derë është vdekja, e dita e kijametit nuk dihet. Dita e shpërblimit dhe ndëshkimit është në ditën e Gjykimit. Premitmi për t'u bërë vezir ka të bëjë me gradën e shehidit që do ta fitojë ai që i mbështetet Allahut Teala e kalon në ahiret i uritur, por i kënaqur me caktimin për të. Kjo gradë arrihet menjëherë pas vdekjes dhe nuk pret deri në ditën e Gjykimit, sepse shehidët janë të gjallë dhe janë duke u kënaqur me furnizim nga Allahu Teala.

Ai që ndërlidhet me shërbëtorët duke kërkuar më shumë bukë është prej atyre që janë lidhur me sebepe. Shërbëtorët, të cilët janë nën urdhrin e sulltanit, janë sebepe.

Të qetë në atë lëndinë dhe nën shikimin e shërbëtorëve janë ata që i gjen në teqe e xhami, pa shqetësime.

Ata që u shpërndanë në të katër anët e mejdanit janë ata që udhëtojnë nëpër botë duke iu mbështetur Allahut Teala, e sebepepet ju shkojnë pas, dhe rrallë janë pa furnizim. Nëse ndonjëri vdes i uritur e i kënaqur me caktimin, do t'i takojë grada e shehidit dhe afërsia me Allahun Teala.

Njerëzit janë të ndarë në këto katër grupe. Ndoshta, në njëqind njerëz, nëntëdhjetë lidhen me sebepe. Prej dhjetë të tjerëve, shtatë u vendosën në vendbanime. Edhe këta, për të qëndruar aty e për të fituar famë, u lidhën me sebepe. Tre udhëtojnë, dhe dy prej tyre janë të pakënaqur me gjendjen, e vetëm i treti, duke treguar qëndrushmëri, e fiton gradën e afërsisë me Allahun Teala.

Ndoshta situata ka qenë kështu me gjeneratat e kaluara. Sot³⁴ ndoshta mund të gjendet një në dhjetëmijë.

³⁴ koha e Gazaliut.

Rasti i dytë PËR GRUMBULLIMIN E PASURISË

Ai që pasurinë e fiton përmes trashëgimisë, fitimit, lypësarisë ose në çfarëdo mënyre tjetër, në raport me grumbullimin e asaj pasurie ka tri situata:

Situata e parë

është të merr vetëm aq sa i nevojitet në atë moment, ushqim, veshje, nëse nuk ka ku të qëndrojë, merr një shtëpi, aq sa ka nevojë. Pjesën tjetër të pasurisë ju jep të varfërve. Nuk do të marrë as nuk do të mbajë pasuri përpos në atë masë sa e di që do t'i nevojitet për të plotësuar të drejtën ndaj atyre që ka obligim. Ai që vepron kështu ka përmbushë detyrën e tevekkulit dhe kjo është grada më e lartë.

Situata e dytë

është e kundërt me të parën dhe tejkalon kufijtë e tevekkulit, e kjo është situata kur personi grumbullon për një vit e më shumë. Personi që kështu vepron, nuk mund të jetë mes atyre që i mbështeten Allahut Teala. Thuhet se vetëm tri gjallesa grumbullojnë për të ardhmen: miu, buburreci dhe njeriu.

Situata e tretë

është kur ushqimi grumbullohet për katërdhjetë ditët e ardhshme. Mendimet dallojnë se në ahiret a do të privohet ose jo nga grada e lartë e premtuar për ata që i mbështeten Allahut. Sehl et-Tusteri ka thënë se i këtilli ka dalë jashtë kufirit të tevekkulit, e Havasi konsideron se me grumbullimin e ushqimit deri në katërdhjetë ditë nuk do të dalë nga kufiri i tevekkulit, por nëse grumbullon për më shumë se kaq, po. Ebu Talib el-Mekki është i mendimit se nuk do të dalë nga kufiri i tevekkulit edhe nëse grumbullon ushqim për më shumë se katërdhjetë ditë. Por, pasi që grumbullimi i ushqimit nuk është, në esencë, në kundërshti me mbështetjen Allahut Teala (*tevekkul*), është vështirë të përcaktohet sasia e grumbullimit.

Çdo shpërblim që është premtuar për një gradë shpërndahet sipas niveleve të asaj grade, e këto grada kanë një nivel në filim dhe një në fund. Ata që ngriten në nivelin e fundit të asaj grade quhen *Sabikun* e ata që janë në fillim, quhen *Ashab-i jemin*. Më pas, ka edhe shkallë të ndryshme të *Ashab-i Jemin*, si edhe të *Sabikun* e shkalla më e lartë e *Ashab-i Jemin* është si shkalla më e ulët e *Sabikun*. Vlerësimi dhe caktimi i vendeve të tilla do të ishte i pakuptimtë.

Këtu e vërteta është se, të jetë tevekkuli si duhet krahas grumbullimit të ushqimit, është e mundur me largimin nga mendimet e tepruara për të ardhmen. Por nuk ka asnjë kusht për të menduar se nuk do të jetojë gjatë, e ta humbë shpresën. Në shpresë, njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri. Disa kanë shpresa të gjata, të tjerët të shkurta; shpresa më e shkurtë është të jetojë edhe një ditë e një natë, ose vetëm disa orë. Shpresa më e gjatë është të jetojë gjatë. Në mes këtyre dyjave ka shkallë të ndryshme.

Ai, shpresa e të cilit zgjatet deri në një muaj është shumë më afër qëllimit se sa ai, shpresa e të cilit zgjatet deri në një vit. Kufizimi i shpresës në katërdhjetë ditë, që është marrë nga koha të cilën Musa a.s., e kaloi në takim me Rabbin e tij, nuk është i përshtatshëm, sepse me atë takim qëllimi nuk ka qenë të tregohet sa gjatë lejohet të mbahet shpresa, por se Musa a.s., që ta meritojë të premtuarën, është dashur të kalojë katërdhjetë ditë në takim, e ky është ligj gradual i Allahut Teala. Arsye është fshetësia e cila depërton edhe në gjëra tjera të ngjashme gradualisht, e ky është ligj i Allahut Teala. Për këtë Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“Allahu Teala e ka gatuar me dorën e Tij brumin e Ademit katërdhjetë ditë.”³⁵

³⁵ Ebu Mensur Dejlemi nga Ibn Mesud dhe Selman Farisi r.a..

Pra, për më gjatë se një vit ushqimin e mbledhë vetëm ai, zemra e të cilit është e dobët dhe e dhënë pas shkaqeve të dukshme, e i tilli nuk është në gradën e mbështetjes, prandaj nuk është i sugrt që përcaktimet që janë të fshehura pas shkaqeve vijnë vetëm nga Ai, i Vërteti, në të Cilin duhet mbështetur. Në të shumtën e rasteve, shkaktarët e këtyre mangësive vazhdimisht shtohen, vijnë në shprehje dhe përsëriten me kalimin e kohës.

Ai që grumbullon ushqim për më shkurt se një vit, do të marrë gradë përshtatshëm shpresës së tij. Grada e atij që grumbullon ushqim për dy muaj nuk është e njëjtë sikur e atij që grumbullon ushqim vetëm për një muaj, e as si e atij që grumbullon për tre muaj. Grumbullimin mund ta ndërpresë vetëm shpresa e shkurtë. Më e mira është që fare të mos grumbullohet ushqim, edhe nëse zemra është e dobët. Sa më pak grumbullon, aq më shumë ngritet grada e tij.

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., e urdhëroi Alinë dhe Usamen r.a., ta lajnë një fukara që kishte vdekur, dhe ata e bënë, e si qefin i veshën mantelin që fukaraja e kishte. Kur e varrosën, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“Allahu Teala do ta ngjallë këtë fukara në ditën e Gjykimit me fytyrë të shndritshme si hëna e plotë. Ky e kishte një veçori që, pa të, fytyra do t’i shndriste si Dielli i mesditës”. As’habët pyetën se për cilën veçori bëhet fjalë, në çka Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- *Ka agjëruar shumë, ka falë namaz natën dhe ka përmendur Allahun, mirëpo, kur bëhej dimër, i palonte rrobat e verës për verën tjetër, e kur bëhej verë, i palonte rrobat e dimrit për dimrin tjetër.*

Më pas, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“Më së paku që ju është dhënë, është jekîni dhe vendosmëria në durim.”³⁶

Ibriku, gota, thika dhe gjëra të ngjashme që nevojiten vazhdimisht, nuk bëjnë pjesë në të përmendurat, e as mbajtja e tyre nuk është në kundërshti me tevekkulin por, rrobat e dimrit nuk nevojiten gjatë verës.

Gjithë kjo që u përmend ndërlihet me personin, të cilit zemra nuk do t’i luhatet kur të braktisë grumbullimin e ushqimit dhe që nuk ndjenë mërzi.

³⁶ Pjesa e parë e hadithit nuk është gjetur, e pjesa e dytë tashmë është përmendur.

I tilli do të vuajë që njerëzit i japin prej pasurisë së tyre, por se zemra nuk i kthehet askujt pos Allahut Teala, Atij të Cilit duhet vërtetë mbështetur.

Nëse në zemër ndjenë shqetësim që e pengon në ibadet, dhikër e meditim, më mirë është që të grumbullojë ushqim për një kohë, deri sa të arrijë qetësimin e zemrës. Sepse qëllimi është të bëhet ibadet me zemër të qetë. Ka shumë njerëz që pasuria e tyre i pengon në ibadet dhe dhikër, e ka edhe shumë njerëz që në këtë i pengon skamja. Pasuria dhe skamja në këtë botë nuk janë shqetësuese vetvetiu. Shqetësuese është ajo që e largon njeriun nga Allahu. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., u dërgua për njerëz të ndryshëm; tregtarë, mjeshtër, punëtorë, bujqë e nuk e urdhëroi tregtarin të ndalojë tregtinë, as mjeshttrin ta braktisë zanatin, por të gjithë njerëzit i ftoi te Allahu Teala, dhe i udhëzoi në të vërtetën që shpëtimi i tyre është në largimin e zemrës së tyre nga kjo botë e t'i mbështeten Allahut Teala.

Zemra është ajo që i mbështetet Allahut. Prandaj për personin me zemër të dobët më mirë është ta grumbullojë ushqimin për vete aq sa i duhet, e për personin me zemër të fortë, ta braktisë grumbullimin. E tëra që thamë deri më tani është për personin që nuk ka familje.

Kur bëhet fjalë për atë i cili mbanë familjen, nuk do të largohet nga mbështetja Allahut nëse i siguron ushqimin familjes për një vit, duke u kujdesur për dobësitë e tyre dhe që zemrat t'ju qetësohen. Por nëse siguron ushqimin për më shumë se një vit, largohet nga mbështetja Allahut. Sepse shkaqet përsëriten me kalimin e viteve. Sepse i grumbullimit të ushqimit për më shumë se një vit është dobësia e zemrës, dhe kjo është e kundërt me forcën e mbështetjes Allahut Teala.

Ai që i është mbështetur Allahut, do të thotë zemërfortë, është ai që i lidhet vetëm Allahut, beson në kujdesin e Allahut, e jo në shkaqet e jashtme.

Resulallahu, s.a.v.s., familjes së vet i grumbullonte ushqimin për gjithë vitin³⁷, por ia ndaloi Ummu Ejmenes që atij a.s., t'i ruajnë ushqim për nesër. Kur Resulallahu, s.a.v.s., e pa një copë bukë që Bilali r.a., e kishte ruajtur për iftar, ia ndaloi duke thënë:

“O Bilal, duro! Mos ke frikë se Rabbi i Arshit do të japë (risk) më pak!”³⁸

³⁷ Hadithi është përmendur në *Librin për zeqatin*.

³⁸ Bezzari, nga Ibn Mesud, Ebu Hurejre dhe Bilalli ku thuhet se a.s., hyri te Bilalli, pa një enë hurme, e tha: “*Ndaj me të madhe...*” Ebu Ja’la dhe Taberani në *Evsat* nga Ebu Hurejre si transmetime *daif* (të dobët).

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Kur të kërkojnë, jep, e kur të japin, mos e fsheh.”³⁹

Zotëria në tevekkul i atyre që i mbështeten Allahut Teala, Muhammedi, s.a.v.s., kur merrte tejemmum pas nevojës së vogël, edhe pse uji nuk ishte larg, thoshte:

“Ku ta di, ndoshta nuk arrij te uji.”⁴⁰

Resulallahu, s.a.v.s., edhe nëse grumbullonte ushqim, nuk i dëmtohej tevekkuli. Ai nuk besonte në ushqimin e ruajtur, i besonte Allahut, por largimi nga kjo është që t’i mësojë jekinin ummetit të tij, sepse forca e ummetit të tij është e dobët në krahasim me forcën e tij.

Bile na njoftoi se, siç i pëlqen Allahut Teala kur ibadetet zbatohen pa lehtësime, i pëlqen edhe kur përdoren lehtësimet. Qëllimi nga kjo është të mos dëshpërohen zemrat e dobëta dhe për t’i kënaqur ata. Sepse Resulallahu, s.a.v.s., është dërguar si mëshirë për të gjitha botët, pa marrë parasysh klasën apo gradën.

³⁹ Taberani dhe Hakim nga Ebu Seid, transmetues i besueshëm.

⁴⁰ Ibn Ebu Dynja nga Ibn Abbas r.a.,

Kur ta kuptosh këtë, do ta kuptosh që braktisja e grumbullimit të pasurisë, për disa është e dëmshme e për disa e padëmshme. Këtë e tregon edhe trasmetimi në të cilin Ebu Umama Bahili ka thënë: *“Një prej ashab-i suffa ndërroi jetë, e nuk e kishte me vete qefinin. Resulallahu, s.a.v.s., urdhëroi:*

- *Preni mantelin e tij dhe bëjani qefinin.*

Duke ia prerë mantelin, në jakë ia gjetën dy dukatë, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- *Këto janë dy male për domkosje.*⁴¹

Kanë vdekur as’habë edhe para këtij e që pas vete lanë pasuri, e për ta Resulallahu, s.a.v.s., nuk tha kështu. Janë dy mundësi, pasi që janë dy gjendje të mundshme të as’habit të përmendur këtu:

Mundësia e parë është të mendohet në dy damkosje, siç përmendet në fjalët e Allahut Teala:

“...në Ditën kur do të digjen në zjarrin e xhehennemit, e me të do të damkoset balli i tyre, anët (ijet) e tyre dhe shpina e tyre...”

(9-Teube: 35), e kjo do të ndodhë nëse është cilësuar me zuhd, varfëri dhe me mbështetje në Allahun Teala, e këto të mos i ketë, kjo është një lloj mashtrimi.

⁴¹ Ahmedi, nga Shehr ibn Havsheb r.a..

Mundësia e dytë është që i ka mbajtur dy dukatë si rezervë, e jo për të mashtruar njerëzit, por që fjala bëhet për dy gradë më pak nga përkryerja. Sikur zjarri që djegë dy herë fytyrën e ia prish bukurinë, edhe këto dy dukatë e prishin përkryerjen e tij. Sepse, sa i jepet në dynjallëk, aq i zvogëlohet nga ahireti.

Kur bëhet fjalë për shpjegimin se grumbullimi i ushqimit nuk dëmton tevekkulin kur në zemër nuk ka dashuri për pasuri, mund të gjejmë dëshmi në transmetimin që vjen nga Bishri. Husejn Megazili, një nga shokët e tij, tregon: *“Ishim te Bishri një mengjes, e i erdhi një person në vizitë. Ishte më i vjetër, lëkurë të grysor e krahërorë të ngushtë, e Bishri, për të cilin unë e di se nuk i ngrihej askujt, u ngrit në këmbë. Më pas më dha një grusht dërrhemë e më tha të blej ushqimin më të shijshëm që mund ta gjej, e as këtë nuk e kishte bërë më parë. E solla ushqimin, e ata dy hëngrën drekë bashkë, e deri atëherë nuk e kisha parë Bishrin të hajë bashkë me dikë. Pasi hëngrën, në sofër teproi shumë ushqim, e mysafiri e mblodhi dhe u largua. E gjithë kjo më habiti, e veprimi i atij personi më neveriti. Bishr më pyeti:*

- Ndoshta nuk të pëlqeu veprimi i tij? I thashë:

- Nuk më pëlqeu; e mori ushqimin e mbetur, pa marrë leje për këtë!; e Bishr tha:

- Ai ishte vëllai ynë Feth Mevsili, sot ai erdhi për të na vizituar nga Mosuli. Erdhi të na mësojë që kur mbështetja në Allahun është e drejtë, nuk pengon të grumbullohet ushqimi.”

Rasti i tretë
PËRDORIMI I SHKAQEVE PËR TË LARGUAR DËMIN QË
SHKAKTON FRIKË

Dije se frika e njeriut nganjëherë mund të jetë për jetën e nganjëherë për pasurinë. Mosmarrja e masave parandaluese kundër rreziqeve për jetën e pasurinë nuk ka lidhje me tevekkulin, dhe përdorimi i atyre masave nuk është në kundërshti me tevekkulin. Rreziqe të tilla janë fjetja në vende ku ka bisha të egra, ose në lëndina ku vërshon uji, ose nën murin e shtrembëruar, ose nën çatinë e shtëpisë së dëmtuar.

Të gjitha këto janë të ndaluara, dhe ai që vepron kështu i është ekspozuar shkatërrimit, pa nevojë. Natyrisht, këta shkaktarë ndahen në të sigurt, të dyshimtë dhe të papërcaktuar.

Braktisja e gjërave të dyshimta, është kusht i tevekkulit. Të mundohet për të mbrojtur me to është ngjashëm sikur të mundohet të mjekohet me fryerje e damkosje (*kejj*⁴²). Fryerja e damkosja nganjëherë bëhen më herët, për të larguar rrezikun që mund të ndodhë, e nganjëherë bëhen pasi të paraqitet rreziku.

⁴² damkosja e plagës me diçka të nxehtë; djegie e plagës; mjekim me djegie.

Duke i përshkruar ata që i mbështeten Allahut Teala, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë se ata nuk e përdorin mjekimin me fryerje dhe damkosje, por nuk ka thënë se kur dalin në të ftohtë nuk veshin rroba të trasha, e që vishet për të parandaluar dëmin nga të ftohtit. Të gjithë shkaktarët tjerë kanë trajtim të njëjtë. Natyrisht, të konsumohet qepa, për shembull, që të ruhet e shtohet ngrohtësia e trupit kur del jashtë në të ftohtë, ndoshta do të jetë formë e terpimit në raport me shkaktarët dhe mbështetjen në ta. Një veprim i tillë mund të klasifikohet sikur shërimi me damkosje, për dallim nga përdorimi i rrobave të ngrohta. Braktisja e shkaktarëve me të cilët ndalohet dëmi, edhe kur janë të sigurt, ka bazë në rastin kur dëmin ia shkakton tjetri. Kur njeriu është në gjendje të durojë ose të reagojë e të hakmirret, atëherë kusht i mbështetjes Allahut Teala është braktisja e hakmarrjes dhe mos reagimi me të keq. Allahu Teala thotë:

“...pra Allahun merre për mbështetje.

Dhe ki durim ndaj asaj që thonë” 73-Muzemil: 9, 10,

dhe thotë:

“...ne gjithsesi do të durojmë e do t'i përballojmë mundimet që na bëni, e vetëm Allahut le t'i mbështeten vazhdimisht ata që gjithnjë iu mbështeten.” 14-Ibrahim: 12,

dhe thotë:

“...mos u vë veshin mundimeve të tyre ndaj teje, e mbështetju Allahut se Allahu është mbrojtje e mjaftueshme.” 33-Azab: 48,

“Duro, ashtu siç duruan të dërguarit e vendosur...”

46-Akaf: 35,

**“sa i mirë është shpërblimi për atë që vepruan.
që duruan dhe vetëm Rabbit të tyre iu mbështetën.”** 29-Ankebut: 58, 59

Të gjitha ajetet e përmendura kanë të bëjnë me durim të shqetësimeve që vijnë nga njerëzit. Sa për durimin e dëmit që e shkaktojnë gjarpërinjtë, bishat e egra e akrepat, kjo nuk ka kurrfarë lidhje me mbështetjen Allahut (*tevekkul*), sepse një durim i tillë është durim i padobishëm. Përpjekja që diçka të bëhet, si edhe braktisja e përpjekjes, kërkohet vetëm kur e ndihmon fenë.

Renditja e shkaktarëve të përmendur është i njëjtë me renditjen në fitim me punë dhe në të siguruarit e përfitimit, kështu që nuk do të shpjegojmë më shumë, që të evitojmë përsëritjen.

Njëjtë është edhe kur kërkon sebepe për ta mbrojtur pasurinë e kjo nuk është në kundërshti me mbështetjen Allahut (*tevekkul*). Shembull është mbyllja e derës kur del nga shtëpia dhe lidhja e devesë. Sepse këto janë sebepe të sigurta, ose të sigurta në të shumtën e rasteve, që njihen me ligjin (sunnetin) e Allahut. Bedunit që e la deven e lirë dhe tha se po i mbështetet Allahut, Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

“Lidhe devenë, e pastaj mbështetju Allahut.”⁴³

Allahu Teala thotë:

“O besimtarë! Bëhuni syçelë.” 4-Nisa: 71

Duke shpjeguar mënyrën e faljes së namazit në frikë, Allahu Teala thotë:

“...le t'i mbajnë pranë edhe armët e veta!”

4-Nisa: 102,

e me një ajet tjetër:

“E ju përgatituni sa të keni mundësi force, (mjete luftarake), e kuaj të caktuar për betejë kundër atyre.” 8-Enfal: 60

⁴³ Tirmidhiu nga Enesi r.a., transmeton edhe Ibn Huzejme në ‘*Tevekkul*’ dhe Taberani nga Amr ibn Umej, me zinxhir të mirë të transmetuesve.

Duke iu drejtuar Musasë, a.s., Allahu Teala tha:

“Ec bashkë me robërit e Mi natën...”

(44-Duhan: 23), sepse me terrin e natës mbrohen nga sytë e armiqve, që është një lloj sebepi. Edhe Resulallahu, s.a.v.s., u strehua në shpellë, që t'i ikë shikimit të armiqve e të mbrohet nga e keqja e tyre.

Mbajtja e armës në namaz nuk e ndalon domosdo dëmin, por mbytja e gjarprit ose akrepit gjithsesi se po. Megjithatë, supozohet se mbajtja e armës në aso situatë do të jetë e dobishme, prandaj e supozuara vjen në nivel të të sigurtës. E vetmja që duhet ta braktisë është spekulimi, siç e kërkon tevekkuli.

Nëse më thua se transmetohet si disa individë kanë qëndruar të palëvizshëm deri sa luani e mbante putrën mbi krahërorin e tyre, do të përgjigjem se njëjtë transmetohet se disa individë e nënshtronin luanin dhe e përdornin si mjet udhëtimi. Njeriu nuk guxon të mashtrohet me këto grada, sepse edhe nëse supozojmë se diçka e tillë është e vërtetë, nuk është diçka që duhet të pasohet e të mësohet. Kjo është një gradë e lartë e kerametit. Gjëra si këto nuk janë kusht në tvekkul. Aty janë fshehtësitë të cilat nuk mund t'i kuptojë askush tjetër përpos atij që vet i përjeton.

Nëse ti më pyet se a ka ndonjë shenjë me të cilën mund ta dish a ke arritur në atë gradë, unë të them se ai që arrin në atë gradë nuk ka nevojë të kërkojë shenjë. Nga shenjat që i paraprijnë kësaj gjendje është që të të nënshtrohet “qeni” që e ke nën lëkurë, e që ti e quan *zemërim*. Ai të kafshon ty dhe të tjerët, dhe nëse ky qen të nënshtrohet ashtu që i lidhet urdhrit tënd dhe lëviz vetëm me shenjen tende, atëherë ti je sundues i tij. Ndoshta pas kësaj do të ngritesh në gradën ku do të nënshtrohet edhe luani, mbret në mesin e bishave të egra. Megjithatë, më me rëndësi e ke ta frenosh qenin që jeton në shtëpinë tënde se sa një kafshë që endet i lirë, e më me rëndësi e ke ta frenosh qenin nën lëkurë, se sa qenin në shtëpi. Nëse nuk arrin ta frenosh qenin e padukshëm brenda teje, mos fantazo se do të nënshtrohet ndonjë qen tjetër.

Mund të pyesësh: *Çka nëse ai që i nënshtrohet Allahut e merr armën si mbrojtje ndaj sulmit të armikut, e mbyllë derën e shtëpisë që të mbrohet nga hajduti, apo e lidhë deven që të mos i ikë; në çfarë baze ai llogaritet në mesin e atyre që i janë mbështetur Allahut Teala?; atëherë përgjigja ime është se ai do të jetë në mesin e atyre që i mbështeten Allahut Teala me diturinë dhe gjendjen e tij.*

Me dituri, sepse e di se kur hajni vendosë të hyjë, nuk mund ta ndalojë dera e mbyllur, dhe që vetëm Allahu Teala ka fuqi ta ndalojë. Sa shumë dyer u mbyllën, e nga kjo nuk pat dobi! Sa deve u lidhën, e prapë ikën! Sa njerëz bartën armë, e u vranë apo u mposhtën! Këto janë vetëm shkaqe, në to nuk mbështetet, por i mbështetet Krijuesit të shkaqeve, si në rastin e përfaqësuesit në ndonjë kontest. Kur përfaqësuesi paraqitet e i sjellë shënimet, ai nuk mbështetet në vete, as në shënime, por mbështetet në aftësitë e tij dhe në të drejtën e rastit që përfaqëson.

Me gjendje i mbështetet Allahut, sepse është *razi* me caktimin e Tij për jetën dhe pronën e vet, e thotë:

- Rabbi im! Nëse Ti lejon që dikush të më grabisë shtëpinë, çfarëdo që merr e dhuroj në rrugën Tënde dhe jam razi me caktimin Tënd. Nuk e di a është ajo që kam në duar dhuratë prej Teje që nuk do ta kthesh prapë, apo vetëm ma ke besuar e përsëri do ta marrësh. Nuk e di a është ajo furnizimi im, apo Ti nga ezeli ke caktuar që ai furnizim i takon tjetrit. Cilido të jetë caktimi Yt, unë jam razi. Nuk e mbylla derën e shtëpisë që të ruhem nga caktimi Yt, as nga pakënaqësia me atë caktim, por i respektova ligjet Tua, që i ndërlidhin shkaqet me pasojat. Në askë tjetër nuk kam besim, pos në Ty, o Ti që je Krijues i të gjitha shkaqeve dhe pasojave!

Kur kjo të jetë gjendja e tij, e ajo që përmendëm më herët dituria e tij, ai nuk ndahet nga grupi i atyre që i mbështeten Allahut kur ta lidhë devenë, ose ta mbyllë derën e shtëpisë, ose ta bartë armën. Pastaj, kur i këtilli kthehet në shtëpi dhe i gjen gjërat e paprekura, duhet ta falënderojë Allahun Teala, sikur t'i jetë dhënë bereqet i ri. Nëse shtëpia i është grabitur e i janë marrë gjërat, duhet të shikojë gjendjen e zemrës së vet, e nëse është e gëzuar dhe e lumtur për shkakun që e di që Allahu Teala ia mori këto që t'ia shtojë shpërblimin në botën tjetër, gradën e mbështetjes e ka të drejtë, dhe me këtë ka shprehë sinqeritetin e vet.

Nëse në zemër ndjenë dhimbje dhe gjen forcë të durojë, atëherë shfaqet se nuk ka qenë i sinqertë në pohimin e tij se i mbështetet Allahut, sepse grada e tevekkulit është një gradë që vjen pas *zuhd*-it.

Nuk e ka braktisur këtë botë ai që vuan kur i humb të mirat e kësaj bote, dhe gëzohet kur këto të mira, të përkohshme, i vijnë. Bile, gjendja e tij është plotësisht në kundërshti me *zuhdin*, prandaj si mund të jetë i vërtetë tevekkuli i tij? Natyrisht, ndoshta do ta arrijë gradën e durimit nëse këto ndjenja i fshehë dhe nuk ankohet, si edhe nuk e tepron me kërkim të asaj që i është vjedhur.

Nëse nuk është në gjendje ta bëjë këtë dhe zemra i ndjen shqetësim, e fillon të ankohet me gjuhë për situatën e vet dhe e rraskapitë trupin në kërkim të pasurisë që i është vjedhur, atëherë kjo vjedhje vetëm ia shton gjynahun, sepse i shfaq të metat në të gjitha gradat që i ka arritur dhe dëshmon se të gjitha pohimet e tij ishin gënjeshtër. Pas kësaj i duhet domosdo të mundohet maksimalisht që të mos i besojë pohimeve të nefsit, sepse pohimet e tij janë mashtrim dhe urdhërojnë të keqen, ani që pohon se qëllim e ka arritjen e të mirës.

Sikur ti të pyesësh: *Si mundet një person që i mbështetet Allahut Teala të posedojë pronë që ajo t'i vjedhet?*; do të përgjigjesha: Në shtëpinë e atij që i mbështetet Allahut domosdo duhet të ketë disa gjëra, siç është pjata nga e cila ha, gota nga e cila pi, ibriku me të cilën merr abdes, një torbë ku e mbanë ushqimin për vete, arma me të cilën do t'i kundërvihet armikut e të ngjashme, që llogariten gjëra të domosdoshme në shtëpi. Gjithashtu, mund të ndodhë që në pronësi të ketë edhe para të cilat pret t'ia japë ndonjë fukaraje, prandaj mbajtja në shtëpi e kësaj nuk e zbehë mbështetjen e tij në Allahun Teala.

Nuk është kusht i mbështetjes Allahut që njeriu të heq dorë nga gota me të cilën pi ujë, nga torba në të cilën mbanë ushqimin e vet, por se kushti kërkohet në atë që e ha dhe në secilën pasuri që i kalon kufijt e nevojës, sepse ligji i Allahut Teala e përcakton që furnizimi i Tij t'ju arrijë atyre që qëndrojnë në mesxhid dhe teqe e që i mbështeten Atij. Por nuk është përshtatshëm ligjit të Tij të blej gota e enë për çdo ditë, as çdo javë. Dalja nga ligji (*sunneti*) i Allahut nuk është kusht në tevekkul. Për këtë arsye, Havvasi bartte me vete në rrugë, konop, tenxhere për zierje, gërshtë dhe gjilpërën, por nuk bartte ushqim. Sepse ligji i Allahut është i ndryshëm në këto dyja.

Nëse ti do të thuash: *Si është e mundur që njeriu të mos ankohet kur i vjedhin gjërat që i nevojiten e të mos pikëllohet për to, e sikur të mos kishte nevojë, përse do t'i kishte në shtëpi dhe pse do ta mbyllte derën e shtëpisë? Nëse i ka mbajtur për nevojë të veta, si të presim që zemra të mos i shqetësohet, kur mes tij dhe asaj që i nevojitet është paraqitur pengesë?;* në këtë do të përgjigjesha: I ka mbajtur në pronësi këto që i përmendëm që veten ta ndihmojë në fenë e tij sepse ka menduar se është mirë t'i posedojë ato gjëra, dhe, po të mos ishte mirë, Allahu Teala as nuk do t'ia dhuronte e nuk do ta nderonte me to.

Krahas kësaj, njeriu mund të mbështetet edhe në atë se bëhet fjalë për lehtësim që vjen nga Allahu Teala, dhe se kjo është mënyrë e mendimit të mirë për Të, i Cili i nidhmon me gjëra që ia forcojnë fenë.

Megjithatë, kjo që përmendëm nuk është e sigurt, sepse ekziston mundësia që ka mirësi në atë që të sfidohet me humbjen e pronës, e të detyrohet të investojë më shumë mundim për të plotësuar nevojat e veta. Shpërblimi për angazhim e mundim është shumë më i madh. Kur Allahu Teala i ka marrë diçka ashtu që i ka lejuar hajnit t'ia vjedhë, mendimi i tij ka ndryshuar, duke qenë në të gjitha gjendjet e tij i mbushur me besim dhe mendim të mirë për Allahun Teala. Tash do të thotë:

- Po të ishte kjo e mirë për mua në diturinë e Allahut, do të mbetej në pronësinë time, prandaj me siguri se është mirë për mua që ato më nuk i kam.

Me këso mendimi mund të largohet brenga nga zemra, sepse në atë mënyrë distancohet nga gëzimi për shkaktarët dhe për pasojat e tyre, duke e kuptuar se këto shkaqe ia ofroi Krijuesi, si formë e kujdesit dhe mirësisë së Allahut ndaj tij.

Me këtë personi është sikur i sëmuri në duart e mjekut të kujdesshëm, i kënaqur me secilin veprim të mjekut. Kur ia jep ilaçin, ky i kënaqur thotë:

- *Sikur mjeku mos ta dinte se kjo është e mirë për mua dhe se unë mund ta duroj, nuk do të ma jepte; dhe nëse mjeku ia ndalon ilaçin, ky prapë i kënaqur me mjekun, sepse atëherë mendon:*

- *Sikur mjeku mos ta dinte se ky ilaç nuk është i mirë për mua, nuk do të ma ndalonte.*

Secili që nuk mendon për mirësinë e Allahut Teala atë që e mendon i sëmuri për ndershmërinë e mjekut të tij të ndërgjegjshëm e të aftë, e të cilin e ka edhe baba, me asgjë nuk është nga ata që i mbështeten Allahut Teala. Kush e njeh Allahun, do të njohë veprat e Tij dhe ligjet me të cilat Ai ju bën mirë robëve të Tij, prandaj nuk do t'i gëzohet shkaktarëve, sepse nuk e di se cilët janë të mirë për të, e cilët jo. Prandaj Omeri, r.a., ka thënë: *“Nuk brengosem se a do të më çelë sabahu të pasur apo të varfër, sepse nuk e di cila është më e mirë për mua.”*

Njëjtë, ai që i mbështetet Allahut Teala, nuk duhet të brengoset nëse diçka prej asaj që e posedon i vjedhet, apo edhe i mbetet. Nuk dihet se çka do të jetë për të më mirë në botën tjetër, ose edhe në këtë botë.

Sa shumë janë vjedhur gjëra në këtë botë, e që kanë qenë shkas për shkatërrim të atyre që i kanë poseduar! Shumë ka të pasur që u sfiduan me pasurinë e tyre, e thanë: *“Të kish dhënë Allahu, e të ishim të varfër!”*

EDEBI I MUTEVEKKILIT KUR I VJEDHET PASURI NGA SHTËPIA

Ka edebe që ndërlidhen me pasurinë, e të cilave personi që i mbështetet Allahut duhet përmajtur kur i largohet nga shtëpia.

Edebi i parë është që të mbyllë derën e shëpisë e të mos e teprojë me kujdes, si për shembull t’i kërkojë komshisë t’ia ruajë shtëpinë ose që në derë të vendosë dryrë shtesë. Malik ibn Dinar r.a., kurrë nuk e mbyllte derën e shtëpisë së tij, vetëm e lidhte me konop, e thoshte: *“Po të mos ishin qentë, as nuk do ta lidhja.”*

Edebi i dytë është të mos e lë në shtëpi atë për të cilën hajdutët do të vinin, e kjo të bëhet sepse për të bërë ata gjynah, ose që ruajtja e tepruar të ndezë kureshtjen e tyre. Prandaj Malik ibn Dinar, kur Mugira ia dhuroi një xhezvë, tha:

- *Merre ti, mua nuk më duhet!;*

e Mugira e pyeti si nuk i duhet, e ibn Dinar u përgjigj:

- *Nuk dua që shejtani të më pshërtijë se do të ma vjedhë hajni.*

Thuaj se ka dashtë që ta mbrojë hajnin që ai të mos bëjë gjynah dhe ta mbrojë zemrën e vet nga pshërtima e shejtanit që do ta ngarkonte me mendimin se diçka mund t'i vidhet. Ebu Sulejman për këtë ka thënë:

“Kjo vjen nga dobësia e zemrës së sufisë.”

Sepse ai që është zahid, ajo nuk i intereson. Ai thotë:

“Kushdo që dëshiron le ta vjedhë”, dhe nuk mërzitet.

Edebi i tretë është kur detyrohet të lë pasurinë në shtëpi, dhe kur të dalë nga shtëpia ta bëjë nijet që është razi me caktimin e Allahut Teala, edhe nëse është e caktuar që hajni ta vjedhë. Kështu, duhet të thotë:

- *Unë këtë e bëra hallall: ose*

- *E dhuroj këtë në rrugë të Allahut, e nëse e marr ndonjë fukara, le t'i jetë sadaka.*

Edhe më mirë nëse këto fjalë nuk i kufizon vetëm në fukaratë, dhe kështu do të ketë dy qëllime (nijet), pa marrë parasysh a bëhet fjalë për të pasur apo fukaranë:

E para, për shkak të pasurisë së tij, personi do të bëjë gjynah. Ndoshta hajni do të marrë vetëm aq sa i nevojitet dhe e braktisë vjedhjen. Meqenëse ky e ka bërë hallall edhe për të pasurin edhe për të varfrin, hajni që ha nga kjo pasuri që ka vjedhur, nuk bëhet gjynaqar.

E dyta, nuk paraqet vështirësi për myslimanin tjetër dhe me pasurinë e vet e mbronë myslimanin tjetër nga padrejtësia (*zullum*).

Në të dy rastet, kur e bën nijet, mbronë pasurinë e myslimanëve tjerë, duke sakrifikuar pasurinë e vet, ose duke e larguar hajnin nga gjynahu, e kështu ai i këshillon myslimanët dhe i përshtatet këshillës së Resulallahut, s.a.v.s.:

“Ndihmoje vëllaun, kur bën padrejtësi dhe kur i bëhet padrejtësi.”⁴⁴

Të padrejtit i ndihmohet ashtu që pengohet në bërje të padrejtësisë, ndërsa falja është sjellje më e mirë për të braktisur ai padrejtësinë. Këtë kuptojë mirë: nijeti i tij, nuk i bën dëm asgjë. Ky nijet i tij as nuk do ta ndryshojë atë që i është caktuar (në ezel) e as që e ndalon hajdutin.

⁴⁴ Hadithi është përmendur më herët.

Por, me këtë nijet arrihet zuhdi, prandaj nëse të këtillit i vjedhet pasuria, për secilin dërhëm të vjedhur, ai do të merr shtatëqind dërhëmë shpërblim, sepse e ka bërë nijet, e edhe nëse nuk i vjedhet pasuria, prapë merr shpërblim.

Në këtë kuptim tregohet nga Resulallahu, s.a.v.s., se mashkulli i cili gjatë marrëdhënies intime me gruan e vet e lëshon farën në vendin e caktuar për këtë, do të shpërblehet, edhe nëse fara nuk ngjizet. Shpërblimin e ka të njëjtë sikur nga ajo marrëdhënie t'i lind fëmijë, e të rritet e të kalojë në ahiret, sepse nga mashkulli varet vetëm lëshimi i farës në pjesën intime, ndërsa krijimi, jeta, furnizimi dhe mbijetesja nuk varen prej tij. Po të krijohej fëmijë, do të fitonte shpërblim për veprimin, e qëllimi nuk i humbë. Njëjtë është edhe me hajninë. Nëse i vjedhet prona me këtë nijet, për shkak nijetit, shpërblehet.

Edebi i katërt është që, kur ta kuptojë se prona i është vjedhur, të mos mërzitet, por, nëse mundet, të jetë i lumtur e të thotë: *“Po të ishte ajo pronë e mirë për mua, Allahu Teala nuk do të ma merrte.”*

Nëse duke u laguar nuk ka thënë:

“Në rast se vjedhet, qoftë për rizanë e Allahut”, nuk duhet ta teprojë në kërkim që t’i kthehet pasuria e kështu të krijojë mendim të keq për myslimanët.

E nëse ka thënë:

“Qoftë për rizanë e Allahut”, nuk duhet assesi ta kërkojë, sepse e ka ndarë për vete në ahiret.

Bile, edhe nëse i kthehet pasuria e vjedhur, më mirë e ka ta refuzojë pasi që tashmë e ka bërë nijet për rizanë e Allahut, e nëse e pranon, kjo pronë është e tij sipas gjykimit zahir. Sepse, pronësia nuk heqet me një nijet të thjeshtë. Por, për atë që i mbështetet Allahut (*tevekkul*), kjo pronë nuk është e pëlqyeshme. Transmetohet se Abdullah ibn Omerit r.a., ia vodhën devenë, e ai, përkundër angazhimit të madh, nuk arriti ta gjejë, dhe tha: *“Qoftë për rizanë e Allahut”*. Më pas hyri në xhami dhe i fali dy reqate, e atëherë i erdhi një person e i tha:

- *Ebu Abdurrahman, devenë e ke në filan vend!*

Abdullahu r.a., u ngrit e i mbathi papuçet, por duke dalë nga xhamia tha: *‘Estagfirullah’*, dhe u kthye mbrapa. E pyetën pse nuk shkoi ta marrë devenë, e tha:

- *Kam thënë ‘qoftë për rizanë e Allahut’, tash nuk mund ta pranoj.*

Transmetohet se si një shejh ka treguar: *“Pashë në ëndërr shokun tim pasi që vdiq, dhe e pyeta:*

- Çka ndodhi me ty pas vdekjes?; e ai më tha:

- Allahu Teala më fali, më vendosi në xhennet e ma tregoi vendin që më ka përgatitur, por jam i mërzhitur e i pikëlluar.

- Si mund të jesh i mërzhitur, kur Allahu Teala të ka falë e të ka vendosur në xhennet?!, e pyeta unë, e ai mori frymë thellë, e më tha:

- Jam i mërzhitur, e do të jem deri në ditën e Gjykimit! Sepse, kur m'u tregua vendi në xhennet, pashë grada më të vlefshme e më të larta atje. Kur deshta të hyj në to, u dëgjua një zë nga lartë, e tha:

- Kthejeni mbrapa! Ai nuk e ka vendin aty! Kjo gradë është për atë që ka thënë: “Qoftë për rizanë e Allahut” dhe e mbajti fjalën, por ky nuk e mbajti.

Transmetohet se një abid e zuri gjumi në Meke, pranë një personi. Kur u zgjua, nuk e gjeti rripin me para dhe i tha atij personit pranë vetes:

- Ti ma morre rripin!

- Sa para kishte në rrip?: e pyeti personi, e abidi i tregoi. Personi e mori me vete në shtëpi e ia dha atë shumë.

Më vonë, shokët e abidit i treguan që ata ia kanë marrë paratë që të bëjnë shaka, dhe të gjithë bashkë shkuan te ky personi që t'ia kthejnë paratë dhe të kërkojnë falje, por personi ju tha:

- *Unë nuk i marr paratë që i kam dhënë për rizanë e Allahut. Këta insistuan, e personi e thirri djalë vet, e në vesh i tregoi emrat e fukarave të cilëve do t'ua ndante atë shumë.*

Ky ishte ahlaku i gjeneratave të para të myslimanëve. Nganjëherë, merrnin nga shtëpia bukë që t'ia japin një fukaraje të caktuar, e nëse nuk e takonin atë fukara, domosdo ia dhuronin tjetrit, por nuk do ta kthenin në shtëpi. Njëjtë ishte edhe me para dhe me të mira tjera që i jepnin si sadaka.

Edepi i pestë është grada më e ulët, e kjo është që i dëmtuari të mos e mallkojë hajnin, i cili i ka bërë padrejtësi duke e vjedhur. Nëse mallkon, tevekkuli i tij bëhet i pavlerë dhe nëse mërzhitet për atë që ka ndodhur, kjo është shejné që zemra e tij është lidhur për pasuri. Nëse e tepron, humb edhe shpërblimin. Në transmetim thuhet: “Kush e mallkon zullumqarin, e ka ndihmuar atë.”

Transmetohet se Rebi ibn Husejmit ia vodhën kalin në vlerë njëzet mijë dërhëmë deri sa ishte duke u falë, e ky nuk e ndërpreu namazin, e as nuk u mërztit. Erdhën shokët ta ngushëllojnë, e ibn Husejm ju tha:

- *Vërtetë e pashë duke ia zgjidhur kapistrën!*

- *E pse nuk e ndalove?!; i thanë, e ai u përgjigj:*

- *Isha i zënë me atë që më është më e dashur se kali; duke menduar në namazin, e shokët e tij nisën ta mallkojnë hajdutin, por ibn Husejm tha:*

- *Mos bëni ashtu, flisni mirë për të sepse atë që ma mori e llogarita si sadaka.*

I vodhën një personi diçka, dhe dikush e pyeti:

- *Pse nuk e mallkon hajdutin?; e ky u përgjigj:*

- *Nuk dua ta ndihmoj shejtanin! E pyeti prapë:*

- *Nëse ta kthen atë që ta vodhi, a do ta marrësh?*

- *Jo. As nuk do ta shikoja; tashnë ia kam bërë hallall!*

Dikush i tha personit që ia vodhën mallin:

- *Mallko atë që të ka bërë padrejtësi!; e ai tha:*

- *Mua askush nuk më bëri padrejtësi. Zullumqari i bëri vetes padrejtësi, a nuk i mjafton atij fatkeqi padrejtësia që ia bëri vetes, që edhe unë t'ia shtoj?!'*

E ofenduan Haxhaxhin për padrejtësinë që po e bën në prani të një personi nga gjenerata e parë (*selefi salihin*), e ai ju tha:

- *Mos e teproni në ofendim! Allahu Teala do të dënojë atë që ofendon nderin e Haxhaxhit, njëjtë siç do të dënojë Haxhaxhin për shkak që ka marrë pasuri dhe jetë.*

Në transmetim thuhet:

“Vërtetë, robit nganjëherë i bëhet padrejtësi, dhe aq e ofendon e shanë atë që i bën padrejtësi, sa barazohet me të në gjynah, e më pas vazhdon të veprojë njëjtë, sa dhunuesit i jep të drejtë që t’i hakmirret.”⁴⁵

Edebi i gjashtë është të brengoset për hajnin, për gjynahet dhe dënimin e tij, ta falënderojë Allahun që i është bërë padrejtësi, e nuk ka bërë ai padrejtësi. Do ta falënderojë Allahun që dëmi i është bërë në gjëra të dynjasë, jo në fe. Dikush iu ankua një dijetari se hajdutët ia prenë rrugën e ia morën pasurinë, e dijetari i tha:

- *Nëse je brengosur më shumë për pasurinë që të është marrë se sa për faktin se në mesin e myslimanëve ka të tillë që hajdutërinë dhe grabitjen e konsiderojnë të lejuar, nuk do të jesh i ndershëm ndaj myslimanëve.*

⁴⁵ Hadithi është përmendur më herët.

Ali ibn Fudajlit i vodhën disa para kur po bënte tavaf rreth Qabes. Babai i tij e pa të mërziur e në lot, e i tha:

- *Po qanë për para?!; e ai u përgjigj:*

- *Jo për para, por për hajnin të cilin Allahu në ditën e Gjykimit do ta pyesë për hajninë, e nuk do të ketë arsyetim.*

Një personit që ia vodhën mallin i thanë:

- *Mallko hajdutin; e ky tha:*

- *Nuk kam kohë, sepse po mërzitem për gjynahin e tij dhe po bëj dua për shpëtimin e tij.*

Qe ahlaku i gjeneratës së parë të myslimanëve, Allahu Teala qoftë i kënaqur (razi) me të gjithë ata.

Rasti i katërt
PËRPJEKJET PËR TË ELIMINUAR DËMIN

Dije se sebepepet që largojnë sëmundjen gjithashtu ndahen në tri: sebepe të sigurta, të supozuara (*maznun*) dhe të bazuara në iluzione (*mavhum*). Të sigurta janë si zhdukja e etjes me ujë dhe e urisë me bukë. Sebepe të supozuara janë si lëshimi i gjakut, ilaçet kundër kapsëllëkut dhe ilaçe tjera, si mjekimi i ftohjes me ngrohtësi dhe i temeperaturës së lartë me ftohtësi, që janë sebepe të dukshme nga mjekësia. E të bazuara në iluzione janë shërimi me fryerje dhe damkosje.

Braktisja e asaj që është e sigurt nuk është nga tevekkuli, e përballë rrezikut nga vdekja ndoshta është haram.

Për mjekimin e bazuar në iluzione, kushti i tevekkulit është që të braktiset kjo, siç ka urdhëruar Resulallahu, s.a.v.s., zotëruesi i tevekkulit. Mënyra më e fortë e mjekimit në këtë mënyrë është damkosja, (mjekimi me djegie), pastaj shërimi me fryerje dhe hajmali.

Sa përk shcallën e supozuar; ky është trajtimi mjekësor. Kjo nuk është në kundërshti me tevekkulin, siç është mjekimi i bazuar në iluzione.

Edhe nëse e braktisë trajtimin mjekësor, nuk është gjynahqar si me braktisje të asaj që është e sigurt. Në disa gjendje, braktisja për disa njerëz mund të jetë më e drejtë. Kjo është grada e mesme.

Se mjekimi nuk është në kundërshti me mbështetjen në Allahun Teala, tregojnë edhe veprimet e Resulallahut, s.a.v.s., fjalët e tij, dhe urdhri i tij që njerëzit të shërohen. Fjalë të Resulallahut, s.a.v.s., janë këto:

“Nuk ka sëmundje e të mos ketë ilaç, pa marrë parasysh a di dikush për të apo jo, pos vdekjes.”⁴⁶

Gjithashtu, thotë:

“Shërohuni, o robë të Allahut, sepse Allahu e ka krijuar edhe sëmundjen edhe ilaçin.”⁴⁷

⁴⁶ Ahmedi dhe Taberani, nga Ibn Mesud, pa pjesën në fund “...pos vdekjes”, dhe e shënon edhe Ibn Maxhe, por pa pjesën “a di dikush për të apo jo...”, si *hasen*. Tirmidhiu shënon hadithin që e cilëson *sahih*, nga Usame ibn Shurejk r.a., e aty thotë: “...përpos pleqërisë.” Taberani në *el-Evsat* dhe Bezari shënojnë hadithin që e përcjellë Ebu Seid Hudri r.a., e Taberani e shënon edhe në *el-Kebi*, nga Ibn Abbas, por me zinxhir të dobët të transmetuesve. Buhariu shënon nga Ebu Hurejre r.a., e aty thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: “Allahu nuk ka dhënë sëmundje, e të mos ketë dhënë shërim për të”, e Muslimi shënon nga Xhabiri r.a., hadithin: “Secila sëmundje e ka ilaçin e vet.”

E pyetën Resulallahun, s.a.v.s., se a ndërrohet caktimi i Allahut Teala duke u shëruar me mjekësi, e tha:

- Edhe ajo është me caktimin e Allahut.⁴⁸

Në transmetim të njohur, thuhet:

“Nuk kam parë asnjë melek nga bota e melekut (mela-i a’la) që nuk më kanë thënë:

- Urdhëroje ummetin tënd të shërohet me hixham (lëshimin e gjakut).”⁴⁹

Dhe duke urdhëruar, Resulallahus.a.v.s., ka thënë:

“Lëshoni gjakun në ditën e shtatëmbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë dhe njëzet e një të muajit, që sëmundja të mos ju befasojë e vrasë.”⁵⁰

⁴⁷ Tirmidhiu, dhe thotë që është sahih. E shënon edhe Ibn Maxhe, që është transmetimi i përmendur këtu, nga Usame ibn Shurejk r.a..

⁴⁸ Tirmidhiu dhe ibn Maxhe nga Ebu Huzame r.a.

⁴⁹ Tirmidhiu, nga Ibn Mesud r.a., e Tirmidhiu thotë që është i mirë dhe garib. E shënon edhe ibn Maxhe nga Enesi r.a..

⁵⁰ Bezzari, nga Ibn Abbas r.a., por zinxhiri i transmetuesve ndalon te as’habi. Tirmidhiu transmeton hadithin nga Resulallahu, s.a.v.s., ku thuhet: *“Më së miri e keni të lëshoni gjakun në ditën e shtatëmbëdhjetë...”*, e më pas përmend hadithin në tërësi, por nuk përmendet vdekja e përnjëhershme. Tirmidhiu thotë se është hadith i mirë dhe garib, ndërsa Bezzari thotë që zinxhiri i përmendur më parë është më i mirë.

Thuhet se shtypja e lartë e gjakut mund të ketë pasoja të rrezikshme, bile që, me lejen e Allahut, mund edhe të mbysë, por që mund të shërohet me lëshimin e gjakut. Nuk ka dallim në mes të nxjerrjes nga trupi të gjakut që mund të shkaktojë vdekjen dhe nxjerrjes së akrepit që është futur nën rroba.

Pra, nuk është kusht i tevekkulit që të braktisen këto që i përmendëm, por kjo është sikur fikja me ujë e zjarrit që nisë ta kaplojë shtëpinë, që të ndalet dëmi që ai zjarr e shkakton. Nuk është mbështetje në Allahun Teala braktisja e ligjiit që Ai e ka caktuar. Në transmetim të saktë thuhet:

“Kush lëshon gjakun të ejten, në ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit, këtë do ta ketë ilaç për secilën sëmundje, për një vit.”⁵¹

Kur flitet për urdhërimin, tregohet se Resulallahu, s.a.v..s., ju urdhëroi shumë as’habëve të përdorin ilaçet e të shërohen me pehriz, ndërsa Sa’d b. Muadhit r.a., ia urdhëroi lëshimin e gjakut (*hixham*), e kur Alisë r.a., iu lëndua syri e kishte dhimbje, i tha:

⁵¹ Bezzar nga Ibn Abbasi r.a., Tebarani nga Mikali r.a., Ibn Hibban në *Dhuafa*.

“Mos i ha këto (e tregoi në hurmet që sapo kishin arritur), ***por haji këto*** (e tregoi në hurmet e përgatitura me miell), ***janë më të mira për ty.***”⁵²

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Suhejbit r.a., kur e pa duke ngrënë hurme kur e kishte syrin e lënduar:

- ***Po ha hurme, e syrin e lënduar!***, e, Suhejb i tha:

- *Po ha me anën e shëndoshë*; në çka Resulallahu, s.a.v.s., buzëqeshi.

Kur flitet për veprimin e Resulallahut, s.a.v.s., familjarët e tij kanë treguar se për çdo mbrëmje ka përdorë surmen, një herë në muaj përdorte shushunjat për t’ia thithur gjakun dhe pinte ilaç një herë në vit. Resulallahu, s.a.v.s., disa herë është mjekuar nga kafshimi i akrepit dhe kafshëve tjera. Transmetohet se, kur i vinte Shpallja, Resulallahun s.a.v.s., e kaplonte kokëdhimbje e madhe, kështu që e lidhte kokën me fashë, në të cilën kishte këna. Në një transmetim thuhet se Resulallahut s.a.v.s., kur iu paraqit plagë në trup, ai vendosi këna, e në transmetim tjetër thuhet se vendosi dhé.

⁵² Ebu Davud dhe Tirmidhiu, që thotë se është *garib*. E shënon edhe Ibn Maxhe, nga Ummul-Munzire, r.a..

Nuk është e mundur të përfshihen të gjitha që transmetohen nga Resulallahu, s.a.v.s., për mënyrat e mjekimit si edhe urdhrat që ato të përdoren. Për këtë temë është shkruar libri që mbanë titullin *Mjekësia e Pejgamberit*. Dijetarët tregojnë se në transmetimet e Beni Izrailëve tregohet se Musa a.s., u sëmur. E vizituan disa nga populli i tij, ia përcaktuan diagnozën, e i thanë:

- *Duhet të mjekohesh me filan ilaçin, e sigurisht do të shërohesh*. Musa a.s., ju tha:

- *Nuk do të mjekohem, por pres prej Tij të më shërojë pa ilaç*. Sëmundja nuk iu largua, por vetëm sa i vazhdoi. Prapë i erdhën të njëjtit, e i thanë:

- *Ilaçi për sëmundjen tënde është i njohur e provuar, nëse e merr, do të shërohesh*. Musa a.s., prapë tha:

- *Nuk dua të mjekohem!* Por, sëmunja nuk e lëshoi, e Allahu Teala i shpalli:

- ***Pasha madhështinë e lartësinë Time, nuk do të shëroj përderisa nuk pranon mjekimin e tyre!***

Atëherë Musa a.s., i thirri, ata e mjekuan, dhe Musa a.s., u shërua. Por, Musanë a.s., e kaploi një lloj habie me këtë, e Allahu Teala i shpalli:

- ***Ke dashur të ndryshosh hikmetin Tim me tevekkulin tënd! Përveç Meje, kush ia krijoi ilaçit shërimin e që ai të sjell dobi?***

Në transmetime tjera përmendet se një pejgamber u ankua për sëmundjen, prandaj Allahu Teala i shpalli të hajë ve, e një tjetër pejgamber u ankua në dobësinë e trupit, e Allahu Teala i shpalli të hajë mish e të pi qumësht. Disa njerëz ju ankuan pejgamberit të tyre se gratë po u lindin fëmijë të shëmtuar, e Allahu Teala i shpalli t'i urdhërojë që grave të tyre shtatzëna të ju japin ftoj për të ngrënë dhe se kjo i bën fëmijët e bukur, dhe që duhet këtë ta vazhdojnë në muajin e tretë dhe të katërt sepse atëherë Allahu Teala ia jep formën fëmijës. Ata ju dhanë grave shtatzëna ftoj, e lehonave hurme.

Allahu Teala ligjin (sunnetin) e Tij, nëpërmjet hikmeteve të ndryshme e ka lidhur për sebepe të dukshme. Edhe ilaçet, si sebetet e tjera, i janë nënshtruar hikmetit të Allahut. Siç është buka ilaç që shëron urinë e uji etjen, njëjtë edhe pija nga mjalti, uthulla e uji është ilaç për sarillëkun, e *bima e lëngët*⁵³ është ilaç për diarenë. Ky shërim mungon në dy raste:

Rasti i parë, ku buka e uji janë ilaç për uri e etje, kjo është e qartë dhe e njohur për të gjithë, derisa për shërim të sarillëkut me pijen e bërë nga mjalti, uthulla e uji dinë vetëm një numër i vogël i njerëzve. Kur me përdorim t'i njihet dobia kësaj pije, atëherë dobia e saj bëhet po aq e njohur sa edhe dobia e bukës dhe ujit.

⁵³ *Convolvulus scammonia*

Rasti i dytë është që ilaçi lehtëson, e pija e bërë nga mjalti, uthulla e uji qetëson sarillëkun, nën kushte të caktuara të brendshme. Shkaku qëndron në përzierjen e cila, përsëri, i ka kushtet e veta të cilat nganjëherë nuk është e mundur të realizohen, e kur kjo të ndodhë, ilaçi për tretje nuk do të ndihmojë. Nga ana tjetër, mjafton të pish pak ujë e ta shuash etjen dhe nuk ka kushte tjera për të plotësuar. Nganjëherë, çrregullime të caktuara mund të shkaktojnë etje të vazhdueshme, por këto janë raste të rralla. Mungesa e rezultateve të shkaqeve të caktuara gjithmonë kthehet në këto dy që i përmendëm.

Përndryshe, shkakun gjithmonë e përcjellë pasoja, sa herë që të plotësohen kushtet e saj. Ky është urdhër, rend dhe nënshtrim që vjen nga Krijuesi i shkaqeve, është hikmeti i Tij dhe manifestim i fuqisë së Tij të përsosur.

Nuk ka asgjë të keqe në atë që, ai që mbështetet në Allahun Teala të përdorë shkaktarët, me kusht që zemrën të mos e kthejë tutje prej Krijuesit të shkaktarëve në rastet kur përdor ilaç ose i drejtohet mjekut.

Transmetohet se Musa a.s., pyeti:

- *Allahu im, prej nga vinë sëmundja e shërimit?*

- ***Nga Unë!***

- *E, çfarë bëjnë mjekët, Allahu im?*

- ***Ata marrin riskun e vet dhe qetësojnë zemrat tuaja, deri sa nuk vjen urdhri Im, e urdhri Im është shërim ose vdekje.***

Pra, kuptimi i mbështetjes në Allahun (*tevekkul*) së bashku me mjekimin, siç është përmendur më herët në aftësitë për largimin e dëmit dhe arritjes së dobisë, përbëhet nga dituria dhe nga gjendja me tevekkulin. Braktisja e mjekimit nuk është kusht për t'iu mbështetur Allahut Teala.

Nëse ti thua se edhe damkosja është qartazi mënyrë e shërimit, do të përgjigjesha që nuk ke të drejtë. Mënyrat e qarta të shërimit janë thithja dhe lëshimi i gjakut, marrja e ilaçit që mundëson tretjen dhe përdorimi i pijeve të ftohta që të largohet temperatura, e damkosja nuk është e dobishme në atë masë dhe në shumicën e vendeve as nuk përdoret. Në vendet ku përdoret, nuk është bërë mënyrë e zakonshme e shërimit, por e përdorin disa arabë dhe turq.

Damkosja dhe fryerja janë një mjekim i papërcaktuar. Por damkosja ndahet nga fryerja në dy drejtime. Së pari, ai digjet me zjarr duke mos pasë nevojë urgjente. E djegë dhe shkatërron trupin. Nga kjo pikëpamje, damkosja është e rrezikshme, ndërsa personi mund të mjekohet edhe me ilaç. Por lëshimi i gjakut është ndryshe, pasojat nuk janë të dëmshme dhe efekti i kësaj nuk arrihet me diçka tjetër. Prandaj Resulallahu s.a.v.s., e ndaloi damkosjen, por jo edhe shërimin me të shkruar, e të dyja janë larg nga mbështetja Allahut Teala (tevekkuli).

Transmetohet se Imran ibn Husejn r.a., u sëmur, dhe e këshilluan të shërohet me damkosje, e ky refuzoi. Përkundër refuzimit të tij, ata insistuan, dhe në fund e detyruan në këtë. Më vonë, pat thënë:

“Dikur shihja dritat dhe dëgjoja zërat e melekëve kur më dërgonin selam, e pas shërimit me damkosje të gjitha këto m’u ndalën...”; dhe shpesh thoshte:

“Disa herë jam shëruar me damkosje, e pasha Allahun, as nuk pat sukses ai shërim, e as nuk më ndihmoi.” Më pas, i penduar, kërkoi falje nga Allahu dhe u ngrit në gjendjen e vjetër, dhe prapë filloi të dëgjojë zërat e melekëve. Shpesh i thoshte Mutarrif ibn Abdullahut:

- Allahu m’i ktheu melekët që më dërgojnë selam!

Pra, damkosja dhe mënyra të ngjashme të mjekimit nuk i kanë hije atij që mbështetet në Allahun Teala.

BRAKTISJA E MJEKIMIT NGANJËHERË ËSHTË E
LAVDËRUAR DHE TREGON FORCËN E TEVEKKULIT, SI
EDHE NUK ËSHTË NË KUNDËRSHTI ME SUNNETIN E
RESULALLAHUT S.A.V.S..

Dije se, siç ka shumë nga të parët që kanë kërkuar mjekim, edhe numri i atyre që nuk e kanë pranuar mjekimin, nuk është pak. Mund të mendohet se braktisja e mjekimit është një mangësi, sepse po të ishte përkryrja në braktisje, edhe Resulallahu s.a.v.s., do ta braktiste, sepse tevekkuli i askujt nuk është më i përkryer se i tij. Kur Ebu Bekr r.a., u sëmur, e pyetën:

- *Ta thërrasim mjekun?*, në çka ai u përgjigj:
- ***Mjeku më pa, e më tha: “Unë bëj atë që dua!”***

Kur Ebu Derda r.a., u sëmur, e pyetën:

- *Në çka po ankon?*, e ky ju tha:
- *Në gjynahet e mia.*
- *E çfarë dëshiron?*, e pyetën prapë, e ju tha:
- *Falje nga Rabbi im.* Ata i thanë:
- *Ta thërrasim ne mjekun?*, e ky ju tha:
- *Mjeku im edhe më bëri të sëmurë.*

Kur Ebu Dherr u verbua, i thanë:

- *Do të ishte mirë të mjekohesh, e ky ju tha:*

- *Jam i zënë.*

- *Kërko pra shërim prej Allahut, i thanë, e ai ju tha:*

- *Prej Tij kërkoj gjëra më të rëndësishme.*

Rebi ibn Hajsem iu paralizua trupi, e kur i thanë të kërkojë mjek, ai ju tha:

- *Ashtu mendova edhe unë, por e braktisa sepse m'u kujtuan popujt e Adit dhe Semudit, banorët e Ressit dhe shumë gjenerata mes tyre, të cilët gjithashtu patën mjekë, e u shkatërruan, edhe mjekët edhe pacientët, e kurrfarë rukje nuk ju ndihmoi.*

Ahmed ibn Hanbel thoshte: *"Ai që beson në tevekkul e niset kësaj rruge, dhe nuk pranon mjekim, për mua është më i dashur."* Edhe vet kur ishte i sëmurë nuk e pranonte mjekimin.

E pyetën Sehl-in :

- *Kur e ka personi tevekkulin e vërtetë?, e ky ju tha:*

- *Kur trupin ia kaplon ndonjë sëmundje ose pasuria i zvogëlohet, e ky nuk i jep rëndësi kësaj, por e sheh vetëm kujdesin e Allahut ndaj tij.*

Pra, disa prej tyre e braktisin mjekimin, bile ka edhe të tillë që mjekimin e shohin si të papëlqyer. Përshtatja e këtyre qëndrimeve dhe sjelljeve të tyre me mjekimin e Resulallahut s.a.v.s., është e mundur vetëm kur kuptohen sebepe të largojnë nga mjekimi. Sipas kësaj, themi se braktisja e mjekimit i ka gjashtë sebepe:

Sebepe i parë; i sëmuri duhet të jetë posedues i keshfit, e kështu i zbulohet se i është afruar dakiku i vdekjes dhe se asnjë ilaç më nuk mund ta ndihmojë. Këtë mund ta dijë përmes ëndrrës (së vërtetë), ose përvojës, ose përmes keshfit dhe myshahedes. Braktisja e mjekimit nga ana e Ebu Bekrit r.a., mund të jetë pikërisht e kësaj kategorie, e Ebu Bekri ishte posedues i keshfit. Para vdekjes, për trashëgiminë e tij, i tha vajzës së vet, Ajshes r.anha:

- *Ato janë dy motrat tua*, e Ajshë r.anha kishte vetëm një motër. Por, gruaja e Ebu Bekrit ishte shtatzënë, e më vonë doli se lindi vajzë - motrën e dytë të Ajshes r.anha. Ebu Bekri r.a., e kuptoi përmes *keshf*-it se gruaja e tij po bartte fëmijë femër. Njëjtë, ai mund ta ketë ditur me keshf se do të vdiste nga kjo sëmundje. Përndryshe, ai e dinte se Resulallahu s.a.v.s., është mjekuar dhe e ka urdhëruar mjekimin, prandaj braktisja e mjekimit nga ana e tij nuk mund të ketë domethenie tjetër.

Sebepe i dytë është që i sëmuri të jetë i preokupuar me gjendjen e tij, me frikën për fundin e tij dhe me njohjen absolute të Allahut për gjendjen e tij, prandaj të gjitha i bën që të harrojë vështirësitë e sëmundjes. Angazhimi me gjendjen e vet nuk ia lejon të merret me sëmundejn. Për të këtillin tregojnë fjalët e Ebu Dherr, kur ka thënë:

- *Jam i zënë*; dhe fjalët e Ebud-Derda, kur ka thënë:
- *Unë po kërkoj falje nga Rabbi im.*

Dhimbjen që e ka ndjerë në zemër nga frika prej gjynaheve të veta ishte më e madhe se sa dhimbja e trupit nga sëmundja. Kjo është si vdekja e ndershme nga diçka edhe më e ndershme, ose si njeriu i cili në frikë dërgohet te mbreti për t'u ekzekutuar, e dikush i thotë:

- *Pse nuk ha diçka? Je i uritur*; në çka ai përgjigjet se uria as nuk i shkon në mendje.

Ky nuk është mohim se ushqimi e shuan urinë, e as që qortohet ai që ushqehet. Kjo na bëhet edhe më e qartë me rastin e Sehl, kur e pyetën:

- *Çka është ushqim?*, e Sehl ju tha:
- *Ushqim është dhikri - përmendja e Allahut, që është gjithmonë i gjallë (el-Hajj) dhe që mbanë gjithçka gjallë (el-Kajjum).*
- *Po të pyesim me çka jetohet.*

- Me dituri.

- Pyetëm për ushqimin!

- Dhikri është ushqim!

- Po pyesim për ushqimin për trup.

- Çfarë keni me trupin? Trupin lëshoja Atij i Cili qysh në fillim e mori në mbrojtje të Tij, e njëjtë do të bëj edhe në fund. Kur trupi sëmuret, lëshoja Krijuesit të tij. A nuk e sheh se kur diçka prishet, ia kthejnë atij që e ka prodhuar, që ai ta rregullojë?!

Sebepi i tretë është që sëmundja është kronike, e ilaçi me të cilin duhet mjekuar nuk është shumë i besueshëm, diçka si damkosja dhe fryerja. Ai që i mbështetet Allahut, largohet nga këto. Prandaj Rebij ibn Husejm tha: *“Mu kujtuan popujt Ad e Semud, që gjithashtu kishin mjekë, e u shkatërruan, edhe mjekët, edhe pacientët”*.

Pra, në ilaç edhe nuk mund të mbështetesh aq. Kjo nganjëherë është për shkak se ilaçi është i padobishëm, e nganjëherë sipas mendimit të vetë pacientit. Natyrisht se mjeku me përvojë ka bindje më të fortë për ilaçin se të tjerët. Kjo do të thotë se mbështetja në shërimin nga ilaçi ose dyshimi në të, mund të ndryshojnë sipas besimit në mjekun. E besimi forcohet me përvojën.

Shumica e abidëve dhe zahidëve që e braktisën mjekimin u mbështetën pikërisht në këtë arsye. Për ta, ilaçet janë të dyshimta, të pabaza. Në fakt, ky mendim sipas atyre që e njohin shkencën e mjekësisë është i vërtetë vetëm për disa ilaçe, e jo për tjerat. Por ai që nuk është mjek, i shikon të gjitha njëjtë. Ai mjekimin e sheh si damkosjen e fryrjen, futje në shkaqe boshe, prandaj edhe e braktisë, për shkak të tevekkulit të tij.

Sebepi i katërt është që me braktisjen e mjekimit, personi synon ta zgjasë sëmundjen e vet, që të fitojë sevape duke qenë i durueshëm në sprovat e Allahut, ose që të provojë forcën që e ka në durim. Ka shumë transmetime për sevapin në durimin e sëmundjes. Kështu, Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Ne pejgamberët jemi sprovuar me telashe më të mëdha, pastaj ata që më së shumti na ngjajnë, më pas ata që ju ngjajnë këtyre. Robi sprovohet përshtatshëm imanit që ka; nëse është me iman të fortë - Allahu Teala ia shton sprovat, por nëse në iman ka dobësi, Allahu ia zbutë sprovat.”⁵⁴

⁵⁴ Ahmed ibn Hanbel, Ebu Ja’la dhe Hakimi, që thotë se është *sahih*, me kushte të Muslimit. Hakimi, edhe nga Sa’d ibn Ebi Vekkas, *sahih* me kushtet e Buhariut dhe Muslimit.

“Allahu Teala e sprovon robin e Tij me telashe, ashtu siç e provoni ju arin me flakë. Dikush nga kjo del si ari i pastër, që më mirë nuk bëhet, disa jo edhe aq mirë, e disa dalin të zi e të shkrumuar.”⁵⁵

Në hadith të transmetuar nga ehli-bejti, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur Allahu Teala e do një rob, Ai e sprovon. Nëse robi duron, Allahu e mbron, e nëse është i kënaqur, e bën të zgjedhur.”⁵⁶

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Ju a dëshironi që, si kafshët e egra, të mos jeni të sëmurë?”⁵⁷

Ibn Mesud r.a., ka thënë: *“Te besimtari, më të shëndoshën ia sheh zemrën, e më të sëmurin – trupin, deri sa te mynafiku, më së shëndoshi ia sheh trupin, e më të sëmurën – zemrën.”*

⁵⁵ Taberani, nga Ebu Umame, me zinxhir të dobët të transmetuesve.

⁵⁶ Autori i *el-Firdevs*, nga Alia r.a.. Me kuptim të njëjtë shënon edhe Taberani, por me zinxhir të dobët.

⁵⁷ Ibn Ebu Asim, në *‘Ahad dhe Mesani’* Ebu Nu’ajm e Ibn Abdurrahman në *‘Sahabe’* Bejhekiu në *‘Shuabu’l-Iman’*, nga Ebu Fatime r.a..

Pasi që për sëmundjen dhe sprovën është premtuar më shumë shpërblim, shumë e donin sëmundjen dhe e dinin si një fitim. Qëllimi i tyre ishte që me durim të arrijnë shpërblimin. Disa prej tyre kishin sëmundje që i fshehnin nga mjeku, e duronin duke qenë të kënaqur (razi) me caktimin e Allahut. E dinin që angazhimi me të Vërtetën (Hakk) është më e rëndësishme se sa angazhimi me sëmundjen. Ata e dinin gjithashtu se sëmundja i pengon gjymtyrët në namaz, por edhe që namazi ulur, bashkë me durimin në caktimin e Allahut, është më me vlerë se namazi që bëhet në këmbë e me shëndet të mirë. Në hadith thuhet:

“Allahu Teala (për të sëmurin) ju thotë melekëve:

- *Shkruani ndër veprat e mira atë që rob i vepron, sepse ai është nën prangat e Mia. Nëse e çliroj, mishin ia ndërroj me mish më të mirë dhe gjakun me gjak më të mirë, e nëse e marr afër Vetes, do ta marr në Rahmetin Tim.*”⁵⁸

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Veprat më me vlerë janë ato që nefsi i urren”⁵⁹,
pra, veprat e bëra në sëmundje dhe në gjendje të vështirësisë.

⁵⁸ Taberani, nga Abdullah ibn Omer r.a.. Tashmë e kemi përmendur.

⁵⁹ Hadithi tashmë është përmendur.

Sehl, ka thënë: *“Braktisja e mjekimit, edhe nëse lajmërohen dobësi në veprim, është më e mirë se sa mjekimi për të bërë veprim.”*

Përndryshe, Sehl, kishte një sëmundje të rëndë, nga e cila nuk mjekohej, e ai vet i mjekonte të tjerët nga po e njëjta sëmundje. Kur shihte dikë si falë namaz i ulur, i cili për shkak të sëmundjen nuk mund të angazhohet në vepra të mira, dhe kërkon shërim që të falë namaz në këmbë e të bëjë vepra të mira, habitej e thoshte:

- Namazi i tij, i ulur e i kënaqur (razi) me gjendjen që e ka, i është më i mirë se shërimi me qëllim që të ketë forcë e të falë namaz në këmbë.

Një herë e pyetën për marrjen e ilaçit, e Sehl, tha:

- Kush fillon të marrë ilaçe, kjo është mirësi e Allahut për më të dobët. Megjithatë, më i mirë është ai që nuk merr ilaçe, sepse nëse merr, qoftë edhe ujë të ftohët, do të pyetet përse e ka marrë. E ai që nuk merr nuk do të pyetet.

Rruga e tij dhe e dijetarëve të Basrasë mbanin qëndrim se nefsi duhet molisur me uri dhe t'i thehen epshet. Sipas tyre, edhe një grimcë nga veprat e zemrës, siç është durimi, rizaja dhe tevekkuli, është më e mirë sesa male veprash të bëra me gjymtyrë.

Sëmundja nuk bëhet pengesë për veprat e zemrës, pos nëse është tejet e rëndë. Sehl ka thënë: *“Sëmundjet e trupit janë rahmet, e sëmundjet e zemrës janë dënim.”*

Sebepi i pestë është që njeriun e kanë mbuluar gjynahet, frikësohet nga to dhe nuk mund t'i shlyejë, kështu që sëmundjen që zgjatë e sheh si shlyerje të atyre gjynaheve. Prandaj edhe heq dorë nga shërimi, me frikën se sëmundja shpejt i kalon. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ethet e zjarrmia i shkrijnë gjynahet e njeriut dhe ai ecë (si me një veshje) pa gjynahe në sipërfaqen e tokës.”⁶⁰

Në hadith gjithashtu thuhet:

Një ditë me ethe i shlyen gjynahet e një viti.⁶¹

Thuhet se kjo është kështu për shkak që ethet e dobësojnë forcën për një vit të tërë, si edhe për faktin se njeriu i ka 360 nyje, e ethet hyjnë në secilën prej tyre. Personi ndjen dhimbje nga secila nyje, e secila dhimbje e shlyen një ditë.

⁶⁰ Ebu Ja'la dhe Ibn Adijj nga Ebu Hurejre r.a.. Taberani, nga Ebud-Derda dhe Enesi r.a..

⁶¹ El-Kudai, në *Musnedush-shihab* nga Ibn Mesud r.a.,

Kur Resulallahu, s.a.v.s., e përmendi pastrimin nga gjynahet me ethe, Zejd ibn Sabit e luti Allahun Teala që gjithmonë të jetë me ethe. Dhe ishte me ethe, deri në vdekje. Duanë e njëjtë e bënë edhe disa nga Ensarët, e edhe ata ishin me ethe deri në vdekje.

Kur Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“Kur Allahu ia merr dikujt sytë, Ai nuk kënaqet për atë rob me shpërblim tjetër përveç xhennetit”⁶²,
në mesin e Ensarëve pati edhe të atillë që dëshiruan të verbohen.

Isa a.s., ka thënë: *“Nuk është dijetar ai i cili nuk gëzohet për telashet dhe sëmnundjet që ia kaplojnë trupin e pronën, që përmes tyre të shpresojë pastrimin nga gjynahet e veta.”*

Transmetohet se Musa a.s., e pa një person që e kishte goditur fatkeqësi e madhe, e tha:

- *Allah, mëshiroje!* Allahu Teala në këtë tha:

- ***Si ta mëshiroj, kur tashmë e kam mëshiruar?!;***

pra, ia fala gjynahet dhe ia ngrita gradën.

⁶² Hadithi është përmendur më herët, por pa shtesën për dëshirën e Ensarëve që të verbohen.

Sebepi i gjashtë duke kujtuar ditët që i kaloi në gjynah, dembeli dhe egërsi kur ishte i shëndetshëm, e braktisë mjekimin nga frika që shpejt do të shërohet e do të dalldiset në gjynah, dembeli dhe egërsi. Shëndeti do të thotë forcim i cilësive ekzistuese te njeriu, e nga këto cilësi ngjallet epshi, nxitet pasioni dhe synohen gjynahet. Më së paku në çka nxitë shëndeti është angazhimi me *mubah*, që në esencë është harxhim i kohës.

Kur Allahu Teala ia do të mirën ndonjë robi, Ai nuk e lë atë rob pa sëmundje e telashe. Prandaj edhe thuhet: *"Besimtari nuk mund të jetë pa sëmundje (ille), pa varëfri (kille) e pa poshtërim (zille)."*

Transmetohet se Allahu Teala thotë:

"Varfëria është burgu Im, e sëmundja prangat e Mia, me të cilat e largoj atë që e Dua nga krijesat e Mia."

Nëse sëmundja është largim nga egërsia, dembelia dhe gjynahu, çfarë mund të jetë më e mirë se kjo?! Ai që frikësohet nga këto, as edhe nuk duhet t'i nënshtrohet mjekimit. Shëndeti i vërtetë është braktisja e gjynahit.

Një *arif* e pyeti një person:

- *Si ishe pasi u ndamë?*

- *Me shëndet, u përgjigj personi, e arifi i tha:*

- *Nëse nuk ke bërë gjynah, atëherë ke qenë me shëndet, por nëse ke bërë gjynah – ku ka sëmundje më të keqe! Ai që bën gjynah, nuk është shëndosh.*

Alia r.a., kur i pa në Irak bunaret e zbukuruara për një festë, pyeti:

- *Çfarë është kjo?*

- *Është një festë e tyre, o prijës i besimtarëve; i thanë, e Alia r.a., tha:*

- *Për ne festë është secila ditë kur nuk bëjmë gjynah.*

Allahu Teala thotë:

“...pasi vërejtët atë që e dëshironit”

(3-Ali Imran: 152), e thuhet se me këtë mendohet pikërisht në shëndet dhe pasuri.

Allahu Teala gjithashtu thotë:

**“Por vërtet që njeriu i kalon kufijtë,
kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.”**

(96-Alak: 6, 7), e edhe kur mendon se është i vetëmjaftueshëm (*mustagni*) me shëndet është kështu.

Disa thonë se Faraoni tha:

"Unë jam zoti juaj më i lartë." (79-Naziat: 24),
për shkak të jetës së shendetshme për kohë të gjatë
ngase për 400 vjet nuk pati dhimbje koke e as që trupin
ia kaploi zjarmia, as që është djersitur ndonjëherë,
prandaj edhe e shpalli veten zot, Allahu e mallkoftë!
Sikur vetëm një ditë të kishte dhimbje koke, kjo do ta
largonte nga çfarëdo veprimi të panevojshëm, e lere më
ta shpallë veten zot! Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

**"Kujtojeni shumë atë (vdekjen) që i shkatërron
kënaqësitë."**⁶³

Thonë se ethet janë lajmëtar i vdekjes, kujton në atë
dhe largon nga thellimi në dynja. Allahu Teala thotë:

**"A nuk e shohin ata se për çdo vit sprovohen një
herë apo dy herë, e përsëri nuk pendohen e as nuk
marrin mësim."** 9-Teube: 126,
e thuhet se sprovohen me sëmundje të shumëllojshme.

Thuhet se personit që dy herë sëmundet e nuk
pendohet, meleku i vdekjes i drejtohet me fjalët:

*- O i pavëmendshëm, nga unë të erdhën dy
lajmëtarë, një pas një, e ti nuk u përgjigje!*

⁶³ Tirmidhiusi hasen dhe garib, si edhe Nesai dhe Ibn Maxhe nga
Ebu Hurejre r.a., e tashmë është përmendur.

Prandaj të parët e ndershëm mërziteshin kur kalonte viti, e nuk i godiste ndonjë telashe, qoftë në trup apo në pasuri. Thoshnin: *“Besimtarit të vërtetë nuk i kalojnë katërdhjetë ditë e të mos e gjejë ndonjë telash.”*

Transmetohet se Ammar ibn Jasir u martua me një grua, e meqenëse ajo nuk u sëmur asnjëherë, ky e shkurorëzoi. Gjithashtu transmetohet se Resulallahut s.a.v.s., ia ofruan një grua për martesë dhe aq të mirë ia përshkruan sa ai gati se dëshiroi të martohet, por kur i treguan se asnjëherë nuk ishte sëmurë, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- *Nuk kam nevojë për të!*⁶⁴

Resulallahu, s.a.v.s., një ditë po fliste për sëmundjet, dhe e përmendi kokëdhimbjen, në çka një person tha:

- *Unë nuk di çka është kokëdhimbja!*

Në këtë, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- *Largohu nga unë!*; dhe vazhdoi: *Kush dëshiron ta shohë një banor të xhehenemit, le ta shikojë këtë!*⁶⁵

Kjo për faktin se edhe në hadith thuhet:

“Ethet janë hise e besimtarit nga Zjarri.”⁶⁶

⁶⁴ Ahmed ibn Hanbel nga Enesi r.a., me zinxhir *xhejjid* (të mirë) të transmetuesve.

⁶⁵ Me këtë kuptim shënon Ebu Davud nga Amiri, vëllau i Hadirit r.a..

Në hadithin nga Enesi dhe Ajshe r.anha, thuhet se kur e pyetën Resulallahun, s.a.v.s.:

- *O Resulallah, a do të jetë edhe dikush bashkë me shehidët në ditën e Kiametit?*; Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Ai që për çdo ditë e kujton vdekjen njëzet herë,***⁶⁷

e në version tjetër:

- ***...që i kujton gjynahet e veta, dhe ato e brengosin.***

Nuk ka dyshim se kujtimi i vdekjes është më i fortë se i sëmuri. Meqë dobitë e sëmundjes janë aq të shumta, disa plotësisht heqin dorë nga mjekimi, sepse aty shohin dobi për vete, e jo pse në vet mjekimin shohin mangësi. Në fakt, si mund të jetë mjekimi i mangët, kur edhe vet Resulallahu, s.a.v.s., është mjekuar?!

⁶⁶ Bezzari nga Ajshe r.anha. Ahmed ibn Hanbel nga Ebu Uname, Taberani në *el-Evsat* nga Enesi r.a, Dejlami në *Musnedul-Firdevs* nga Ibn Mesud r.a. Të gjithë zinxhirët janë të mirë.

⁶⁷ Zinxhiri i transmetuesve të këtij hadithi nuk është i shënuar në përmbledhjet e haditheve.

PËRGJIGJE ATYRE QË THONË SE BRAKTISJA E SHËRIMIT ËSHTË MË E MIRË

Nëse dikush thotë:

*Resulallahu s.a.v.s., është mjekuar me qëllim që të jetë shembull për të tjerët, jo për vete, sepse mjekimi është gjendja e atyre që janë të dobët, ndërsa ata që janë shpirtërisht të fuqishëm e braktisin mjekimin, dhe i mbështeten Allahut; atëherë, sipas kësaj, edhe kur gjaku vlon në organizëm, ai duhet të lëshohet. Nëse ky thotë po, dhe kjo është kusht i tevekkulit, atëherë kusht do të ishte që edhe akrepi e gjarpri lirisht ta kafshojnë njeriun e ky të mos i largojë, sepse gjaku “kafshon” të brendshmen, e akrepi e gjarpri të jashtmen, prandaj ku është dallimi? Edhe i urituri nuk duhet të hajë, e i eturi nuk duhet të pijë, dhe nuk ka njeri që për këtë të thotë po, e mes gjithë këtyre gjendjeve, nuk ka dallim. Të gjitha këto janë të lidhura me shkaktarë (*esbab*), që i ka përcaktuar *Shkaktari* i të gjitha shkaqeve, i lavdëruar dhe i lartësuar është Ai, dhe me to e zbaton ligjin e Vet.*

Se braktisja e mjekimit dhe parandalimi i sëmundjes nuk është kusht i tevekkulit, tregon veprimi i hazreti Omerit r.a., dhe as’habëve tjerë në ndodhinë e ndërliður me murtajën;

Omeri r.a., me as'habë u nisën për në Sham e kur arritën në vendin e quajtur el-Xhabi, mësuan se në Sham është përhapur murtaja, epidemi e madhe. As'habët u ndanë në dy mendime; disa thanë se nuk duhet shkuar atje e ta hedhin veten në shkatërrim, e të tjerët thanë: *“Ne do të shkojmë e do t'i mbështetemi Allahut Teala. Nuk do të ikim nga caktimi i Allahut, e as nga vdekja, e të bëhemi sikur ata për të cilët Allahu Teala thotë: **A nuk di për ata, të cilët nga frika prej vdekjes u larguan prej atdheut të vet** (2-Brekare: 243).*

Në fund të gjithë shkuan te hazreti Omeri r.a., të dëgjojnë mendimin e tij. Omeri r.a., tha:

- *Do të kthehem! Nuk do të shkojmë atje ku ka epidemi të murtajës.* Ata që mendonin ndryshe, thanë:

- *Të ikim nga caktimi i Allahut?!;* e Omeri r.a., tha:

- *Po, do të ikim nga caktimi i Allahut, në caktimin e Allahut; dhe ju shpjegoi këtë me një shembull:*

Nëse dikush prej juve i dërgon delet në një lëndinë, që në një skaj ëshë me gjelbrim e në tjetrin i thatë. Nëse i kullos në pjesën e gjelbruar, kjo do të ishte me caktimin e Allahut, njëjtë siç do të ishte edhe po ti dërgonte në pjesën e thatë. E ky delet sigurisht i çon në pjesën e gjelbruar. Edhe ne njëjtë; po marrim një masë. Nuk ka ikje nga caktimi i Allahut.

Omeri r.a., kërkoi të dëgjojë edhe mendimin e Abdurrahman ibn Avf, r.a., por ai nuk ishte aty.

Kur erdhi në mëngjes, Omeri r.a., e pyeti, e Abdurrahmani r.a., tha:

- *O udhëheqës i besimtarëve, unë për këtë çështje dëshmi e kam hadithin që vet e kam dëgjuar.*

- *Allahu Ekber!;* tha Omeri r.a., e Abdurrahmani r.a., atëherë tregoi se e ka dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., të thotë:

“Kur të dëgjoni që në ndonjë vend është përhapur murtaja, mos shkoni atje, e nëse murtaja përhapet atje ku jeni, mos ikni nga aty.”

Hazreti Omeri r.a., u gëzua, e falënderoi Allahun Teala që mendimi i vet ishte përshtatshëm hadithit, dhe u kthyen të gjithë. Prandaj parandalimi i sëmundjes nuk është kushti i tevekkulit, në këtë as’habët u pajtuan.

Nëse ti pyet: *Pse Resulallahu s.a.v.s., e ndaloi largimin nga vendi ku ka murtajë? Sipas mjekësisë, shkakut i murtajës është ajri i ndotur, ndërsa mënyra më e mirë e shërimit është largimi nga gjërat e dëmshme. Në këtë rast i dëmshëm është ajri atje. Prandaj, pse Resulallahu s.a.v.s., nuk dha leje të largohen nga aty?;* dije se nuk ka mosmarrëveshje për atë se ikja nga dëmi nuk është i ndaluar. Edhe lëshimi i gjakut është ikje nga dëmi. Braktisja e tevekkulit në raste të këtilla është i lejuar. Megjithëkëtë, kjo shprehje nuk i mjafton qëllimit. E Allahu e di më së miri të fshehtë e kësaj.

Sa për shkakun, themi se ajri i ndotur nuk bën dëm në kontakt me të jashtmen e trupit, por bën dëm kur ai ajr të thithet vazhdimisht.

Pra, nëse në ajër ka papastërti (mikrobe) që arrijnë në mushkëri, zemër e organe tjera të brendshme, dhe ai ajër merret për një kohë të gjatë, ai do të lë pasoja, por që nuk shfaqen menjëherë. Sëmundja fillon të shfaqet pas një kohe. Prandaj dalja nga vendi ku është përhapur sëmundja nuk do ta ndërprejë ndikimin që ka lëshuar rrënjë më herët. Mundësitë për të shpëtuar janë të dobëta. Nëse sepasi është vetëm kjo, atëherë do të ishte në kundërshtim me tevekkulin, e nuk do të ishte e ndaluar.

Por, ka edhe një sepasi tjetër që nuk e lejon largimin, e ky është kujdesi për të sëmurët. Nëse të shëndetshmit lejohet të largohen, atëherë nuk ngelë askush që t'i shërbejë të sëmurët. Nuk do të mbetej askush t'ju sjellë ujë e ushqim dhe ata do të braktiseshin në vdekje.

Siç kanë shpresë ata që janë të shëndetshëm se nuk do të sëmuren, edhe të sëmurët kanë shpresë se do të shërohen. Por, nëse të shëndetshmit largohen, kjo do të thotë që padyshim i kanë braktisur të sëmurët në vdekje.

Ndërsa myslimanët janë të lidhur me njëri-tjetrin si tullat e një ndërtese. Në esencë, të gjithë besimtarët janë si një trup. Sikur në rastet kur ndonjë pjesë e trupit nuk funksionon mirë, e i tërë trupi i shërben asaj pjese, edhe besimtarët interesohen për dertet e njëri-tjetrit dhe ndihmohen mes vete.

Shpjegimi ynë deri këtu është pikëpamja jonë rreth ndalesës së largimit nga vendi i sëmundjes.

Sa për ata që janë jashtë vendit ku është përhapur murtaja, ata nuk kanë thithë ajr të ndotur, dhe nëse banorët e atij vendi nuk kanë nevojë për ta, nuk kanë nevojë të hyjnë në atë vend.

Por, nëse në atë vend kanë mbetur vetëm të sëmurët, lejohet të hyjë ai që dëshiron të kujdeset për ta. Këtu, dëmi është supozim, e dobia është e sigurt, prandaj edhe preferohet. Prandaj ikja nga murtaja është e ngjashme me ikjen nga fushëbeteja⁶⁸, sepse për ata që janë në atë vend ka dëshpërim e shkatërrim.

⁶⁸ Hadithin për këtë e shënon Ahmed ibn Hanbel nga Ajshe r.anha, me zinxhir të mirë (*xhejjid*) të transmetuesve, si edhe te Xhabiri r.a., por me zinxhir të dobët.

Të gjitha këto janë çështje të ndjeshme. Kush nuk mendon për këto, duke e shikuar vetëm të jashtmen e hadithit dhe sebebip, i sheh ato si e anulojnë njëra-tjetriën. Gabimet e abidëve dhe zahidëve në këtë çështje janë të shumta. Pikërisht për këtë edhe ekziston nderi dhe vlera e diturisë.

Nëse ti thua: *Braktisja e shërimit, ashtu siç e tregove, kuptohet që ka vlerë; përse Resulallahu s.a.v.s., nuk e përfitoi këtë vlerë duke braktisë shërimit?*; dije se braktisja e shërimit ka vlerë për atë që ka shumë gjynahe dhe me këtë i pastron, ose frikësohet nga dëshirat e veta të azdisura kur është shëndosh, ose i nevojitet diçka t’ia përkujtojë vdekjen për shkak të gafletit (pavëmendjes) që e pushton, ose dëshiron të arrijë sevapin e sabrit, meqenëse nuk i ka arritur gradat e atyre që janë të kënaqur (*razi*) e mbështeten në Allahun.

Ka vlerë edhe për atë i cili nuk e di që Allahu Teala e ka vendosur shërimitin në ilaçe, prandaj shërimi do të ishte një gjë e dyshimtë për të, e nga kjo pikëpamje e braktisë shërimitin, ose edhe për atë të cilin angazhimi me gjendjen e vet e parandalon të merret me shërim, ku shërimi vetëm sa do ta largonte nga gjendja, e ky nuk është aq i fortë t’i bashkojë edhe shërimitin edhe gjendjen.

Ja, këto janë sebepe që të braktiset shërimi. Secila prej tyre për disa persona është përkryerje, por në krahasim me gradën e Resulallahut s.a.v.s.. është e mangët. Grada e Reaulallaut s.a.v.s., është mbi të gjitha këto grada. Gjendja e tij është në një rrugë dhe nuk ndryshon, pati sebepe apo jo. Shikimi i tij, në çdo situatë ishte i drejtuar vetëm drejt Shkaktarit, e jo shkaqeve. Atij që është në këtë gradë nuk i bëjnë dëm shkaqet.

Dëshira e përkoshme është mangësi, e kur nuk posedon fare dëshirë për pasuri, kjo është përkryerje. Por, mos-posedimi i dëshirës për pasuri është mangësi për atë të cilit i është plotësisht e njëjtë, pati ai pasuri apo jo. Për shembull; ata që e shohin të njëjtë arin e gurin janë në gradë më të lartë se ata që largohen prej arit duke thënë: *ari është pasuri e dynjallëkut*. Për Resulallahun, s.a.v.s., ari dhe guri ishin njësoj. Ai nuk e mbante arin në pronë, që t'ia mësojë ummetit gradën e *zuhdit*. Për të ishte krejt e njëjtë, a ndërlihdeshin sebetet a jo. Mos-braktisja e shërimit është përshtatje në *sunnetullah* (ligjin e Allahut në gjithësi). Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu e tregonte vendin e dhembjes.

Grumbullimi i pronës është ndryshe. Dëmi i kësaj është i madh. Bile, që të mos dëmtojë shërimi, duhet të besohet se Allahu Teala e krijoi shërimin.

Të besohet se shërimi vjen nga ilaçi ose doktori, është e rrëzikshme. Në realitet, ilaçet janë vetëm mjet. Nëse me shërim synohet forcimi i shëndetit për të bërë më shumë gjynahe, kjo është e ndaluar. Por, në të shumtën e rasteve besimtari nuk e ka këtë qëllim.

Secili besimtar është i vetëdijshëm që ilaçi nuk sjell shërim vetvetiu, por se Allahu Teala e bëri atë shkas për shërim, njëjtë siç është i vetëdijshëm që uji nuk ia shuan etjen, e as buka nuk e ngopë, dhe këto i pranon vetëm si një shkak dhe mjet.

Gjykimi i shërimit nga aspekti i qëllimit është si gjykimi i fitimit; varësisht se a fiton ai për t'u ndihmuar në ibadete apo gjynahe, do të ketë dy gjykime të ndryshme. Nëse fiton për mubah, edhe fitimi i është mubah.

Sipas kuptimeve që i dhamë, arrijmë në përfundim se në disa raste është më mirë të braktiset shërimi, e në rastet tjera më mirë të shërohet. Kjo ndryshon varësisht gradës, personit dhe qëllimit. Në realitet, bërja ose braktisja e diçkaje nuk është në vetvete kusht i tevekkulit, përpos braktisja e fryerjes dhe mashtrimeve.

GJENDJA E ATYRE QË FSHEHIN OSE TREGOJNË SËMUNDJEN

Dije se fshehja e sëmundjes, varfërisë dhe telasheve tjera është nga thesaret e mirësisë dhe një nga gradat më të larta. Sepse, të jesh i kënaqur (razi) me caktimin e Allahut dhe të durosh sprovat e Tij është marrëdhënie e veçantë me Allahun Teala. Fshehja e sëmundjes ose varfërisë është trimëri më e madhe se sa të tregohet për to. Megjithëkëtë, të tregohet nuk është e ndaluar, nëse nijeti dhe qëllimi janë të singerta. Zaten, janë tri sebepe se kur tregohet për sëmundjen:

1. *Kur qëllim e ka shërimin, dhe e njofton mjekun me sëmundjen.* Nuk ankohet, por e njofton për t'u mjekuar, e shërimin, që ky e ka qëllim, do ta japë Allahu Teala. Bishri ia tregonte dhimbjet e veta Abdurrahmanit. Ahmed ibn Hanbel fliste për sëmundjen e vet, e thoshte:
- *Vetëm po e përshkruaj Fuqinë e Allahut mbi mua.*

2. *I tregon për sëmundjen dikujt që nuk është mjek, për këshillim.* Qëllim e ka të mësojë diçka për durimin e sëmundjes, por edhe falënderimin. Për dhimbjet e veta tregon ashtu si tregon për nimetet që ia jep Allahu. Hasan Basri thoshte: *“Kur i sëmuri e falënderon Allahun Teala, e më pas i përmend dhimbjet e veta, kjo nuk i llogaritet ankesë.”*

3. *E tregon sëmundjen me qëllim që të shprehë nevojën e tij për Allahun dhe pafuqinë e tij.* Mirëpo, kjo i takon vetëm atij që përndryshe është i fuqishëm dhe trim, e pafuqinë nuk e ka cilësi. Tregohet se hazreti Alia r.a., ishte sëmurë, e kur e pyetën si është, tha:

- *Nuk jam mirë.* Të pranishmit e shikuan njëri-tjetrin, dhe kjo përgjigje nuk ju pëlqeu, duke menduar se po ankohej, në çka Alia r.a., ju tha:

- *Po ia paraqes gjendjen time Allahut. Prej Allahut Teala kërkoj fuqi dhe trimëri.*

Alia r.a., dëshironte t'ju tregonte atyre pafuqinë dhe varësinë e vet, sepse ata e njihin Alinë r.a., me forcë dhe trimëri. Në fakt, Alia r.a., vetëm se shprehu edebin që Resulallahu s.a.v.s., ia mësoi tij, kur Alia r.a., një herë ishte i sëmurë, e Resulallahu s.a.v.s., e dëgjoi të thotë: *“Allah, më jep durim në këtë provë”,*

e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- ***Ti po kërkon provë nga Allahu. Kërko shërim prej Tij.***⁶⁹

Domethënë, të tregohet për sëmundjen lejohet vetëm kur është fjala për nijete të tilla. Ky është kusht, sepse të tregohet për sëmundjen është në fakt ankesë në Allahun, meqenëse edhe sëmundja është prej Allahut, e ankesa në Allahun është e ndaluar (haram).

⁶⁹ Hadithi tashmë është përmendur.

Këtë e kemi shpjeguar edhe kur kemi folë për ndalesën e kërkimit të lëmoshës nga të varfrit, pos kur është tejet e nevojshme. Prandaj, të tregohet sëmundja është sikur të mos jetë razi me punën e Allahut dhe t'i shfaqë zemërim Atij, e kjo është haram.

Nëse nuk ka një pohim të tillë, por as ndonjë prej nijeteve të përshkruara më lartë, nuk është haram. E megjithatë, më mirë është të mos tregojë, sepse mund të kuptohet si ankesë, e nganjëherë edhe mund të ikë nga përshkrimi i vërtetë i gjendjes së sëmundjes.

Nga ana tjetër, ai që braktisë shërimin për shkak të tevekkulit, ai aspak nuk ka të drejtë të tregojë sëmundjen, sepse qetësimi me ilaç është më i mirë se qetësimi duke treguar për sëmundjen. Dikush ka thënë: *“Ai që shpallë sëmundjen, nuk konsiderohet i durueshëm.”*

Për fjalën e Allahut Teala

“...fe-sabrun xhemil”, kur tregon për Jakubin, a.s., në ajetin 12-Jusuf: 83:

“Durimi im është (fe-sabrun xhemil), durim i bukur”, thuhet se është durimi pa asnjë ankesë.

E pyetën Jakubin a.s. si e humbi shikimin, e ai tha:

- *Nga kalimi i kohës dhe pikëllimi*. Allahu i shpalli:

- ***Ke filluar t'ju ankohesh robëve të Mi!***

e Jakubi a.s., tha:

- *O Rabbi im, pendohem te Ti!*

Tavusi dhe Muxhahidi kanë thënë: *“Rënkimi i të sëmurit për sëmundjen shkruhet në fletoren e tij.”*

Ata e urrenin rënkimin e të sëmurit sepse kjo është një lloj ankese. Tregohet se Iblisi, Allahu e mallkoftë, nga sëmundja e Ejubit a.s., arriti të fitojë vetëm rënkimin.

E në hadith thuhet:

“Kur robi sëmuret, Allahu Teala i dërgon dy melekë dhe ju thotë: Shkoni e shikoni çfarë ju thotë vizitorëve. Nëse e falënderon Allahun dhe thotë ‘jam mirë’ edhe ju bëni dua për të mirën e tij, e nëse nisë të ankohet dhe flet vetëm keq, thuani: ‘Ashtu edhe të qoftë’.”⁷⁰

Prandaj disa nga të devotshmit nuk e vizitonin të sëmurin, pikërisht nga frika e ankesave të mundshme dhe frika prej zhytjes në llafe.

⁷⁰ Tashmë e kemi përmendur.

Disa prej tyre, kur ishin sëmure, i mbyllnin dyert dhe nuk pranonin vizitorë deri sa shëroheshin. Fudajli, Vuhejbi dhe Bishri ishin prej tyre. Fudajli ka thënë:

“Dëshiroj të jem pacient pa vizitorë”,

dhe gjithashtu ka thënë: *“Shkaku i vizitorëve, nuk më pëlqen sëmundja”,* e Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!

Me ndihmën dhe lehtësimin prej Allahut, përfundoi libri për tevhid dhe tevekkul, e pason libri për dashurinë, dëshirën dhe miqësinë.

I lavdëruar qoftë Allahu, Garantues i suksesit!

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	3
VLERAT E LARTA (FAZILET) TË TEVEKKULIT.....	6
AJETET NË KËTË TEMË.....	6
HADITHET NË KËTË TEMË.....	9
FJALËT E AS'HABËVE DHE DIJETARËVE NË KËTË TEMË	12
HAKIKATI I TEVHIDIT, QË ËSHTË ESENCA E TEVEKKULIT	14
PËR TEVEKKULIN DHE GJENDJET E TIJ.....	73
GJENDJA E TEVEKKULIT.....	73
FJALËT E SHEHLERËVE PËR GJENDJET E TEVEKKULIT.....	92
VEPRIMET E ATYRE QË I MBËSHTETEN ALLAHUT.....	97
PËRFITIMI I DOBISË.....	99
TEVEKKULI I ATIJ QË KA FAMILJE.....	127
SHPJEGIM PËRMES SHEMBUJVE PËR GJENDJET E MUTEVEKKILIT RRETH LIDHJES ME SEBEPE	140
PËR GRUMBULLIMIN E PASURISË.....	144
PËRDORIMI I SHKAQEVE PËR TË LARGUAR DËMIN QË SHKAKTON FRIKË.....	155
EDEBI I MUTEVEKKILIT KUR I VJEDHET PASURI NGA SHTËPIA	167
PËRPJEKJET PËR TË ELIMINUAR DËMIN	177
BRAKTISJA E MJEKIMIT NGANJËHERË ËSHTË E LAVDËRUAR DHE TREGON FORCËN E TEVEKKULIT, SI EDHE NUK ËSHTË NË KUNDËRSHTI ME SUNNETIN E RESULALLAHUT S.A.V.S..	187
PËRGJIGJE ATYRE QË THONË SE BRAKTISJA E SHËRIMIT ËSHTË MË E MIRË	203
GJENDJA E ATYRE QË FSHEHIN OSE TREGOJNË SËMUNDJEN	211

